



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.01.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të komisionit.
2. Seancë dëgjimore me kandidatët për Avokat të Popullit.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Anila Agalliu, Edmond Leka, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi.

Mungojnë:

Bashkim Fino, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Eduard Halimi, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

Të ftuar:

Olta Aliaj
Drita Avdyli
Yllka Banushi
Rezarta Bitri
Jordan Daci
Katriot Frashëri
Altin Goxhaj
Gëzim Gjana

Mimoza Gjika
Genci Gjonçaj
Adrian Licaj
Lefterie Luzi (Lleshi)
Anton Lleshaj
Bujar Madani
Erinda Ndroqi
Suzana Pasha
Zhaklin Peto
Igli Totozani
Rovena Voda

HAPET MBLEDHJA

Eduard Halimi – Procesi qeveritar që ju po bëni për zgjedhjen e Avokatit të Popullit është tërësisht në të kundërt me traditën e këtij parlamenti, është tërësisht në të kundërt me paktin politik të zhvilluar tre vjet më parë, është tërësisht në të kundërt me frymën Kushtetuese. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës, nuk mund të jetë kurrë, në asnjë moment, zgjedhja e Kryeministrit të radhës. Avokati i Popullit i përket popullit, u përket qytetarëve dhe duhet të jetë rojtar i të drejtave të tyre, duhet të jetë në shërbim të qytetarëve. Avokati i Popullit duhet të jetë zëri kundër Kryeministrit dhe jo kukulla e radhës e tij.

5 vjet më parë, kur ju ishit në opozitë, e kërkuat deri në bojkot marrjen e Avokatit të Popullit. Të gjithë e mbajnë mend se si maxhoranca e asaj kohe jua la juve të drejtën, pra opozitës, në mënyrë krejt racionale që ta zgjidhnin Avokatin e Popullit. Të gjithë e mbajnë mend se konkursi për përzgjedhjen e kandidaturës së Avokatit të Popullit u bë në selinë e Partisë Socialiste, ku konkurruan 12 kandidatë të Partisë Socialiste përballë një komisioni të Partisë Socialiste, i kryesuar nga ministrja aktuale, zonja Gjermani, e cila zgjodhi pikërisht një kandidat të sjellë nga Partia Socialiste. Kjo ishte situata e para 5 vjetve. Sot, pas 5 vjetësh, jemi tërësisht në të kundërt. Pse ndodh kjo?! Kjo gjë ndodh për dy arsye.

E para, ka lidhje me arrogancën dhe delirin e Edi Ramës: “Unë i fitova zgjedhjet, unë i dua pushtetet”.

E dyta, ka lidhje me një element tjetër, me rolin e ri që ju dha Avokatit të Popullit me ndryshimet kushtetuese të 22 korrikut për sa i përket implementimit të reformës në drejtësi, ku Avokati i Popullit ka një rol shtesë edhe në përzgjedhjen e kandidaturave për organet e qeverisjes qendrore. Edhe argumenti i dytë ka lidhje me të parin, pra me arrogancën e Edi Ramës për të marrë të gjitha pushtetet. Atë që cedoio Edi Rama më 22 korrik, duke i kaluar disa kompetenca Avokatit të Popullit, e rrëmben tani duke e shndërruar institucionin e Avokatit të Popullit dhe vetë këtë të fundit në një kukull të radhës.

Ndaj, për ne është shumë e qartë, por për ta bërë të qartë për të gjithë, për publikun, për palën kundërshtare, por edhe për partnerët tanë: zgjedhja e Avokatit të Popullit nga Kryeministri është një proces i papranueshëm për opozitën dhe kundër paktit politik dhe frymës së Kushtetutës. Kjo ka të bëjë vetëm me arrogancën e Edi Ramës për t’i marrë të gjitha pushtetet, duke përfshirë edhe zgjedhjen e institucioneve të drejtësisë, që do bëhet gjatë ditëve në vijim me implementimin

e reformës në drejtësi. Arroganca, siç kanë treguar të gjithë skenarët qoftë larg Shqipërisë, por edhe në vendet fqinje është rruga më e shkurtër për të ikur nga pushteti. Po e përsëris për ne është shumë e qartë, por për ta bërë për të qartë për të gjithë publikun, që Avokati i Popullit nuk mund të jetë ushtar i Kryeministrit, kushdo qoftë ai. Avokati i Popullit i përket popullit dhe jo qeverisë, e cila do ta përzgjedhë. Ndaj, për ne ky proces është i papranueshëm.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Mund të vazhdojmë, pasi mbaroi edhe deklaratën politike zoti Halimi, duke bojkotuar, siç e shihni, këtë seancë, që kanë të bëjë me përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, ashtu siç i kanë bojkotuar në vijimësi të gjitha seancat që kanë pasur të bëjnë me këtë proces. Gjithsesi, kjo është zgjedhja e tyre politike. Avokati i Popullit zgjidhet me 84 vota nga Kuvendi i Shqipërisë dhe çdo kandidaturë që mund të votohet, kërkon minimumi mbështetjen e 28 deputetëve, pra vullnetin e të paktën 28 ligjvënësve. Unë besoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka 28 deputetë që të mund të mbështesnin të paktën një kandidaturë për të garuar për funksionin e Avokatit të Popullit, por ka zgjedhur këtë rrugë, por kjo është një çështje që u takon atyre. Ne duhet të vazhdojmë normalisht për të bërë detyrën tonë që nuk është më shumë se organizimi i një seancë dëgjimore, përgatitja e një raporti për të vlerësuar kushtet ligjore dhe vlerësimin e kandidaturave përkatëse. Pastaj është tërësisht vullneti i grupeve politike dhe i deputetëve të mbështesin kandidatin që ata çmojnë se është më i miri për të kryer këtë funksion.

Vazhdojmë normalisht. A ka ndonjë që do të shtojë diçka? Nuk ka.

Atëherë, siç u be me dije, kanë paraqitur dokumentet 20 kandidatura, që do të garojnë për këtë funksion. 19 prej tyre kanë konfirmuar se do të jenë sot të pranishëm për t'u dëgjuar në këtë seancë dëgjimore. Do të vazhdojmë sipas rendit alfabetik, duke nisur nga mbiemri i secilit prej kandidatëve. I është lënë një kohë prej rreth 7 minutash secilit prej kandidatëve për të paraqitur CV-në dhe platformën. I është dhënë mundësia secilit ta paraqiste më parë me shkrim për ta vënë në dispozicion të deputetëve, por është përsëri e mundur që secili ta dorëzojë platformën e tij për të qenë në dispozicion të deputetëve dhe grupeve politike për të bërë përzgjedhjen. Vazhdojmë me procesin sipas renditjes alfabetike. Shpresoj që stafi ta ketë bërë mirë këtë renditje, që të mos ketë ndonjë kontestim për mbiemrin.

Po nis sipas radhës që kam. Fillimisht e ka fjalën Olta Aliaj.

Zonja Aliaj, ju keni paraqitur kandidaturën për të qenë një prej kandidatëve për funksionin e Avokatit të Popullit. Siç jeni njohur me parashikimet kushtetuese, me parashikimet që ka ligji

“Për Avokatin e Popullit” për këtë funksion, keni paraqitur dokumentet përkatëse dhe jeni njoftuar për t’u dëgjuar në seancën e sotme në një kohë prej jo më shumë se 7 minutash. Ju lutem, respektoni kohën për shkak të numrit të madh të kandidatëve dhe angazhimit që t’i japim kohën e mjaftueshme secilit për t’u shprehur!

Fjala është për ju, pastaj janë pyetjet e deputetëve.

Olta Aliaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Faleminderit për mundësinë që po më jepni për të prezantuar veten dhe të jap kontributin tim në shërbimin publik!

Quhem Olta Aliaj dhe aktualisht punoj si këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Studimet e larta në Jurisprudencë i kam mbaruar në Universitetin e Bolonjës me temë diplome “Aplikimi i të drejtës ndërkombëtare në Kushtetutën shqiptare”, më pas kam marrë gradën master në “Studime ligjore ndërkombëtare” nga Universiteti Amerikan në Uashington DC. Një eksperiencë që dua ta veçoj gjatë kësaj periudhe është puna pro bono në një organizatë jofitimprurëse, që është shumë e njohur në fushën e të drejtave të njeriut PILPG. Gjatë punës në këtë organizatë jam marrë me hartimin e Kushtetutës së Kosovës, me pjesën e të drejtave të njeriut, si edhe me projektin për statusin përfundimtar të Kosovës.

Pas mbarimit të masterit, kam punuar 4 vjet në një nga studiot më të njohura ligjore në Amerikë CD Austin. Aty kam asistuar partnerët e studios për përgatitjen e memove ligjore, si edhe për përgatitjen e ekspertëve dhe dëshmitarëve përpara seancave gjyqësore. Megjithëse kam kaluar një periudhë të gjatë të jetës jashtë vendit, gjithmonë kam dashur të kthehem në vendin tim dhe në vitin 2009 jam kthyer në Shqipëri. Fillimisht kam punuar në studion ligjore Loloçi. Gjatë kohës në këtë studio kam bërë një studim të thelluar për diskriminimin e komunitetit LGBTI në Shqipëri për interes të Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut. Për sa jam në dijeni, ky institut ka drejtuar edhe projektin 4-vjeçar danez në mbështetje të Avokatit të Popullit, me fonde të akorduara nga Mbretëria daneze.

Në vitin 2011 kam filluar punë si këshilltare në Gjykatën Kushtetuese. Prej 6 vjetësh në këtë rol kam vlerësuar ankesa kushtetuese, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e njeriut si në kontekstin e procesit të rregullt ligjor, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të rasteve të kushtetutshmërisë së ligjit.

Kam pasur rastin të shqyrtoj kërkesa të ardhura nga Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara, nga Shoqata të Verbërve, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, por edhe nga Avokati i Popullit. Më konkretisht, kam kontrolluar inspektimin e të drejtës së pronës, të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në një proces gjyqësor, ndalimin e diskriminimit, e torturës, të trajtimit çnjerëzor e degradues, barazinë përpara ligjit dhe standarde të tjera në fushën e të drejtave të njeriut. Ky lloj kontrolli, që përbën edhe thelbin e punës sime të përditshme, më ka ndihmuar që të njoh mirë standardet kushtetuese për të drejtat e njeriut dhe standardet e Gjykatës së Strasburgut në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, kam marrë pjesë si eksperte e caktuar nga Gjykata Kushtetuese në reformën e sistemit të drejtësisë, ku kam dhënë kontributin tim për draftimin e amendimeve kushtetuese dhe ligjore për Gjykatën Kushtetuese.

Dua të paraqes shumë shkurt një platformë apo vizionin tim, nëse do të më jepni votëbesimin të zgjidhem në këtë pozicion.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut është një prioritet për procesin e integritimit evropian, ndaj edhe roli i Avokatit të Popullit, si institucioni që mbron këto të drejta, ka një rëndësi të veçantë. Nëse do të votëbesohem të drejtoj këtë institucion, do të punoj dhe do të kontribuoj maksimalisht për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike. Në vizionin tim ky institucion do të jetë përherë pranë qytetarëve, duke luajtur një rol proaktiv për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre. Do të udhëhiqem kurdoherë nga parimet e paanshmërisë, profesionalizimit dhe pavarësisë.

Për të realizuar misionin e Avokatit të Popullit, nëse votëbesohem, do të bashkëpunoj ngushtësisht me institucionet shtetërore, me shoqërinë civile, me grupet e interesit, me organizatat joqeveritare dhe me partnerët ndërkombëtarë për përmirësimin dhe arritjen e standardeve të larta në fushën e të drejtave të njeriut.

Do të bashkëpunoj me Kuvendin jo vetëm nëpërmjet përgatitjes së raporteve vjetore, por edhe duke paraqitur raporte për çështje të veçanta në kohën e duhur, në mënyrë që të merren masa dhe të parandalohen situata, të cilat mund të sjellin shkelje të të drejtave të njeriut. Do të kem parasysh konstatimet dhe rekomandimet e pasqyruara në rezolutat e Kuvendit për vlerësimin e punës vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit.

Do të ndjek në mënyrë proaktive nëpërmjet një plani, sipas temave të caktuara dhe të veçanta, zbatimin nga institucionet shtetërore të rekomandimeve konkrete të dhëna nga Avokati i Popullit.

Do të informoj ligjvënësin për ndryshime të nevojshme legjislative në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe në përmbushje të rekomandimeve të Komisionit European.

Do të monitoroj nismat legjislative që prekin të drejtat e qytetarëve, duke marrë një rol aktiv nëpërmjet pjesëmarrjes në komisionet parlamentare duke paraqitur propozime konkrete.

Do të nxis ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit të të drejtave të njeriut nga ana e publikut dhe institucioneve të administratës publike nëpërmjet medias dhe aktiviteteve të organizuara për këtë qëllim.

Do të thelloj angazhimin publik, sidomos në lidhje me problematikat që shtetasit hasin në marrëdhënie me prokurorinë, me gjykatat dhe me sistemin e burgjeve.

Do të rris gatishmërinë e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit në monitorimin e respektimin e të drejtave të njeriut të shtetasve të huaj, të cilët mund të zhvendosen përkohësisht në vendin tonë si emigrantë.

Do të forcoj ndërveprimin institucional me sistemin e organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Do të vë theks të veçantë në përthithjen dhe promovimin e standardeve më të mira të të drejtave të njeriut në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Gjithashtu, do të përpiqem maksimalisht të ruaj statusin A të akreditimit konform parimeve të Parisit.

Do të përmirësoj eficiencën e institucion nëpërmjet një marrëdhënie të afërt dhe bashkëpunuese me stafin, i cili duhet të punojë si një ekip i koordinuar për realizmin e misionit që ka institucioni i Avokatit të Popullit.

Do të përfundoj në kohë procedurat paraprake për përzgjedhjen e komisionerëve në dy vendet vakante të krijuara.

Besoj se arsimi dhe përvoja e punës në fushën e të drejtave të njeriut do të më ndihmojnë të kryej me përgjegjësi dhe kompetencë detyrat e Avokatit të Popullit, nëse do të emërohen në këtë pozicion.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit edhe për saktësinë, pra prezantimi juaj, bashkë me CV-në dhe platformën ishin fiks 7 minuta.

A ka pyetje?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Aliaj!

Ne CV-në dhe dosjen që ju keni depozituar e kemi. Ju ndoqa me vëmendje dhe kam një pyetje lidhur me pjesën e platformës. Në gjithë atë platformë që ju paraqitet për përmirësimin dhe forcimin e institucionit të Avokatit të Popullit, cilën do të vlerësonit si më parësore në punën tuaj?

Faleminderit!

Olta Aliaj – Faleminderit!

Besoj se përmirësimi i marrëdhënieve institucionale është i një rëndësie të veçantë, sidomos me Kuvendin, por edhe me institucione të tjera shtetërore, por kryesisht me Kuvendin. Dua të theksoj se Avokati i Popullit duhet të komunikojë dhe t'i drejtohet Kuvendit jo vetëm me anë të raportit të tij vjetor apo në rastet kur kanë ndodhur shkelje, pra kur situata ka ndodhur, por duhet të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme situatën e të drejtave të njeriut dhe t'i bëjë prezente problemet që në fazat fillestare, që të merren masa parandaluese.

Gjithashtu, një rëndësi të veçantë për mua ka ndërveprimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera, për shembull me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Besoj se të tria këto institucione mund të koordinohen me mirë dhe të bashkërendojnë aktivitete në fushën e të drejtave të njeriut.

Edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile është shumë e rëndësishme për veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe besoj se ka hapësira për përmirësim në këtë drejtim dhe për të bërë aktivitete më të shpeshta për t'u konsultuar me shoqërinë civile.

Një tjetër çështje që e konsideroj të rëndësishme është edhe bashkëpunimi me mediet. Mendoj se Avokati i Popullit duhet të ketë një angazhim më të madh mediatik për të bërë prezente situatën e të drejtave të njeriut, për të prezantuar veprimtarinë e institucionit të tij, sidomos në rastet e problematikave që kanë shtetasit me prokurorinë, me sistemin penitenciar dhe me gjykatat. Mendoj se këto çështje duhet të kenë mbulim më të madh mediatik.

Po kështu, edhe në ndjekjen e rekomandimeve nga ana e Avokatit të Popullit, që ai vetë u jep institucioneve shtetërore, mendoj se ai duhet të jetë më proaktiv, t'i ndjekë më nga afër dhe të monitorojë sesi janë marrë dhe çfarë hapash konkrete janë bërë për të realizuar këto rekomandime. Pra, nuk mund të shihet më Avokati i Popullit si një institucion ku qytetarët vetëm shkojnë ankohen dhe çdo gjë përfundon me një rekomandim.

Gjithashtu, edhe për sa u përket nismave legislative, Avokati i Popullit duhet të jetë aktiv në komisionet parlamentare, të japë propozime konkrete për këto nisma legislative që prekin të drejtat e njeriut ose të propozojë vetë ai nisma legislative për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe për ta ngritur në nivelin e standardeve europiane. Besoj se edhe situata që është krijuar me vendet vakante e dëmton pak eficiencën e institucionit, pasi Kuvendi, në dijeninë time, ka vendosur një afat, qershorin e vitit 2016, për të plotësuar vendet vakante, por ato janë ende të paplotësuara.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pyetje të tjera nuk ka.

Faleminderit, zonja Aliaj!

Kandidatja tjetër është zonja Drita Avdyli, pas saj është zonja Yllka Banushi.

Zonja Avdyli, siç jeni njoftuar, keni të drejtën për të bërë një prezantim 7 minuta lidhur me CV-në dhe platformën tuaj, pastaj do t’u përgjigjeni pyetjeve që mund të bëjnë deputetët. Ju lutem, respektoni kohën!

Fjala është për ju.

Drita Avdyli – Ju falënderoj!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar media,

Të kandidosh në një vend, që vetëm emri të jep një përgjegjësi dhe përfshirje, është jo vetëm guxim, por, në radhë të parë, kurajë qytetare, profesionale dhe e argumentuar.

Unë, si një grua në karrierë të gjatë dhe të suksesshme, gjatë gjithë shkallës së saj jam ngjitur në bazë të dy parimeve: duke mësuar dhe duke dëgjuar.

Gjatë viteve të mia të punës kam bërë vetëm punë. Jam një grua e martuar me tre fëmijë meshkuj. Nuk kam reshtur së kontribuuar jo vetëm në familje, por edhe në punë. Bashkëshorti im është një mësues dhe tre fëmijët e mi janë diplomuar, janë të rritur dhe shquhen për një punë të ndershme. Pra, pjesë e kësaj karriere është përfaqësuar edhe në familjen time. Në fillimet e mia kam punuar si drejtuese në hekurudhën shqiptare në Durrës, ku njerëzit ishin shumë hallexhinj dhe të varfër. Pikërisht duke jetuar aty dhe duke përjetuar histori njerëzore më kanë ndihmuar në punën time qoftë drejtuese, ashtu edhe si aktiviste, më vonë edhe si lektore.

Përpara ndryshimeve të '91-shit kam qenë drejtoreshë e degës së planit. Kam kontribuuar deri në vitin 2002 si kryetare e departamentit ekonomik, duke drejtuar suksesshëm hekurudhën

shqiptare. Pastaj në vitin 2002 kam kaluar shefe e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, në vitin 2006 u bëra drejtoreshë për shtetësinë dhe refugjatët, kryetare e një bordi, e **Nimeksit**. Nga Ministria e Brendshme në vitin 2013 u bëra kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, por jo vetëm kaq, por jam dekanë në një fakultet privat. Ajo që më dha mua përvojë, shtytje, integritet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm ka qenë pikërisht pozicioni im si komisionere kombëtare e Organizatës Rajonale për Emigracionin me qendër në Shkup. Në fillim isha koordinatorë kombëtare, më vonë u bëra koordinatorë rajonale. Qenia ime në këtë post bëri që unë të kisha kontakte të vazhdueshme me politikanë, me deputetë, me ambasadorë, me përfaqësues të rangjeve diplomatike në Ballkan, në Shqipëri, ashtu edhe në botë. Njohja apo pjesëmarrja në shumë aktivitete të UNCR-së apo të drejtave të njeriut më kanë bërë të rritem edhe më shumë profesionalisht. Unë arrita të përjetoja problematikat e personave të migruar brenda Shqipërisë me probleme të ndryshme, me emigrantët shqiptarë, që janë larguar për kushtet ekonomike apo kushte të tjera, si edhe me të gjithë të huajt që vijnë në Shqipëri, ashtu sikundër ishte edhe ardhja e uigurëve dhe e iranianëve në Shqipëri. Kam udhëhequr strategjitë kombëtare të migracionit për të huajt.

Siç ju thashë, nga viti 2013 deri tani kryesoj Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, pra një alternativë të re, një profesion të ri për të zgjidhur këto mosmarrëveshje, pa iu drejtuar gjykatës. Duke qenë se ne në çdo moment bëjmë rekomandime për shumë konflikte, duke i orientuar palët drejt një zgjidhjeje, p-pikërisht drejtimi i këtij ent të ri më ka dhënë dhe më ka krijuar një atmosferë tjetër për drejtimin dhe për një qasje të re ndaj qytetarëve. Ndërkohë, krahas punës së paepur si kryetare e Dhomës së Ndërmjetësve, unë jam përfaqësuese vullnetare apo presidente e Institutit të Migracionit, duke qenë eksperte e njohur në këtë fushë dhe kam kontribuar vullnetarisht në këtë fushë. Gjithashtu, jam lektore në Universitetin Mesdhetar dhe jam dekanë. Pikërisht kjo më ka dhënë mundësinë të njoh, të prek problematika të ndryshme të brezave të ndryshëm, të brezit të ri, duke qenë lektore, të brezit të mesëm apo edhe të brezit të tretë, si edhe të kontribuoj për një imazh evropian në mësimdhënie apo të trajtoj tematika dhe probleme të ndryshme për realitetin shqiptar. Në të njëjtën kohë, unë kam aplikuar në jetë për dy gjëra, përveç punës dhe edukimit. Kam mbaruar shkollën e mesme në Durrës. Kam qenë pjesë e Olimpiadës së Matematikës. Kam mbaruar Fakultetin Ekonomik në vitin 1986 dhe Fakultetin Juridik në vitin 2006. Kam marrë titullin “Avokat” në vitin 2006, si edhe kam ndjekur shume shkolla jashtë dhe brenda vendit. Kam kryer studime të thelluara pasuniversitare në financat publike dhe në audit ndërkombëtar, i organizuar nga Instituti i Financave Publike e Kontabilitetit në Londër dhe Qendra e Ekselencës në Slloveni.

Gjithashtu, kam mbaruar studimet master ndërkombëtare të nivelit të dytë për qeverisje dhe politika për zhvillimin territorial. Gjithashtu, në vitin 2016 kam mbrojtur temën e doktoraturës për migracion, meqenëse edhe kontributi im më i madh ka qenë në fushën e migrimit.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në bazë të kësaj ekspozije të përgjithshme dhe të eksperiencave të mia arsimore, drejtuese, kontribuuese, është guxim i madh të pranosh dhe të aplikosh në pozicionin e Avokatit të Popullit. Në fakt, *de jure* nuk e kam ushtruar këtë profesion, por *de facto*, po, pasi duke takuar shumë njerëz apo grupe njerëzish...

Fatmir Xhafaj – Zonja Avduli, keni kaluar 2 minuta nga koha që kishim parashikuar për të gjithë.

Të lutem, a mund ta përmbliidhni?

Drita Avduli – Platforma që unë paraqes përpara këtij komisioni është, së pari, nëpërmjet dëgjimit aktiv të shumë problematikave për të zgjidhur thjesht dhe vetëm nëse një palë e tretë e pavarur është në gjendje të dëgjojë, në bazë të transparencës. Pra, Avokati i Popullit duhet të jetë një institucion model. Transparenca duhet të jetë në themel të tij, bashkëpunimi me partnerët dhe, nëse të gjithë së bashku, ndërtojmë një mekanizëm ku gjithsecili bën punën e tij, atëherë më pak çështje do të adresoheshin tek Avokati i Popullit. Pikërisht, zgjidhja e këtij ngërçi do të jetë ndër pikat kryesore të axhendës sime. Gjithashtu, do të jem më afër terrenit duke zhvilluar takime të herëpashershme dhe kontrole të vazhdueshme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Shpresoj të kem mirëkuptimin tuaj, por kemi vendosur një minutash, të cilin ju e kaluat, për fat të keq.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Avdyli! Unë ju dëgjova me vëmendje, por kam parë edhe dokumentacionin. Unë kam dy pyetje për ju.

Pyetja e parë lidhet me dy kriteret që kërkon neni 3 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se personi duhet të ketë njohuri dhe veprimtari të shquara në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe duhet të shquhet për aftësi profesionale. Ju keni një karrierë të pasur në shumë fusha, si në ekonomi, në menaxhim, në ndërmjetësim, në ligje, në emigracion etj. Jam e interesuar për periudhën kur keni shërbyer në Komisionin Kombëtar për Refugjatët. Sa kohë keni shërbyer në këtë funksion?

Pyetja e dytë është e njëjta që ia shtrova edhe kandidatës së parë. Çfarë do të bënit më mirë se është bërë deri më sot, nëse do të merrni mandatin nga Kuvendi i Shqipërisë për të qenë Avokate e Popullit?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju lutem, shkurt! Pyetjet ishin të gjata, por shpresoj që përgjigja të jetë e shkurtër.

Drita Avdyli – Faleminderit, zonja Hysi!

Unë kam qenë Komisionere Kombëtare për refugjatët dhe drejtoreshë për shtetësinë dhe refugjatët në vitet 2006-2013. Sigurisht, gjatë strategjisë që kemi bërë dhe gjatë punës që kam bërë një pjesë e punës sime kanë qenë të lidhura edhe me të drejtat e njeriut. Meqenëse isha pjesë e kësaj strukture në Ministrinë e Brendshme, kam zbatuar jo vetëm ligjet kombëtare, por edhe ato ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e tij, sidomos me të huajt që kanë ardhur në Shqipëri.

E dyta, nuk them se nuk është drejtuar mirë deri tani, por, nëse unë do të isha pjesë e treshes fituese të kandidatëve, ashtu sikurse theksova edhe më lart, vetëm dëgjimi i njerëzve dhe të qenit afër tyre apo takimet e shumta me institucionet do të bëjnë që këto ankesa dhe zgjidhjet e problemeve të jenë shumë të vogla.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Nuk ka pyetje të tjera.

Faleminderit, zonja Avdyli!

Fjalën e ka zonja Yllka Banushi, pas saj zonja Rezarta Bitri.

Përshëndetje! Siç jeni njoftuar, në këtë seancë dëgjimore duhet të paraqisni CV-në dhe platformën tuaj lidhur me kandidimin, por, ju lutem, të respektoni kohën, që është maksimumi 7 minuta.

Yllka Banushi – Faleminderit!

Përshëndetje, zoti kryetar!

Përshëndetje, të nderuar anëtarë të komisionit!

Jam këtu, ashtu siç e paraqiti edhe kryetari, për të prezantuar kandidaturën time për Avokat të Popullit. Kjo gjë për mua ka një rëndësi dhe një emocion të veçantë për shkak edhe të pozicionit si këshilltare ligjore që unë mbuloj prej pak kohësh në këtë komision.

Lidhur me eksperiencën që kam në fushën e drejtësisë, do të desha ta filloja me arsimimin tim. Jam diplomuar në vitin 2003 në drejtësi, i cili u pasua nga studimet master dhe doktoraturë

sërisht në fushën e drejtësisë, me një fokus specifik të drejtën kushtetuese. Kjo eksperiencë akademike më ka shërbyer për eksperiencën disiplinëshe të punës në fushën e të drejtave të njeriut, në fushën e administratës publike në bashkëpunim me ndërkombëtarët, që janë zhvilluar sipas një kronologjie të caktuar.

Në fushën e të drejtave të njeriut unë kam qenë aktiviste dhe drejtuese e një organizate e cila është fokusuar në mbrojtjen, advokimin, mbrojtjen procedurale të individëve dhe shtresave më të ekspozuara ndaj çështjeve të të drejtave të njeriut, të strehimit, të komunitetit rom, të lirisë shprehjes së gazetarëve etj. Angazhimi im ka qenë aktiv për një periudhë 5-vjeçare, 2008-2013. Kam qenë aktive në studimin e kazuseve ligjore, në mbrojtjen në gjykatat e të gjitha niveleve, duke përfshirë Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo eksperiencë është pasuar me angazhimin tim si këshilltare ligjore pranë prezencës së OSBE-së në Shqipëri në Departamentin e Shtetit Ligjor dhe të Drejtave të Njeriut. Edhe këtu u angazhova me të drejtat e njeriut me një fokus specifik, të drejtat e minoriteteve, ku kam pasur mundësinë të bashkëpunoj në mënyrë të rëndësishme dhe intensive me institucione shtetërore, me komunitetin ndërkombëtar, me shoqërinë civile dhe me vetë Avokatin e Popullit.

Për sa i përket eksperiencës në administratë, kam maturuar një njohje dhe i kam thelluar njohuritë e mia për administratën shtetërore, që e konsideroj një instrument shumë të domosdoshëm për platformën në të cilën operon Avokati i Popullit në ushtrimin e kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, pra një njohje nga brenda sesi funksionon administrata dhe instrumentet e saj.

Ky është në tërësi formimi im, i pasuruar edhe me një eksperiencë të mësimdhënies në nivel akademik, në lëndët e të drejtës kushtetuese, teknikës legjislative, historinë e shtetit të së drejtës, bazën e të drejtës, që e kanë pasuruar themelin mbi të cilin është orientuar edhe veprimtaria dhe eksperiencia ime e punës.

Për sa i përket platformës zhvillimore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, në rast se do të kisha shansin të zgjidhesha, ajo është një platformë e cila do të zhvillohej në bazë të katër shtyllave. Parësorja është shtylla kushtetuese, në dritën e ndryshimeve të reja kushtetuese, në kuadrin e reformës në drejtësi, të cilat kanë dashur që Avokati i Popullit të ketë një rol të shtuar si vëzhgues, garant i proceseve dhe i rëndësisë së tyre.

Shtylla e dytë është ajo e risive ligjore të dy vjetve më parë, të cilat besoj se ende duan kohën e tyre për t'u implementuar, që kanë shtuar kompetencat e Avokatit të Popullit, duke tentuar

t'i japin më shumë nisma, më shumë akses në organet shtetërore, specifkisht pranë Kuvendit dhe nënkomisioneve, duke i vendosur afate këtij të fundit për të shqyrtuar raportet e Avokatit të Popullit dhe duke i dhënë mundësi atij për të qenë prezent, publik me raportimet, në rast mos diskutimi në Kuvend.

Shtylla e tretë dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me disa përmirësime të veprimtarisë të mënyrës se si ajo mund të ushtrohet.

E para, ka të bëjë me përfshirjen e shtresave të caktuara, të cilat mendoj se nuk kanë pasur reflektim të thelluar si kategoritë e tjera, si çështja e minoriteteve, që kanë qenë shumë në fokus të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, por raste të sigurisë në punë, të marrëdhënies së punës, si rastet e raportuara rregullisht në medie, së minatorëve, naftëtarëve, mendoj mund të kishin qenë një fashë e cila mund të përfshihej, pra të kemi një gjithëpërfshirje të fashave të prekura nga veprimtaria e administratës qoftë edhe në mënyrë të tërthortë.

Gjithashtu, mendoj se duhet të ketë një shtrirje më kapilare të veprimtarisë së Avokatit të Popullit në nivel vendor, sepse edhe në raportet e tij rezulton se në nivel qendror ankesat janë të përqendruara kryesisht në Tiranë, kryesisht ndaj ministrive të linjës, ndërkohë që mendoj se problematikat shtrihen dhe nuk kanë arritur ende të përfaqësohen plotësisht nëpërmjet instrumenteve të Avokatit të popullit. Gjithashtu, mendoj se duhet rritet bashkëpunimi ndërinstytucional, që ka qenë mjaft i mirë. Standardet që ka arritur Avokati i Popullit deri më sot janë mjaft të mira, por mendoj se ka vend për përmirësim, sidomos me institucione analoge. Këtu i referohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku për shkak të ndryshimeve të reja ligjore ka disa interpretime sesi duhen ushtruar kompetencat nga këto dy institucione që ndërkohë funksionojnë në një platformë të përbashkët dhe duhet të ndërveprojnë, pavarësisht interpretimeve ligjore që ata mund t'u japin kompetencave të tyre. Kjo duhet të ketë edhe vizibilitetin e duhur, pra jo vetëm të jetë thelbësisht një marrëdhënie e ndërtuar, për qytetarin, për shoqërinë dhe është i interesuar për veprimtarinë e këtyre institucioneve.

Fatmir Xhafaj – Mendoj se është e mjaftueshme.

Yllka Banushi – Ky ishte thelbi.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Banushi!

A ka pyetje?

Po, zonja Hysi, një pyetje.

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë, por është edhe fusha që unë mbuloj në këtë komision dhe kam një pyetje.

Faleminderit, zonja Banushi, për prezantimin! Kam parë CV-n dhe kam ndjekur kontributin tuaj, por unë do të bëj një pyetje që jua kam shtruar edhe kandidatëve të mëparshëm. Në këto katër shtylla që ju përcaktuat në platformën tuaj, cilën do të rendisnit si hapin e parë, veprimi konkret që do të ndërmerrenit, nëse Kuvendi do t'ju votonte për të qenë Avokate e Popullit?

Yllka Banushi – Mendoj se prioritet duhet të jetë shtrirja kapilare e Avokatit të Popullit edhe në nivel vendor, sepse kjo nënkupton gjithëpërfshirje edhe të problematikave, përveçse të kategorive.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Banushi!

Yllka Banushi – Faleminderit ju!

Fatmir Xhafaj – Tani e ka fjalën zonja Bitri, pastaj e ka zoti Daci.

Zonja Bitri, mirë se keni ardhur! Keni paraqitur kandidaturën për Avokat të Popullit. Si jeni njoftuar, kemi vendosur rregullin që do t'i dëgjojmë të gjithë kandidatët në një kohë të barabartë prej 7 minutash për të paraqitur shkurtimisht CV-në, sepse është pjesë e dokumenteve, dhe platformën ose vizionin tuaj për këtë funksion të rëndësishëm. Ju lutem, respektoni kohën!

Fjala është për ju.

Rezarta Bitri – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë deputetë të komisionit,

Kam kënaqësinë të prezantoj para jush veten time përkundrejt kërkesës për kandidim për këtë pozicion të nderuar kushtetutes të Avokatit të Popullit. Pa humbur kohë, më lejoni të bëj një prezantim të shkurtër në nivel personal.

Quhem Rezarta Bitri. Jam e martuar dhe jam nënë e dy fëmijëve. Jam lauruar me diplomën e juristit në vitin 2000 me informim të thelluar akademik me postgradimin tim në shkollën pasuniversitare pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës, sigurisht duke avancuar më tej edhe me përmbylljen e gradës shkencore “Doktor në shkencat juridike” në sferën publike-administrative. Sigurisht që formimi im akademik ka ecur në koherencë të plotë dhe përkrahë zhvillimit të një karriere 16-vjeçare, e cila më jep sot një shtysë shumë të madhe për të qenë këtu për të pasur këtë ambicie dhe për të pretenduar pozicionin e Avokatit të Popullit.

Për hir të së vërtetës, kam pasur fatin të ndaj një eksperiencë disavjeçare në Ministrinë e Drejtësisë, ku kam punuar 9 vjet dhe në një nga strukturat më të nderuara juridiko-profesionale në të gjithë pushtetin ekzekutiv, veçanërisht në këtë ministri. Bëhet fjalë për Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit, ku jam formuar dhe kam zhvilluar një karrierë solide në drejtim të formimit tim ligjor, një ekspertizë e mirëfilltë, e cila ka ecur në mënyrë progresive dhe hap pas hapi, duke nisur nga studimet e mirëfillta juridike, analizat dhe rekomandimet institucionale, hartimi i legjislacionit, pjesëmarrja në oponentat e qindra akteve të prodhuara nga veprimtaria e pushtetit ekzekutiv. Pa diskutim që kjo është një shtyllë e fortë, e cila më ka dhënë një anë shumë të fortë për të qenë këtu përpara jush sot, një *background* ligjor shumë dimensional, pjesë e së cilës janë edhe aktet ligjore, duke filluar nga kodet, nga aktet dhe instrumentet ndërkombëtare, që janë pjesë e drejtës sonë të brendshme, që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Sigurisht, ka qenë edhe një eksperiencë e mirëfilltë administrative me një fokus dhe një njohje nga afër të administratës. Kam pasur nderin dhe shansin të bashkëpunoj me titullarë juristë ndër vit të dimensioneve dhe profileve të spikatura, gjë që më ka orientuar më së miri për të thithur dhe për të zhvilluar një karrierë administrative të spikatur. Përpos kësaj, ndihem përsëri me fat, sepse karriera ime ka evoluar në strukturat e gjyqësorit në një pozicion dhe në një këndvështrim tjetër nga ai fillestar dhe disavjeçar. Kam një eksperiencë të fokusuar në nivel menaxhial në Gjykatën e Lartë, një dimension që, për hir të së vërtetës, është mjaft i vlefshëm që më ka kompletuar dhe më ka dhënë një kriter shtesë në ekspertizën time për t'i parë çështjet e të drejtave të njeriut nga një profil tjetër dhe në raport të drejtpërdrejt me qytetarin. Sigurisht kam një ekspertizë tjetër ligjore të fituar në Gjykatën Kushtetuese, që krijon një shumëplanësh profesional për mua si juriste, pasi kam pasur aksesin për të dhënë këshillime të drejtpërdrejta në Gjykatën Kushtetuese për çështjet dhe kërkesat e paraqitura, sidomos për shkëljen e të drejtave të njeriut. Kjo ishte një panoramë e përgjithshme, sepse për hir të kohës unë nuk mund të ndalem në detaje të mëtejshme. Ndoshta, nëse do të jetë e nevojshme, ju anëtarë të nderuar, mund të kërkonj dhe unë pa hezitim mund t'ju jap informacione shtesë. Lë të themi që ky jetëshkrim e bën kërkesën time solide.

Aktualisht asistoj në platformat qeveritare, në reformën e shërbimeve publike dhe reformën e dixhitalizmit si këshilltar Juridike në Ministrinë e Inovacionit. Jam ende duke zhvilluar karrierën time. E drejta për ta zhvilluar këtë karrierë më bën sot të kem ambicien për të prezantuar diçka më shumë për institucionin kushtues dhe pozicionin e nderuar të Avokatit të Popullit.

Për sa i përket platformës, vizionit apo komponentëve ato që do të doja të prezantoja mund të jenë shumë, por unë do të ndalem te shtyllat kryesore dhe paraprake, sepse duhet një platformë e mirëfilltë apo një program ambicioz për ta drejtuar këtë institucion, sigurisht, nëse do të kem shansin, fatin dhe vlerësimin tuaj të jem në krye të këtij institucioni, të cilin do ta zhvilloj më tej dhe do të mbështes një konsultim të gjerë të brendshëm institucional, por edhe të jashtëm me faktorë të tjerë.

Gjithsesi, institucioni i Avokatit të Popullit është padiskutim një institucion kushtetues, i cili është realitet në sistemin tonë të brendshëm, ka një lloj konsolidimi, është një institucion që nuk krijohet sot për herë të parë dhe as për mua nuk është hera e parë që vij për drejtimin e këtij institucioni. Ai ka një histori, traditë, kuadër rregullator, tashmë të konsoliduar, i cili buron që nga Kushtetuta dhe pastaj në akte detyesore ligjore, ka një profil dhe një historik administrativ dhe sigurisht që kjo nga ana ime kërkon një angazhim akoma më strategjik, më vizionar për të çuar më tej gjithçka që ka ardhur deri më sot nga kontributi real i institucionit të Avokatit të Popullit.

Unë nuk dua të ndalem shumë në detaje, por vizioni im dhe ajo që duhet të arrij është mirëqeverisja. Fokusi im për këtë institucion konsiston në një kontribut proaktiv dhe konkret për të ndikuar në mirëqeverisjen e institucioneve shtetërore, në konsolidimin e një kulture të mirëfilltë administrative.

Mbrojtja e të drejtave është çështja kryesore në fokus të këtij institucioni, por do të doja që të krijoja një balancë midis mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por njëkohësisht edhe për t'u dhënë institucioneve shtetërore shansin për të pasur një bashkëpunëtor solid, në mënyrë që performanca e tyre të arrijë nivele të kënaqshme dhe pretendimet e qytetarëve, ankesat për cenim të të drejtave të njeriut të vijnë duke u minimizuar. Pra, fokusi im do të jetë instalimi, konsolidimi dhe përpjekjet e vazhdueshme ndërvepruese për të rritur kulturën institucionale në kuadër të veprimtarisë të institucioneve shtetërore. Sigurisht që mbrojtja, prioritetet aktuale dhe kategoritë vulnerabel do të jenë në fokus të punës sime, por do të doja që të sillja në vëmendje të këtij paneli të nderuar një çështje shumë sensitive.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem përmbledheni, sepse mbaruan 7 minutat tuaja.

Rezarta Bitri – Në fokusin tim, pra në prioritetet e prioriteteve, duke marrë spunto nga aktualiteti dhe fenomenet, të cilat shoqërojnë zhvillimet tona të brendshme, do të kem në vëmendje fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 18 vjeç. Gjithsesi, vizioni im do të ketë objektiva për t'u përmbushur dhe sigurisht që do të shoqërohen me planveprime dhe veprime konkrete.

Dua të sjell në vëmendje një elaborim të instrumenteve. Një nga pikat kryesore të planveprimit tim do të jetë ndërveprimi me institucionet, me qytetarët dhe lehtësimi i mënyrave të komunikimit, pa anashkaluar edhe zhvillimet e mëdha teknologjike dhe statusin në të cilin sot synojnë të kalojnë të gjitha shërbimet që ofron administrata publike me forma të reja teknologjike. Sigurisht që këtë fokus dua ta kem edhe në fokus të veprimtarisë sime si një dimension të ri.

Fatmir Xhafaj – Dakord, faleminderit!

A kanë kolegët pyetje? Nuk ka.

Kam unë një pyetje. Cila është ajo gjë që do të donit të bënit ndryshe nga ajo çfarë është bërë deri sot nga institucioni i Avokatit të Popullit?

Rezarta Bitri - Ajo që do të bëja ndryshe është një qasje konkrete, e cila është shërbimi i afërt me qytetarin, asistencë me qytetarin dhe shërbim për qytetarin. Strukturat e Avokatit të Popullit do të doja t'i sillja në terren dhe një lloj delegimi në të gjithë territorin për atë që është e mundur, për të qenë më afër rolit aktiv. Pra, kjo do të ishte një nga pikat kryesore të miat për të avancuar dhe për të sjellë diçka ndryshe.

Fatmir Xhafaj – Dakord, faleminderit!

Mesa shoh, pyetje të tjera nuk ka.

Zonja Bitri, shumë faleminderit që ishit e pranishme.

Rezarta Bitri – Faleminderit të gjithëve për vëmendjen dhe durimin!

Mirupafshim!

Fatmir Xhafaj – Zoti Jordan Daci, mirë se keni ardhur!

Ju keni paraqitur kandidaturën për Avokat Populli. Natyrisht, ju keni CV-në tuaj dhe pa dyshim këndvështrimin, qasjen dhe qëllimet që keni hyrë në këtë garë dhe që mendoni se ju bëjnë të përshtatshëm për të kryer këtë funksion kaq të rëndësishëm, siç është funksioni i Avokatit të Popullit.

Siç ju kemi njoftuar, keni 7 minuta kohë në dispozicion për të prezantuar shkurtimisht CV-në tuaj, megjithëse ajo është e njohur nga dokumentet që keni sjellë për ne, por kjo bëhet për interesin e publikut.

Së dyti, pikat kryesore të vizionit tuaj për funksionin e Avokatit të Popullit.

Ju lutem, respektoni kohën 7 minuta, sepse kemi mbajtur të njëjtin qëndrim me të gjithë kandidatët e tjerë dhe kjo është seancë e hapur mediatike.

Zoti Daci, fjala për ju!

Jordan Daci – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë,

E nderuar profesoreshë,

Më lejoni ta dalloj nga të tjerët, sepse e kam pasur profesoreshë që nga fakulteti deri kur kam marrë titullin profesor.

Së pari, ju falënderoj për mundësinë që po më jepni. Sapo u shpërndava platformën time të printuar, duke qenë se koha është e limituar, nuk doja të humbisja kohë.

Një prezantim të shkurtër të CV-së sime. Për fatin tim të mirë, qëkur kam filluar karrierën time si jurist deri tani jam marrë me të drejtat e njeriut. Kam mbaruar studimet shkëlqyeshëm në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, kam bërë studimet master në Universitetin e Bolonjës dhe të Sarajevës për të drejtat e njeriut. Në vitin 2010 kam mbaruar studimet e doktoratës me vlerësim shkëlqyeshëm në fushën e të drejtës publike, kushtetuese dhe së fundi kam marrë titullin profesor i asociuar, ndërkohë që titullin avokat e kam marrë në vitin 2004. Krahas shkollës, kam bërë një sërë kursesh dhe kualifikimesh, të cilat janë të lidhura posaçërisht me fushën e të drejtave të njeriut.

Për sa i përket përvojës në punë, ajo është shumë e gjerë dhe kryesisht ka qenë e ndryshueshme, por që ka qëndruar gjithmonë e lidhur me të drejtat e njeriut.

Fillimisht kam punuar në Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë; anëtar i grupit të punës për konventat e OKB-së; kam punuar në komitetin ndërministror për luftën kundër trafikëve; kam filluar punë si këshilltar ndërkombëtar në qeverinë e Kosovës në kuadër të misionit ndërkombëtar në atë kohë dhe më vonë në institucionet qeverisëse; kam qenë raportues special për OSBE-në në vitin 2009, sa i përket pavarësisë së gjyqësorit; në vitin 2008 kam qenë bashkëvlerësues i ekipit për indeksin e formës gjyqësore të Dhomës Amerikane të Avokatëve; kam kryer detyra si këshilltar i kryetarit të Gjykatës së Lartë, këshilltar i ministrit të Financave, i ministrit të Energjetikës dhe Ekonomisë në vitin 2012; jam autor i reformës legislative në fushën e inspektimit të vitit 2012, si edhe autor i disa teksteve të akteve ligjore dhe nënligjore në Kosovë dhe Shqipëri, duke përfshirë edhe raportet ndërkombëtare.

Për sa u përket të drejtave të njeriut, që nga viti 2004 dhe në vijim jam profesor dhe autor i tekstit të kësaj lëndë dhe kam rreth 34 botime, kryesisht në revistën ndërkombëtare, të cilat janë të cituara në mbarë botën, ku pjesa më e madhe i përkasin fushës së të drejtave të njeriut.

Për sa i përket përvojës, kam fituar edhe çmime ndërkombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut, ku çmimi i fundit ka qenë në vitin 2014 nga organizata e mirënjohur *International Bridges to Justice*, i cili ka qenë një konkurs ndërkombëtar pikërisht për të drejtat e njeriut. Praktikisht e gjithë karriera ime, duke përfshirë edhe karrierën time si avokat, e cila përfshin gjithçka, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Strasburgut, ka qenë e përfshirë te lëmi i të drejtave të njeriut, sigurisht edhe ligjit.

Unë besoj se Kuvendi do ta shqyrtojë me gjithë kujdesin e nevojshëm kandidaturën time. Platforma ime përfshin disa pika, e grupuar në katër grupe, ku sigurisht grupi i parë është miradministrimi, ligjshmëria dhe përgjegjshmëria; rritja e cilësisë dhe përmbushja e detyrave të plota të avokatit; grupi i dytë është bashkëpunimi me administratën, shoqërinë civile dhe avokatët e huaj; grupi i tretë është rritja e besimit dhe përfshirjes së publikut, ndërgjegjësimi dhe transparenca.

Referuar raporteve të pavarura dhe të institucioneve shqiptare, kam bërë edhe një analizë të gjendjes aktuale të institucionit të Avokatit të Popullit, por që ajo zë më pak vend se pjesa tjetër.

Ajo çfarë mendoj si sfidë për këtë institucion është rifitimi i besimit të publikut, mjafton që t'u referohemi statistikave, ku gati 60% e ankesave nuk pranohen për shkak se janë jashtë juridiksionit, ç'ka tregon se publiku nuk e di ende të saktë se cila është puna që duhet të bëjë Avokati i Popullit.

Nga ana tjetër mendoj se kompetencat e reja kushtetuese kërkojnë jo vetëm një profesionalizëm, por edhe një maturi në ushtrimin e tyre, konkretisht të drejtën për të vënë në lëvizje si subjekt të përgjithshëm Gjykatën Kushtetuese. Mendoj se Avokati i Popullit duhet të përqendrojë punën tek trajtimi i çështjeve me ndikim të përgjithshëm dhe jo specifik, mundësisht sa më të gjerë, por nga ana tjetër këto kompetenca kushtetuese, të cilat janë dhënë pikërisht në kuadër të reformës në drejtësi, si një konsensus i madh historik, mendoj se kërkojnë edhe maturinë e nevojshme, sepse do ta ekspozojnë Avokatin e Popullit para një kequshtrimi të detyrës. Pra, besoj se ekuilibri midis këtyre dy elementeve duhet të ketë një vëmendje e posaçme.

Është e nevojshme të theksohet se historia e Avokatit të Popullit nuk do të fillojë as me mua, nëse do të jem unë ai që do të zgjidhem, as me të tjerët, por është e rëndësishme që të ruhet ajo ç'ka Avokati i Popullit ka siguruar dhe ka arritur gjatë këtyre vjetëve si institucion dhe mendoj se duhet të shndërrohet në institucion, i cili të jetë model reference kombëtare për gjithçka që i takon rolit që parashikohet të ketë ky institucioni kushtetues.

Nëse unë do të përzgjidhem, një fushë që do të kishte vëmendje të madhe do të ishte ndihma dhe qenia e një avokati jokonfliktual, por konstruktiv. Unë nuk e mendoj Avokatin e Popullit në opozitë me administratën, por partner me administratën në zbatimin e ligjit. Nuk dua që Avokati i Popullit të nxjerrë vetëm rekomandime, por të punojë në atë formë që të realizojë përmbushjen e tyre. Një Avokat Populli, i cili ankohet për shkeljen apo mosrespektimin e të drejtave të tyre nuk mendoj se do të kishte besimin e publikut dhe mbi të gjitha, vendosja e një partneriteti, sidomos me Kuvendin është një domosdoshmëri dhe prioritet absolut.

Unë kam hyrë në këtë garë me një besim të palëkundur se Kuvendi me reformën e madhe të sistemit gjyqësor që bëri, ka treguar dhe jam i bindur që do të tregojë maturinë në përzgjedhjen e kandidaturës së duhur dhe duke respektuar kriteret ligjore.

Çështje të tjera, të cilat do të merrnin përsëri vëmendjen në kuadër të Avokatit të Popullit janë çështjet e miradministrimit, të përmirësimit të cilësisë së punës, cilësisë së botimeve, sigurisht rritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore, si aseti kryesor i vetë Avokatit të Popullit.

Në kuadër të ligjeve, iniciativa ligjvënëse nëse do ta quajmë kështu, është një instrument i cili duhet të përdoret me shumë kujdes, por që do të ishte një instrument shumë i dobishëm në funksion të përmbushjes së detyrave të Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem konkludoni, sepse ka mbaruar koha.

Jordan Daci – Për ta përmbyllur, unë e kam paraqitur me shkrim.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Jam i hapur për çdo lloj pyetje dhe besoj se, nëse do të kem besimin tuaj, do ta justifikoj atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Daci, për praninë, për prezantimin dhe për dokumentacionin shumë të mirë që keni vënë në dispozicion të komisionit.

Ka pyetje?

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Zoti Daci, në platformën që na keni shpërndarë, në pjesën kur flitet për gjendjen e tanishme në institucionin e Avokatit të Popullit në pikën 10 shpreheni se sipas një raporti të *Transparenc International* lidhur me vlerësimin e sistemit kombëtar të integritetit të Shqipërisë rezulton se Avokati i Popullit shfrytëzon vetëm 50% të kapaciteteve që disponon sot,

ka shkallë të ulët integriteti, pavarësie dhe përgjegjshmërie në masën minus 25%, ka një qasje tepër burokratike dhe ekziston fenomeni i nepotizmit, gjithmonë duke cituar raportin tuaj.

Në rast se ju do të mandatoheni nga Kuvendi për të qenë në krye të këtij institucioni, çfarë keni menduar për të arritur shkallën e integritetit, pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe për të eliminuar fenomenin e nepotizmit në këtë institucion?

Jordan Daci – Faleminderit për pyetjen!

Unë kam kopje të raportit dhe mund t'ia vë në dispozicion komisionit. Pa vënë në diskutim vërtetësinë, sepse nuk jam në pozita për ta gjykuar vërtetësinë e tyre në këtë pjesë, po gjëja e parë që do të bëj është vlerësimi i situatës aktuale, pra unë nuk do të mjaftohem vetëm me një raport, sepse nuk do të ishte serioze nga ana e një të sapozgjedhuri të bazohet vetëm në një raport për të marrë vendime që i takojnë kësaj sfare. Absolutisht, për sa i përket vënies në efikasitet, do të bëhet menjëherë plotësimi i vendeve vakante, ku është një nga problemet që theksohet atje.

Problem tjetër janë rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat, pa dyshim që duhet të zbatohen me urgjencë, sepse janë edhe detyrim ligjor. Ka probleme lidhur me administrimin financiar dhe ligjit për menaxhimin buxhetor. Gjëja e parë që duhet të bëhet është analiza e situatës aktuale, rishikimi i nevojave dhe sigurisht zbatimi i plotë i ligjit për sa i përket nëpunësit civil dhe zbatimit të kriterëve strikte. Nëse unë do të kem fatin të jem në krye të këtij institucioni, ju garantoj dhe ju premtoj që do të mundohem të jem model për sa u përket emërimeve larg çdolloj nepotizmi. I vetmi orientim për mua do të jetë profesionalizmi dhe integriteti i personave, ashtu siç mendoj që i kam edhe vetë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Daci!

Zonja Hysi e ka fjalën

Vasilika Hysi – Faleminderit për prezantimin dhe platformën!

Mua më lindin shumë pyetje për të bërë, por unë po bëj vetëm dy.

Së pari, ju thoni se në rritjen e transparencës së institucionit dhe përfshirjes së publikut nuk do të ketë axhendë personale, por institucionale.

Së dyti, do të rritet transparenca e plotë e deklaratës konflikt interesi të stafit dhe të vetë Avokatit të Popullit krahas ILDKPI-së dhe në faqen e Avokatit të Popullit.

Ku e bazoni këtë gjë?

Jordan Daci – Konkretisht bazohem në raportin i *Transparence of International*, i cili është raport i dhjetorit të vitit 2016 dhe në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Praktishtë unë

kam pasur fatin të kem qenë subjekt i deklaramit në ILDKPDI dhe jam i gatshëm t'i nënshtrohem çdolloj kontrolli dhe rikontrolli të mëtejshëm dhe në radhë të parë kjo bazohet te vetë transparenca që vetë institucioni bën. Kur unë po kërkoja raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ai ishte zhdukur dhe nuk ekzistonte as te *website*-en i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe as te *website* i Avokatit të Popullit, pavarësisht se ekzistonte si *link*, por që nuk të çonte askund. Unë mendoj se ndërveprimi i institucionit të Avokatit të Popullit me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe me Inspektoratin e Deklarimit të Pasurive është i domosdoshëm dhe duhet të jemi vetë modeli. Unë ajo çfarë premtoj dhe e bazoj është te gjetjet, të cilat janë të thëna. Mungesa e transparencës është bërë edhe nga anëtarët e këtij komisioni të nderuar, edhe në debatet që ka pasur. Mjafton të marrim shembull që Avokati i Popullit nuk ka raportuar asnjëherë në Kuvend, i cili është detyrim ligjor që ai duhet ta bënte. Raportimi dhe vendosja e një raporti të përhershëm me Kuvendin, qoftë edhe pa kërkesë, por duke i mundësuar informacione të përhershme, është pjesë dhe kërkesë e domosdoshme e integritetit të këtij institucioni.

Konkretisht, për sa u përket edhe gjetjeve që janë në këto raporte, i paraqesin këto probleme. *Website* i Avokatit të Popullit apo vetë komunikimi që Avokati i Popullit do të ketë me publikun duhet ta ketë parasysh dhe ta ketë prioritet edhe këtë element, sepse duhet të jetë shembull për të gjitha institucionet e tjera.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se nuk kemi pyetje të tjera.

Zoti Daci , faleminderit dhe gjithë të mirat!

Jordan Daci – Ju falënderoj për mundësinë!

Fatmir Xhafaj – Kandidati tjetër, zoti Kastriot Frashëri. Zoti Frashëri, ju keni paraqitur kandidaturën për Avokat Populli, përmes kërkesës suaj keni aplikuar dhe keni paraqitur edhe dokumentacionin.

Siç jeni njoftuar, keni jo më shumë se 7 minuta kohë për të prezantuar CV-në dhe vizionin tuaj lidhur me këtë funksion të rëndësishëm, kohë që është respektuar nga të gjithë kandidatët paraardhës.

Fjala për ju.

Kastriot Frashëri –Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të përpiqem ta respektoj në maksimum kohën.

Të nderuar zotëriinj deputetë,

Nuk dua të zgjatem shumë me diskutimin tim, sepse shumica e deputetëve më njohin. Unë jam prezent në jetën publike që prej viteve '90 e deri më sot me një aktivitet të spikatur dhe të njohur. Veprimtaria ime është pasqyruar në qindra faqe në media dhe nuk besoj se nuk janë pasqyruar vetëm dy fjalë “Farshëri maskara, hajdut apo bandit”. Unë vetëm kam mbrojtur interesin publik, interesat kombëtare të vendit. Në mendjen time dhe në idetë e mia kam pasur pronar vetëm Shqipërinë dhe interesin kombëtar, pjesë e genit të cilin unë përfaqësoj.

Në këtë proces u futa për t'i dhënë një integritet këtij procesi, pasi e gjykoj dhe e vlerësoj shumë që institucionet kushtetuese të vendit në krye të tyre duhet të drejtohen nga njerëz që kanë jo vetëm integritet profesional, por edhe moral, njerëz të cilët i kanë dhënë shoqërisë dhe duhet t'i japin. Shpresoj në gjykimin dhe në votën e zotërinjve të nderuar deputetë, sepse kam 25 vjet veprimtari publike, në të cilat kam qenë prezent në shumë sipërmarrje, kam mbrojtur interesin publik, të drejtat dhe liritë kushtetuese të shtetasve, kam shkruar, kam përfaqësuar individët si avokat i tyre në organet e drejtësisë, është bërë edhe publike që 80% të çështjeve i kam bërë falas, edhe pse unë mund të isha biznesmen, por kam mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe faktet janë të mirëpasqyruara dhe më vjen mirë që në memorien historike të vendit këto më bëjnë nder jo vetëm mua, por kujt do që do t'i kishte. Më falni, sepse ndoshta duket si mungesë modestie, por këtu jemi për të prezantuar CV-në tonë se nga vijmë dhe çfarë kërkojmë të bëjmë.

Meqenëse zotërinjtë kanë kërkuar një platformë në lidhje me synimet që unë kam, nëse parlamenti do të më japë votëbesimin për të drejtuar këtë institucione të rëndësishëm, unë po paraqes shkurt synimet e mia.

Në radhë të parë, unë do ta kthej menjëherë institucionin e Avokatit të Popullit te populli, kjo nuk është populiste, por unë e vlerësoj dhe e di që ky institucion është vlerësuar edhe nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare në nivelin “a”, edhe nga parlamenti, por që unë e kam pasur gjithmonë prioritet, duke punuar për interesa më të gjera.

Lidhur me realizimin e këtij qëllimi, unë kam menduar që të fokusohem në 5 drejtime.

Në radhë të parë do të fokusohem në marrëdhëniet me parlamentin, veçanërisht me Komisionin e Ligjeve, që kemi marrëdhënie të drejtpërdrejtë.

Si Avokat i Popullit synoj të ngre në nivel më të lartë komunikimin me Kuvendin, me synimin që të jem më prezent dhe të dëgjohem për çështje që ne i çmojmë si të rëndësishme, bazuar edhe në nenin 6 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Do të përpiqem të konsolidoj autoritetin e institucionit të Avokatit të Popullit përmes ndërmarrjes së veprimeve ligjore në përputhje me të drejtat e parashikuara në nenin 21.

Do të shfrytëzoj të drejtën e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative, jo vetëm ku do të konstatoj se përmbajtja e ligjit apo e akteve të tjera normative bien ndesh me Kushtetutën, kjo bazuar në kompetencat që jep ligji, siç është neni 24 i ligjit, por do të punoj me përkushtim për të bërë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve.

Do të trajtoj me shumë prioritet çdo rezolutë të parlamentit me synim kryesor rritjen e performancës së institucionit të Avokatit të Popullit.

Do të punoj me përkushtim për vendosjen e marrëdhënieve të mira të komunikimit, edhe me komisionin tuaj, të cilin e thashë më parë.

Lidhur me marrëdhëniet me qeverinë dhe administratën publike, do të punoj me përkushtim për të bërë propozime ndaj organeve të administratës për ndryshimin dhe përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Do të punoj për të siguruar dhe për të përforcuar nismën e Avokatit të Popullit për të ndërmarrë qëllime inspektimi apo studimi në lidhje me funksionimin e sektorit të shërbimeve publike, pasi, duke pasur një karrierë të gjatë, unë i di shumë mirë problemet e administratës publike dhe do të përpiqem që këto gjëra të eliminohen, sepse këto janë burimi i korrupsionit, i shkeljes të të drejtave të njeriut dhe realizimit të të drejtave të shtetasve.

Do të organizoj trajnime me sektorët e administratës publike që ofrojnë shërbime publike, pasi ne shohim që ka një problem të madh me ndryshimet e mëdha të qeverisë, sepse ndryshojnë organigramat e institucioneve dhe sa t'ia marrim dorën punës duhet kohë e gjatë, ndërkohë që janë qytetarët që e paguajnë.

Do të punoj me përkushtim për forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet e tjera të shtetit dhe me organizatat joqeveritare.

Një nga synimet e mia do të jetë edhe reformimi i institucionit të Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem përmbledheni, sepse mbaroi koha.

Kastriot Frashëri – Për sa i përket reformimit, do të synoj që ta kthej këtë institucion në një vëzhgues të veprimtarisë së administratës publike, duke kontribuar për një qeverisje të mirë.

Do të punoj së bashku me komisionerët, që të përmirësoj rregulloren e brendshme dhe strukturën organizative të institucionit.

Do të përmirësoj sistemin e ankimimit përmes ankesave *online*.

Nëse do të zgjidhem Avokat i Popullit, do të propozoj menjëherë dy komisionerët që nuk janë zgjedhur prej më shumë se dy vjetësh, si edhe do të realizoj detyrimet ligjore të ngarkuara nga ligji, në lidhje me procedurat e zgjedhjes së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorisë, që përfaqëson shoqërinë civile.

Do të punoj në mënyrë të ngushtë në marrëdhënie me institucionet e tjera dhe Gjykatën Kushtetuese për ridimensionimin e marrëdhënieve dhe do të vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për nisma legjislativë, si edhe do të punoj në mënyrë të ngushtë me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shoqërinë civile dhe me median.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Frashëri!

Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Hysi .

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Edhe platforma juaj është interesante dhe konstatoj se i njihni mirë të gjithë kandidatët dhe pikat e forta dhe të dobëta të këtij institucioni.

Kam një pyetje lidhur me reformimin e institucionit të Avokatit të Popullit nga pikëpamja e infrastrukturës. Ju thoni që do të jeni në komunikim me stafin dhe do të përmirësoni marrëdhëniet me stafin dhe do të bashkëpunoni me komisionerët për të përmirësuar rregulloren e brendshme dhe strukturën organizative të funksionimit të këtij institucioni. Çfarë keni konstatuar ju që jepni këto dy rekomandime?

Kastriot Frashëri – Sepse unë kam 15 vjet që drejtoj një institut të pavarur që është Instituti i Çështjeve Kombëtare dhe kam pasur vazhdimisht kontakte bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit dhe në seksionet që ata kanë, të cilat nuk kanë qenë shumë eficiente në veprimtarinë e tyre. Unë them që të bëj një riorganizim të brendshëm brenda strukturës që lejon ligji dhe me shkuarjen time atje të ketë një imazh të ri, i cili, në fund të fundit, do t'i shërbej edhe mirëqeverisjes, sepse është administrata publike që i shkakton këto probleme dhe janë ata që i drejtojnë njerëzit nëpër gjykata apo pranë Avokatit të Popullit.

Faleminderit, zonja Hysi!

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera?

Jo, nuk ka.

Faleminderit zoti Frashëri.

Zoti Goxhaj e ka fjalën.

Përshëndetje, zoti Altin Goxhaj!

Ju keni paraqitur kandidaturën për Avokat të Popullit, si edhe dokumentet përkatëse sipas kërkesave që ka ligji.

Sot zhvillohet kjo seancë dëgjimore për t'ju dëgjuar ju dhe kandidatët e tjerë lidhur me CV-në dhe platformën tuaj. Kemi përcaktuar një minutazh prej 7 minutash prej secilin nga kandidatët për të bërë këtë prezantim, pastaj fillojmë me pyetjet e deputetëve.

Zoti Goxhaj, mund të filloni.

Altin Goxhaj – Përshëndetje!

Fillimisht unë kam sjellë dy deklaratat që janë kusht për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, për të mos qenë anëtar i partive politike dhe organizatave politike, si edhe të mos ketë konflikt interesi.

Fillimisht dua të bëj me dije komisionin që para një ore kam dorëzuar nëpërmjet postës në Gjykatën Administrative Tiranë një kërkesë padi për marrjen e masës së sigurimit të padisë të pezullimit të vendimit nr.3, datë 28.12.2016 të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe pasojave të tij deri në një vendim të formës së prerë.

Së dyti, shpallin absolutisht si të pavlefshëm vendimin nr.3, datë 28.12.2016 të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe pasojat që kanë ardhur prej këtij vendimi, domethënë kam kërkuar shpalljen të pavlefshëm të shpalljes së garës që ju keni bërë në datën 28.12.2016 në kundërshtim me Rregulloren e parlamentit dhe ligjin “Për Avokatin e Popullit”, pasi nuk është kompetencë e Komisionit të Ligjeve që të marrin një vendim tjetër.

E bëra këtë hyrje paraprakisht për t'ju bërë me dije se platforma ime duhet të ishte sot vetëm përballë dy platformave të tjera dhe pasi të kualifikoheshim, nëse plotësonim kriteret ligjore, të mblidheshin 28 firmat, të shkonin në parlament dhe nëse nuk votoheshin, mund të shpallej një garë tjetër nga Kuvendi dhe jo nga Komisioni i ligjeve.

Unë jam Altin Goxhaj, kam 27 vjet që jam aktivizuar në shoqërinë civile dhe në aktivizimin qytetar, që nga viti 2008 ushtroj profesionin e avokatit në formë të licencuar, por që e kam ushtruar në formë administrative që nga viti 2005 si avokat konsumatorësh pranë shoqërisë civile. Gjatë viteve 1992-2017 kam qenë i angazhuar në punë shtetërore, në administratë publike

për dy muaj, plus një muaj në pritje të zëvendësimit pasi kam dhënë dorëheqjen në Bashkinë e Tiranës, në kohën kur ka qenë kryetar Lulzim Basha, kam qenë konsulent për ngritjen e Agjencisë së Konsumatorëve dhe kam ushtruar detyrën për të ndërtuar zyrën e Avokatit të Qytetit dhe më pas kam dhënë dorëheqjen. Kjo është eksperiencia ime në administratën publike.

Në vitet 1988-1992 kam studiuar për filozofi dhe sociologji. Kam mbaruar arsimin juridik në vitet 1992-1997. Kam mbaruar arsimimin në Punët Sociale si specializim pasuniversitar në vitet 1992-1993. Kam mbrojtur gjuhën angleze dhe italiane në vitet 1995-1996. Aktualisht kam licencën e avokatit të dhënë nga Dhoma e Avokatisë Tiranë, duke e ushtruar këtë profesion që nga viti 2014 si profesion privat. Kam qenë i angazhuar në parti politike në vitet 1990-1993 pranë Partisë Demokratike dhe që nga viti 1993 deri sot nuk kam qenë i angazhuar në çdo lloj formacioni politik. Nga vitet 1992-1994 kam qenë një nga drejtuesit e federatës së Rinisë Shqiptare. Nga vitet 1992-2005 jam aktivizuar në një organizatë që merrej me studime sociale në formë sociologjike. Nga vitet 1994-2005 kam qenë një nga drejtuesit dhe themeluesit kryesor e Këshillit Rinor Shqiptar, organizatë *ombrellë* e shoqatave joqeveritare rinore të asaj kohe. Nga vitet 1995-2013 kam drejtuar zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorëve, si një shoqatë joqeveritare. Prej viteve 1998-2010 kam pasur biznes privat të shitjes së motosharrave, i cili u mbyll pas një presioni dy-vjeçar nga Bashkia Tiranë, si pasojë e protestave që ne bëmë, ku unë hodha në gjyq bashkinë për gjokat e paligjshme që vinin dhe e kam fituar gjyqin në shkallë të parë, të dytë dhe të tretë. Prej viti 2010-2014 kam qenë i angazhuar në projekte të ndryshme, bashkëpunime të ndryshme dhe kam siguruar burimet e jetesës nëpërmjet aktivizimit si ekspert i jashtëm. Që nga viti 2014 drejtoj një biznes privat.

Platforma ime e Avokatit të Popullit quhet kundër diktaturës së oligarkisë sorosiane. Bazuar në këtë situatë reale, Shqipëria sundohet nga një kasë kontrolluese e kultivuar dhe e frymëzuar nga politika të kulteve sorosiane për 25 vjet, e përkufizuar si oligarkia sorosiane, e cila deri dje ka luajtur një rol të rëndësishëm për ndërtimin e sotshëm të një oligarkisë sorosiane dhe për këtë arsye platforma e Avokatit të Popullit përcaktohet si një platformë në përgjigje të këtij realiteti. Kjo platformë ka qëllim kryesor për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të diktaturës së oligarkisë sorosiane. Në këtë platformë unë synoj këta objektiva: denoncimin dhe kundërvënien ligjore brenda kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj një regjimi frikës, shtypës dhe totalitar, që synon kontrollin e çdo segmenti të demokracisë dhe shtetit ligjor, duke unifikuar në një kontroll të vetëm të gjitha pushtetet ku ka vakum të *check and balance* të ngjashëm **IU-në**

diktatoriale me fasadë demokratike të kuruar nga *network*-u sorosian brenda dhe jashtë Shqipërisë. Informimin e institucioneve ndërkombëtare, sidomos ato amerikane për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe përpjekjes së një pushteti të oligarkisë sorosiane për shkretimin dhe shkatërrimin e Shqipërisë dhe të shtetit dhe bashkëpunimi me to për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe shtetit ligjor brenda kompetencave të Avokatit të Popullit. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore ndaj kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj degradimit dhe rrënimit të shtetit dhe demokracisë, ekonomisë, shoqërisë, familjes dhe moralit. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore ndaj kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj korrupsionit total të koordinuar dhe hierarkik, sipas një skenari të qartë të grabitjes së pasurive kombëtare, burimeve dhe tregjeve. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore brenda kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj grabitjes në emër të interesit publik apo drejtpërdrejt të interesit privat të pronave dhe qytetarëve, të pasurive publike, rrënimit të mjedisit dhe tjetërsimit të burimeve dhe tregjeve. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore brenda kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj kastës kontrolluese sorosiane, e cila po implementon një skenar bazë për rrënimin e shtetit ligjor dhe ekonomisë së Shqipërisë nëpërmjet shkeljes së planifikuar të të drejtave të njeriut, rrënimin e palnifikuar të demokracisë dhe ekonomisë, si edhe fuqizimin e kastës në kurriz të të drejtave dhe interesave të qytetarëve. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore brenda kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj realizimit të një skenari ndërkombëtar të orientuar nga rrjeti të ndërkombëtar korruptiv sorosian për falimentimin dhe rrënimin e plotë ekonomik të Shqipërisë, duke rrënuar interesat sociale dhe ekonomike të shqiptarëve me qëllim trajtimin e Shqipërisë si një model biznesi “skrapi” që duhet nxjerrë në ankand me vlerë sa më të vogël për të përfituar nga kjo oligarki që synon të zotërojë gjithë ekonominë dhe pasuritë kombëtare, duke ia grabitur këtë qytetarëve. Denoncimin dhe kundërvënien ligjore brenda kompetencave të Avokatit të Popullit ndaj krijimit të një pushteti unik mafioz të kontrolluar nga kjo kastë sorosiane që bashkon totalisht politikën, krimin dhe ekonominë në një grup të vetëm.

Fushat kryesore janë:

Trajtimi policor dhe sistemi penitenciar.

Të drejtat e njeriut dhe marrëdhënia e qytetarëve me institucionet shtetërore. Të drejtat e fëmijëve dhe të konsumatorëve.

Zbatimi i platformës:

Riorganizim i strukturës së brendshme të Avokatit të Popullit në pikat kryesore, duke ridimensionuar objektivat dhe prioritetet administratës konform legjislacionit tonë.

Fuqizim i stafit me burime shtesë sipas nenit 37 të ligjit për Avokatin e Popullit.

Rrjeti i monitorimit qytetar të të drejtave të njeriut

Krijimi i rrjetit të 61 zyrave të Avokatit të Qytetit në 61 bashkitë e Shqipërisë.

Rritja e kapaciteteve të rrjeteve të reporterëve vullnetarë dhe punonjësve social që janë të angazhuar në këtë drejtim.

Shërbimi dixhital i të drejtave të njeriut.

Këshillim dhe orientim ligjor për qytetarët dhe për problemet që kanë qytetarët me administratën publike.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem përmbledheni, sepse mbaroi 7 minutëshi.

Altin Goxhaj – Platformën time do ta përkufizoj në tre elemente.

1. Avokati i Popullit do të veprojë në kufijtë e ligjit, jo thjesht brenda ligjit, por aty ku e ka maksimumin e mundësisë, duke shkuar në çdo burg, qeli, apo komisariat dhe duke ndjekur çdo hap ligjor brenda kompetencave të Avokatit të Popullit për të bërë shembull ndëshkimi çdo oficer policie apo punonjës policie, në radhë të parë duke marrë në konsideratë hierarkinë e tyre. Pra, përgjegjësit e ushtrimit të dhunës, shkeljes të të drejtave të njeriut dhe politikës së frikësimit, që policia është kthyer në një instrument të diktaturës dhe jo të zbatimit të ligjit.

2. Avokati i Popullit do të ndërmarrë të gjitha masat e duhura ligjore brenda kompetencave të tij për të mbrojtur pronën private të qytetarëve që po grabitet çdo ditë nga një shtet grabitës i diktaturës në kapërcim të kompetencave ligjore dhe me qëllime të qarta të pasurimit të kësaj oligarkie.

3. Avokati i Popullit do të krijojë një rrjet të fuqishëm monitorimi, shërbimi dhe mbi të gjitha këshillimi ligjor për të ndërgjegjësuar qytetarët që nuk është rruga e frikës dhe drogëzimit përballë presionit shtetëror, por rezistenca dhe ndjekja e çdo hapi ligjor për të ndërtuar në Shqipëri rezistencën ndaj planit për të krijuar një politikë frikësimi të qytetarëve njësoj si 27 vjet më parë.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ju faleminderit zoti Goxhaj për paraqitjen e platformës suaj.

Ka pyetje nga kolegët?

Nuk ka pyetje.

Faleminderit, zoti Goxhaj!

Altin Goxhaj – Ku ta lë kopjen e platformës sime?

Fatmir Xhafaj - Te stafi i Shërbimit të Monitorimit, kolegët janë pas jush.

Ditë të mbarë!

Fjalën e ka zoti Gjana, pastaj zonja Gjika.

Përshëndetje zoti Gjana!

Ju keni paraqitur kandidaturën për Avokat Populli për t’u votuar nga deputetët në seancë plenare. Siç kemi vepruar edhe me paraardhësit, duhet të prezantoni CV-në dhe vizionin tuaj për këtë përgjegjësi që doni të merrni, por me një kohë të kufizuar jo më shumë se 7 minuta.

Gëzim Gjana – Faleminderit!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar deputet,

Quhem Gëzim Gjana, kam lindur në Kukës, ditëlindja 22.02.1982.

Kam mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme dhe më pas studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë me kohë të plotë, sistemin 4-vjeçar dhe jam diplomuar jurist. Para se të filloja studimet e larta, unë kam punuar në sistemin arsimor dhe kam punuar mësues në një shkollë 8-vjeçare në rrethin e Kukësit. Pas diplomimit kam vazhduar stazhin e avokatisë dhe kam punuar pranë një studioje ligjore dhe kam dhënë provimin pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ku jam licencuar avokat.

Nga data 2 tetor të vitit 2013 dhe në vazhdim ushtroj profesionin e avokatit me qendër pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Duke pasur dëshirë që të jap kontributin tim në promovimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë, kam paraqitur kërkesën time për të kandiduar në pozicionin e Avokatit të Popullit.

Platformën time e kam përmbledhur shkurt dhe konsiston në nxitjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Të ngre avokatin e Popullit në një nivel të tillë, që të jetë më efikas dhe ndikues në mirëqeverisjen e vendit, në mënyrë që t’u japë mundësi qytetarëve të Republikës së Shqipërisë që të trajtohen në mënyrë të barabartë në çdo marrëdhënie në lidhje me institucionet e administratës publike.

Të krijoj bashkëpunim me *onbucmanët* e vendeve të ndryshme.

Të ndikoj në kualifikimin dhe trajnimin e të gjithë stafit, personelit dhe ekspertëve që punojnë pranë Avokatit të Popullit, në mënyrë që ata të jenë më të kualifikuar në trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve të ndryshëm.

Të ndërtoj marrëdhënie të shëndosha dhe bilaterale me institucione të ndryshme të administratës shtetërore dhe me organizatat joqeveritare.

Institucioni i Avokatit të Popullit kryen detyrat të përcaktuara në ligjin e posaçëm “Për Avokatin e Popullit”, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nga neni 60 deri në nenin 63, të përcaktuara edhe në ligje të tjera të veçanta. Avokati i Popullit ka mision kryesor mbrojtjen e interesave dhe të drejtat e ligjshme të qytetarëve nga veprimet ose mosveprimet e pasakta, e parregullta dhe të paligjshme të institucioneve të administratës publike.

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgjegjësi në mirëmenaxhimin e buxhetit, pasi është një institucion që paguhet nga taksat e qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për prezantimin tuaj!

Ka pyetje? Nuk ka pyetje.

Zoti Gjana, ju uroj një ditë të mbarë dhe punë të mbarë!

Gëzim Gjana – Punë të mbarë edhe juve!

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Mimoza Gjika. Të përgatitet zoti Gjonçaj.

Zonja Gjika, ju keni paraqitur kërkesën për të qenë kandidate e mundshme ndër kandidatët që mund të përzgjidhen të paktën nga 28 deputetë për t’u votuar në seancë plenare për funksionin e Avokatit të Popullit. Ashtu siç ju kemi njoftuar dhe siç kemi vepruar me të gjithë kandidatët e mëparshëm, keni 7 minuta kohë për të paraqitur CV-në dhe vizionin tuaj lidhur me këtë kandidim.

Atëherë, fjala për ju.

Mimoza Gjika – Faleminderit, zoti kryetar!

Quhem Mimoza Gjika, vij pas një përvoje shumë të gjatë pune në administratën publike, në shoqërinë civile. Për nga pozicionet që kam mbajtur, kam pasur mundësi ta njoh shumë mirë sistemin e OKB-së për të drejtat e njeriut, gjithashtu edhe sistemin europian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Shpesh kam kontribuar në përgatitjen e raporteve në kuadrin e konventave të ndryshme që bën shteti shqiptar. Pra, me pak fjalë, dua të them se e njoh shumë mirë mjedisin në të cilin

operon Avokati i Popullit, njoh shumë mirë si administratën, shoqërinë civile, si dhe sistemin ndërkombëtar.

Nga ana tjetër, në 5 vjetet e fundit kam punuar si këshilltare në kabinetin e Avokatit të Popullit dhe e njoh shumë mirë mënyrën e funksionimit dhe të operimit të këtij institucioni. Ajo që dua të vë në dukje është se me amendimet e fundit që iu bënë ligjit të Avokatit të Popullit në vitin 2014, mandati i tij u zgjerua shumë për të përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Tashmë Avokati i Popullit përmbush 5 kriteret e Parisit për të vepruar si një institucion i të drejtave të njeriut. Mirëpo ligji i parë i Avokatit të Popullit dhe natyra e institucioneve të tilla në botë bëjnë që avokati ose siç quhet në gjuhën origjinale *ombudsman-i* të jetë një ndërmjetës midis qytetarit dhe administratës për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Në 5 vjet që kaluan institucioni e forcoi shumë imazhin dhe rolin e tij në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Besoj se të gjithë i dinë aksionet në mbrojtje të romëve, LGBT-ve, minoriteteve, grupeve vulnerabël, aftësisë së kufizuar e të tjera. Në gjykimin tim në këta 5 vjet u la disi pas dore puna e institucionit si *ombudsman* i vërtetë. Ligji i parashikon të dyja këto funksione të tij, por ajo që dua të them është se Avokati veproi më së shumti dhe kryesisht si një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut. Prandaj në vizionin tim, ashtu siç e kam thënë edhe në mënyrë të përmbledhur në letrën e interesit, është momenti që institucioni i Avokatit të Popullit të forcojë boshtin e tij të punës me administratën publike, duke vepruar kryesisht si një mediator dhe ndërmjetës midis tij dhe administratës dhe aspak si një denoncues apo raportues i thjeshtë i këtyre problemeve. Duke thënë këtë kam parasysh se duhet të vendoset një marrëdhënie konstruktive e Avokatit të Popullit me administratën për të zgjidhur realisht ato probleme që janë të mundshme sidomos në momentet e vështirësive ekonomike që kalon vendi, por edhe Europa mbarë. Ky forcim i këtij boshti të Avokatit të Popullit do të krijonte mundësi reale për realizimin e kërkesave dhe nevojave të të drejtave sociale-ekonomike të popullatës, që gjithnjë rrezikohen nga krizat ekonomike, por rrezikohen gjithashtu edhe nga një shpërndarje jo e drejtë e rritjes ekonomike që përjeton vendi.

Një tjetër prioritet i punës sime në 5 vjetët që do të vijmë nëse do të jem në këtë pozicion do të jetë edhe forcimi i punës dhe i rolit të komisionerëve brenda institucionit të Avokatit të Popullit. Komisionerët janë shtylla kurrizore e punës së avokatit, janë ata që trajtojnë ankesat e njerëzve dhe që kërkojnë zgjidhje prej administratës. Deri tani, të paktën ashtu siç e njoh unë institucionin e Avokatit të Popullit, roli i komisionerëve nuk ka qenë në lartësinë e duhur, për më

tepër tani që roli i komisionerëve kalon në 5, që realisht parashikon një shtim të kompetencave të Avokatit të Popullit. Mendoj se duke i dhënë vendin e duhur rolit të komisionerëve dhe duke bashkëpunuar ngushtë edhe me dy komisionerët e tjerë të pavarur, që ekzistojnë në vend, krijohet një kuadër i plotë i mundësisë për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në të gjitha aspektet, qofshin ato të drejta, bazë themelore e njeriut apo dhe të drejta social-ekonomike, për të siguruar një përfshirje dhe një pjesëmarrje sa më të gjerë të qytetarëve në jetën e vendit.

Prioriteti im i tretë, nëse unë do të jem në këtë pozicion, do të kalojë, dhe kjo ka të bëjë më shumë me rrafshin e brendshëm të institucionit, në një qasje më strategjike të punës së avokatit. Qasja e deritanishme ka qenë një qasje e fragmentuar, e copëzuar në baza *ad hoc* dhe një problem dalim, e atakojmë në publik përpara se ta atakojmë me organet apo strukturat që e kanë në dorë zgjidhjen reale të problemit. Mendoj se, duke fuqizuar komisionerët dhe duke u fokusuar në një punë studimore, hetimore të thelluar, të kalohet nga kjo qasje e fragmentuar në një qasje strategjike, pra në zgjidhjen e atyre problemeve që realisht janë të mundshme për t'u zgjidhur dhe që afektojnë një numër sa më të madh qytetarësh. Pra, vlen të zgjidhen ato probleme që prekin jetët e një grupi sa më të madh shoqëror.

Sigurisht, në fokusin e punës së avokatit dhe në përzgjedhjen strategjike të këtyre problematikave do të jenë grupet vulnerabël, të pambrojturit, ata që nuk kanë zë, ata që rrezikohen të shtyhen më në periferi të shoqërisë për shkak të zhvillimeve të pabarabarta, do të jenë minoritet, personat LGBT, ata që janë subjekt i diskriminimit, duke vënë gjithmonë theksin në një bashkëpunim sa më të ngushtë me dy komisionerët e tjerë, duke referuar pranë tyre ato çështje, të cilat dalin gjatë shqyrtimit të çështjeve substanciale. Pra, nëse në një çështje të caktuar vihet re se, krahas shkeljes së një të drejtë social-ekonomike, kjo shkelje ka ardhur si pasojë e diskriminimit, çështja menjëherë do t'i referohet komisionerit antidiskriminim, që, në gjykimin tim, është një bashkëpunim i munguar në këto vite. Pra, synimi do të jetë bashkëpunimi me të gjithë aktorët dhe faktorët që veprojnë në vend. Në këtë kuadër vlera që do të promovojë Avokati i Popullit do të jetë një trajtim i barabartë dhe i drejtë për të gjithë, do të jetë forcimi i transparencës dhe llogaridhënies, do të jetë pavarësia dhe paanësia e institucionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, vlerat do të jenë, edhe një herë, pavarësia dhe paanësia, duke luftuar përforcimin e diversitetit dhe pluralitetit edhe brenda institucionit. Misioni kryesor do të jetë: të bëhemi një faktor ndryshimi pozitiv për jetën e qytetarëve në Shqipëri.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Po, zonja Hysi

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja Gjika!

Në fakt, deri tani seanca është shumë interesante, sepse kemi disa platforma.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi disa platforma dhe ju jeni një nga kandidatet që vjen nga brenda institucionit dhe që e njihni institucionin shumë mirë.

Në rrafshin e brendshëm institucional keni renditur një sërë nevojash për ndërhyrje urgjente, sa më të shpejtë, po ashtu edhe në rrafshin e marrëdhënieve me aktorët e tjerë.

Mimoza Gjika – Po.

Vasilika Hysi – Për mua janë të gjitha shumë të rëndësishme, ju në rast se do të mandatoheni nga Kuvendi i Shqipërisë si Avokatja e Popullit, kë do të vlerësonit, si prioritare, parësore në të tërësinë e këtyre masave që i vlerësoni si pjesë të strategjisë suaj?

Mimoza Gjika – Në fakt, është e pamundur që dikush të vijë dhe të përmbysë gjithçka, prandaj unë kam zgjedhur tri objektiva madhorë dhe fokusimi im i parë do të jetë pikërisht në këto tri objektiva, që ngërthejnë njëkohësisht edhe një qasje të brendshme, por edhe pozicionimin e Avokatit të Popullit në mjedisin që e rrethon. Puna e parë që do të bëj do të jetë forcimi i rolit të komisionerëve brenda institucionit që pothuajse ka qenë i paqenë. Ky forcim i rolit të komisionerëve do të thotë, në të njëjtën kohë, kalim i prioritetit nga qasja luftarake apo atakuse në një qasje bashkëpunuese me administratën, për të kaluar realisht në rolin e mediatorit dhe ndërmjetësuesit për zgjidhjen paqësore të problemeve dhe konflikteve që lindin midis qytetarit dhe administratës.

Sigurisht, për këtë synim në institucion duhen bërë disa rregullime që për mendimin tim janë të domosdoshme. Rregullimi nr. 1 është rivlerësimi i rolit të komisionerëve. Ata janë shtylla e institucionit, janë ata që bëjnë punën dhe përballen me ankesat, kurse Avokati i Popullit është, si të thuash, i pari midis të barabartëve. Pra, duhet të kalohet nga një drejtim i fortë, monokratit i njëshit, në drejtim me pjesëmarrje të institucionit, sepse, në fund të fundit, pjesëmarrja dhe dëgjimi i zërit të çdokujt është ajo që bën diferencën, jemi në kohëra kur, sado i rëndësishëm të jetë njëshi, forca e vërtetë e demokracisë është në pjesëmarrjen dhe në demokratizimin e jetës së brendshme

të institucionit. Pa demokratizuar vetë institucionin për mua është e pamundur që të kërkojsh një demokratizim të shoqërisë në përgjithësi, që gjithashtu, është një nga rolet dhe funksionet që duhet të kryejë Avokati i Popullit bazuar edhe në ligjin e tij.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Gjika!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Zonja Gjika, faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mimoza Gjika – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Gjonçaj. Më pas të përgatitet zoti Liçaj.

Zoti Gjonçaj, mirë se keni ardhur! Ju keni shprehur kërkesën për të qenë kandidat ndër ata që mund të përzgjidhen nga Kuvendi për funksionin e Avokatit të Popullit. Ju keni paraqitur dokumentacionin tuaj, por gjithsesi në këtë seancë dëgjimore dëshirojmë të dëgjojmë CV-në dhe vizionin tuaj lidhur me këtë funksion të rëndësishëm Kushtetues.

Ju lutem, respektoni kohën që ju kemi përcaktuar, që e kemi respektuar edhe me kandidatët e tjerë, jo më shumë se 7 minuta për CV-në dhe platformën tuaj. Më pas mund të lini ndonjë dokument, nëse shikohet e nevojshme, që deputetët ta kenë në dispozicion që të njihen më shumë.

Urdhëroni, zoti Gjonçaj!

Genci Gjonçaj – Mirëdita!

Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua t'ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për paraqitjen e platformës sime para jush, këtij komisioni të nderuar. Disa nga ju mund të mos më njohin se kush jam unë, çfarë dua të përfaqësoj nëpërmjet këtij kandidimi.

Së pari, më lejoni ta nis prezantimin, gjithmonë duke respektuar kohën që ju më keni vënë në dispozicion, duke treguar shkurtimisht kush jam, idetë dhe parimet, që unë përfaqësoj, përse kam zgjedhur të kandidoj në këtë garë, cila është platforma ime dhe çfarë përmban ajo, pse pikërisht kam zgjedhur këtë platformë dhe si mendoj ta implementoj në institucionin e Avokatit të Popullit.

Unë jam Genc Gjonçaj me profesion jurist, me një eksperiencë mbi 20-vjeçare në këtë profesion. Kam një eksperiencë të gjatë administrative në administratën shtetërore dhe një karrierë të konsoliduar, duke filluar nga nivelet më të ulëta e deri tek ato më të larta të nëpunësve civile. Besoj se ky është edhe elementi kryesor dhe i rëndësishëm i kandidimit tim.

Sikundër prezantohet edhe në CV-në time, unë kam punuar në disa institucione të rëndësishme të administratës në pozicione të ndryshme, çka mendoj se më bën të aftë për të kuptuar sesi funksionon realisht administrata publike, veçanërisht në raport me kërkesat e qytetarëve dhe ato të Avokatit të Popullit. Një eksperiencë e rëndësishme e krijuar nga unë është ajo e avokatit të qytetit të Tiranës në Bashkinë e Tiranës, ku, fal përkushtimit të stafit dhe rregullave të brendshme të vendosura, arrita të krijoj një realitet brenda administratës së bashkisë në mbështetje të të drejtave të qytetarëve të Tiranës. E spikatur, gjithmonë duke iu referuar CV-së sime, mbetet besoj edhe eksperiencia me shoqërinë civile. Veçanërisht në vitet e para të demokracisë, ku nëpërmjet veprimit aktiv kam kontribuar drejtpërdrejtë në krijimin e një shoqërie të hapur dhe një mjedisi funksional për organizatat joqeveritare. Si pedagog në universitet dhe autor tekstesh akademike kam pasur parasysh gjithmonë që alfa dhe omega e një shoqërie është liria dhe respekti për të drejtat e njeriut, gjithmonë kam inkurajuar veçanërisht të rinjtë, studentët e mi, që të mos heshtin dhe të luftojnë gjithmonë për to.

Së fundi, është një e drejtë e ligjshme e imja kërkesa, dëshira dhe vullneti për ta zhvilluar më tej karrierën time personale.

Realiteti i vendeve perëndimore, ku institucioni i Avokatit të Popullit është tashmë i konsoliduar dhe luan një rol qendror, të dorës së parë, për ngritjen edhe adresimin e problematikave që lidhen me të drejtat e njeriut, qoftë në nivel qendror, qoftë në nivel vendor, ku për sa i përket realitetit tonë mendoj se ka shumë për t'u bërë, ka qenë orientues për organizimin e platformës që unë po ju paraqes.

Eksperiencia perëndimore tregon se të drejtat themelore të njeriut mbeten çështje me një ndjeshmëri të lartë për publikun, por vendosja e standardeve në këtë vazhdë dhe respektimi i tyre kanë gjithmonë nevojë për një angazhim të vazhdueshëm dhe profesional. Avokati i Popullit është një mjet efikas që ka shoqëria në dorë për këtë qëllim. Vendet me demokraci të konsoliduar kanë përcaktuar qartë natyrën dhe aspektet procedurale të komunikimit midis Avokatit të Popullit dhe ekzekutivit apo organeve të tjera. Vendosja e një marrëdhënie të qëndrueshme me publikun, e cila duhet të arrihet nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe aksesit në këtë institucion, si simbol kryesor i saj, është një kusht themelor që besoj se do të rrisë kapacitetin e Avokatit të Popullit për të siguruar reagimin dhe korrigjimin e praktikave prej Kuvendit, ekzekutivit apo institucioneve të tjera, që mund të ndikojnë apo të përcaktojnë respektimin e të drejtave të njeriut. Reflektimi i këtyre njohurive në realitetin shqiptar, mendoj se mund të arrihet përmes një sërë hapash, ndër më

të rëndësishmit do të veçoja: rishikimin e kuadrit ligjor, që përcakton ndikimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në praktikën e institucioneve të cilat i adresohen.

Avokatit të Popullit i janë veshur kompetenca shumë të rëndësishme ligjore, por, në fakt, mjetet për të shprehur dhe për të imponuar vullnetin e tij mendoj se janë joefikas. Në mungesë të hapësirës ligjore për sanksione, mjeti i vetëm i Avokatit të Popullit, në marrëdhëniet me Kuvendin, ekzekutivin, institucionet e të tjera mbetet rekomandimi. Më e pakta që duhet riparë në këtë kontekst është fakti se një rekomandim i Avokatit të Popullit po nuk u kundërshtua në mënyrë të arsyeshme, duhet të pranohet automatikisht nga institucioni përgjegjës dhe të jetë përcaktues për praktikën vijuese.

Përmirësimi i situatës financiare të institucionit të Avokatit të Popullit është një hap tjetër jetik për fuqizimin e rolit të tij dhe roleve që në të vërtetë ai duhet të luaj në shoqëri. Avokati i Popullit duhet të marrë përsipër rolin e tij, si autor i raporteve profesionale e të besueshme, lidhur mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vend. Rëndom merren raporte të OJQ-ve të ndryshme shqiptare apo ndërkombëtare, por një raport i besueshëm cilësor ende mungon. Kjo gjë duhet të realizohet, pa dyshim, në bashkëpunim me të gjitha institucionet publike, opinionin publik, shoqërinë civile, në mënyrë transparente dhe gjithmonë nëpërmjet Kuvendit të Republikës.

Gjithashtu, duhet të adresohet mungesa e programeve konkrete, edukuese dhe sensibilizuese mbi të drejtat themelore të njeriut, duke rritur edhe implementimin e projekteve me financim buxhetor ose nga donatorët e huaj. Informimi mbetet bazë për parandalimin e shkeljes së të drejtave. Një shfuqizim më i mirë i teknologjive të reja të komunikimit, si dhe sigurim i bashkëpunimit të qëndrueshëm me mediet është një hap i rëndësishëm për arritjen e këtyre objektivave. Përfshirja në rregulloret e brendshme apo manualet e punëve të institucioneve...

Fatmir Xhafaj – Zoti Gjonçaj, 7 minutat tuaja në dispozicionin sapo përfunduan.

Genci Gjonçaj – Nëse mund ta shkurtoj në 1 minutë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Genci Gjonçaj – Atëherë, po kaloj tek ajo që unë mendoj se duhet të bëjë Avokati i Popullit dhe cilat janë risitë e kandidimit tim. Fakti që Avokati i Popullit është në themelin kushtetues, pasi mbron të drejtat dhe liritë e njeriut, duhet ta kthejë këtë institut ligjor në një institucion, që lidhet jo vetëm me çështje individuale apo të grupeve të caktuara të interesit, siç ndodh deri më sot, madje këtu kam një vërejtje lidhur dhe me faktin që në këtë institucion ende flitet për mjetet e parandalimit të torturës, trajtimit, dënimit të egër çnjerëzor, mendoj se kjo është

një gjë tejkaluar në realitetin demokratik tonë. Avokati i Popullit duhet të orientohet dhe të ketë vëmendje të çështjet, të cilat kanë një vëmendje të veçantë të opinionit publik, të cilat unë po i listoj:

Së pari, zgjedhjet dhe vota e lirë, si detyrim direkt i nenit 45 të Kushtetutës, ku përcaktohet se çdo shtetas që ka mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet se vota është e vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Avokati i Popullit duhet të ngrejë një sistem permanent dhe të qëndrueshëm të mbikëqyrjes së zgjedhjeve, duke monitoruar nga afër çdo proces që ka lidhje me zgjedhjet apo referendimet dhe duke rekomanduar masat përkatëse për përmirësim të vazhdueshëm. Rritja e mirëqenies së qytetarit, ku avokati duhet të përqendrohet tek elemente të tilla si: strehim, punësimi, edukimi, dëmshpërblimi, ndihma sociale...

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, përmbylleni!

Genc Gjonçaj – Mbështetja e kategorive vulnerabël të shoqërisë, kryesisht viktimat e trafikut, personat me nevoja speciale, të huajt, rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe, ajo që dua të kisha parasysh, nëse do të propozoja ndryshime, rritja e penaltetit, pra vendosja e penaltetit nëpërmjet gjobitjes në rast të mosmarrjes parasysh rekomandimet e Avokatit të Popullit do të ishte një zgjidhje e përkohshme, por efikase.

Së fundi, natyrisht, avokati duhet të fillojë të luajë rolin e ngarkuar nga reforma që ju keni miratuar së fundi në drejtësi. Duke përdorur mekanizmat e duhur ligjorë, mendoj se duke pasur mbështetjen e Kuvendit dhe qeverisë, ky institucion mund të shndërrohet nga një institucion i kuptuar gabimisht deri më sot si informues dhe që vepron me rekomandime të posaçme, për sa i takon disa të drejtave të veçanta.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, zoti Gjonçaj, përmbylleni!

Genc Gjonçaj – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Genc Gjonçaj – Faleminderit ju që më dëgjuat dhe suksese të gjithëve kandidatëve!

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje?

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, për prezantimin ,zoti Gjonçaj!

Unë kam një pyetje që ua kam bërë edhe kandidatëve të tjerë. Në listën që ju renditët se çfarë duhet të bëjë Avokati i Popullit, cilat do të konsideroni si ndërhyrjet më parësore, nëse ju do të mandatoheshit nga Kuvendi i Shqipërisë për të qenë Avokat i Popullit?

Faleminderit!

Genc Gjonçaj – Si kundër e thashë në pjesën shpjeguese, Avokati i Popullit është një figurë juridike, e cila është veshur me shumë kompetenca, por ndërkohë materializimi i fuqisë ekzekutive të tij për mua është joefikas. Ajo që do të kërkoja është që më së paku, rekomandimet e Avokatit të Popullit, në rast se nuk kundërshtohen në mënyrë të arsyetuar, të pranohen nga institucioni përgjegjës dhe në një rast akoma më të mirë, do të ishte fakti që të vendosnim penalizmin e subjektit, i cili nuk zbaton rekomandimin nëpërmjet formës së gjobës. Është një formë e njohur nga legjislacioni shqiptar, ka komisioner dhe institute, që e aplikojnë. Këta do të ishin hapat e parë për sa i takon bërjes efektive dhe funksionale të këtij pozicioni.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Zoti Manja ka pyetje për ju, zoti Gjonçaj.

Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Zoti Gjonçaj, në CV-në tuaj thoni se keni shërbyer gati 3 vjet si avokati i qytetit të Tiranës. Natyrisht, institucioni Avokati të Popullit është institucion kushtetues, por është edhe një autoritet moral, ku kredibiliteti i institucionit dhe i drejtuesit të këtij institucioni merr një rëndësi të dorës së parë. A mendoni ju, nga eksperiencia si avokat i qytetit të Tiranës, që duhet kredibiliteti i institucionit, sepse, në fund të fundit, institucioni i Avokatit të Popullit, lidhet ngushtësisht edhe me autoritetin moral dhe kredibilitetin e tij drejtues të këtij institucioni, gjithmonë duke pasur parasysh eksperiencën tuaj si avokatit i qytetit të Tiranës, në raport me autoritetet administrative, që kanë drejtuar bashkinë gjatë kohës që ju keni avokat i qytetit?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Manja!

Urdhëroni, zoti Gjonçaj!

Genci Gjonçaj – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, kjo është një ndër eksperiencat e rëndësishme të karrierës sime, jo për faktin se jam përballë jush për të argumentuar kandidimin si Avokat Populli dhe se avokati i qytetit është një miniavokat i popullit në nivel vendor, por për faktin se arritëm që të fusnim një koncept të ri në punët e pushtetit vendor asokohe, të krijonim një strukturë, e cila mbronte zërin e qytetarëve, mbronte qytetarët nga praktikat administrative të baskisë. Duke qenë si ishte një gjë e pashkelur më parë u ndjeva mirë që në një kohë të shkurtër, prej 2-3 vjetësh, arritëm ta vinim në funksion dhe ta poziciononim avokatin e qytetit si zërin e qytetarëve dhe problematikave që ata kishin në

raport me vendimmarrjen e bashkisë. Natyrisht, ishin fillimet e para, në gjykimin tim ajo gjë duhet të zhvillohej. Avokati i qytetit fare mirë mund të kishte dalë si një autoritet në varësi të këshillit bashkiak, por janë çështje të organizimit të funksionimit të pushtetit vendor. Ndihem mirë se sollëm një risi dhe arritëm ta implementonim në një kohë të shkurtër.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Kam unë një pyetje. Më jepni 3 arsye, pse unë do të jem pjesë e një liste që mbështet kandidaturën tuaj, dhe më jepni 1 arsye pse nuk duhet ta bëj këtë gjë?

Genci Gjonçaj - Nuk do ta bënit, sepse kemi njohje personale dhe kjo është një nga arsyet që mund t'ju pengojë që ta bëni një gjë të tillë. Ndërsa për 3 arsytet që unë dua t'ju bind juve për mbështetjen e kandidaturës sime është:

Së pari, në të gjithë karrierën time kam pasur parasysh principet e lirisë dhe të drejtat e njeriut që janë një gjë e rëndësishme për të cilat kam luftuar dhe do të vazhdoj të luftoj.

Së dyti, profesionalisht besoj se jam i aftë për të drejtuar një institucion dhe për të propozuar masa dhe të adresoj problematika.

Së treti, eksperiencia ime e gjatë në administratën publike më lejon që të kuptoj ku janë problemet, cilat janë problemet reale dhe ku duhet të orientohet puna e Avokatit të Popullit.

Nuk duhet rëndom të merremi me një, apo dy-tre çështje, të cilat publikisht vazhdojnë dhe përsëriten, madje janë kthyer në një mjet humori publik, me çfarë çështjesh duhet të merret Avokati i Popullit. Avokati i Popullit duhet të orientohet te çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me të liritë dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Gjonçaj që jeni një ndër 20 kandidatët e tjerë në këtë listë!

Punë të mbarë dhe gjithë të mirat!

Genci Gjonçaj – Faleminderit juve që më dhatë mundësinë të paraqes platformën time!

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zoti Liçaj. Më pas të përgatitet zonja Luzi.

Zoti Liçaj, natyrisht e keni të qartë arsyen pse jeni në këtë seancë dëgjimore, pasi keni paraqitur dokumentet për të kandiduar për funksionin e Avokatit të Popullit. Ashtu siç jeni njoftuar dhe siç është vepruar për të gjithë kandidatët që kanë prezantuar CV-në dhe programin përkatës, keni vetëm 7 minuta në dispozicion për të bërë një gjë të tillë. Kështu që koha është për ju, unë do ta monitoroj këtë kohë dhe më pas mund të keni pyetje nga deputetët.

Urdhëroni, fjala për ju!

Ardian Liçaj – Mirëdita!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Të vish te ju për të kërkuar postin e Avokatit të Popullit pa dyshim jo vetëm duhet ta kesh të menduar mirë rrugën mbi të cilën duhet të ecësh, por dhe një kauzë shumë të fortë për t'u përfaqësuar, jo vetëm me fjalë, jo vetëm si avokat, por dhe si një intelektual i vërtetë, ku largpamësia e mendimit duhet patjetër të konvergojë me forcën dhe vullnetin e veprimit. Unë e kam një kauzë po kaq të fortë. Kauza ime është se Avokati i Popullit është shpresa e fundit e qytetarit për drejtësi. Kështu e kuptoj unë këtë post dhe mbi këtë do të përkushtoj të gjithë punën, mundin dhe djersën time, do të përkushtoj atë që gjithçka mbart unë, një inxhinier dhe avokat. Unë vendos mbi këtë post pasionin tim të pastër, si shenjë e maksimumit tim njerëzor, për ta bërë kauzën time më se të realizueshme, në të kundërt do të jetë e pavlerë dhe gjithkush kollaj mund ta paragjykojë dhe më tej po aq kollaj mund ta gjykojë.

Avokati i Popullit për mua është promotori i zhvillimit të shoqërisë dhe duhet që në çdo moment të shfaqet kreativ në jetën e përditshme të popullit të tij. Duke rekomanduar, sugjeruar apo hetuar ai do ta bëjë më të lehtë rrugën e qytetarit tek e drejta. Nuk ka dhe nuk mund të ketë nder, lavdi, por dhe përgjegjësi më të madhe për një avokat që të jetë Avokat i Popullit të tij, por kurrë dhe asnjëherë një Avokat Populli i dyzuar apo i trezuar. Avokat Populli, je ose nuk je.

Avokati i Popullit duhet të hyjë në çdo qelizë të shoqërisë. Për mirëqenien dhe mirërritjen e popullit të tij, ai duhet të ketë një program më të mirë se qeveria, si dhe një program pararendës për opozitën. Ai duhet të jetë ura më e qëndrueshme për të lidhur të gjithë politikën në shërbim të së drejtës për qytetarin. Për Avokatin e Popullit dhe jo vetëm për të drejtësia është sistemi që patjetër duhet të funksionojë, prandaj dhe quhet dhe sistemi i drejtësisë.

Të nderuar anëtarë e komisionit,

Ndiejë të udhës, meqë rasti po më jepet, t'ju sugjeroj të ndaheni nga e kaluara, zgjidhni Avokatin e Popullit jo si një zgjedhje për të zgjedhur, por si një zgjidhje për të zgjidhur. Vetëm kështu mund ta bëjmë këtë popull të vrasë mosbesimin ndaj drejtësisë dhe zbatuesit të tij, ku ai nuk do dhe nuk do të jetë më jetim.

Unë mendoj se Avokati i Popullit duhet të zgjidhet vetëm një herë dhe me një mandat maksimal deri në 7 vjet, duke krijuar mundësi dhe hapësirë për të gjithë, ai nuk duhet të konsiderohet asnjëherë një vend komod pune apo një gjethë që pluskon në lumin e politikës shqiptare, por një aftësi më shumë për t'u vënë në shërbim të ekuilibrit ligjor të shoqërisë.

Në Shqipëri populli përditë dhe më shumë e ka humbur besimin te drejtësia dhe jo rrallëherë merr ligjin në dorën e tij, i bindur se drejtësia ka dështuar dhe nuk ekziston, se shteti dhe institucionet e zbatojnë ligjin në mënyrë selektive dhe përdorin rregulla jo në ndihmë të qytetarit, por kundër tij. Këtë do të luftoj, do të insistoj që shteti, institucionet dhe burokracia të punojnë pro njeriut për çdo qytetar konkret, të zgjidhin hallet e tij, të cilat tashmë janë shtuar shumë. Do të jem konkret në luftën time, duke ju rikujtuar përditë që prandaj ato ekzistojnë dhe janë në këto poste, por më parë duke i kujtuar dhe rikujtuar vetes sime se duhet të jem në çdo moment në vijën e parë të luftës së jetës për qytetarinë, për Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo luftë mund të duket përtej fuqisë sime, por unë di si të përdor resursin e madhe që jep besimi i popullit. Si bir i këtij populli, njoh shumë mirë institucionet dhe sistemin politik, unë di si të jem i dobishëm dhe si të ndihmoj popullin të zgjidh problemet dhe padrejtësitë ndaj tij.

Unë jam kandidat për Avokat Populli që nuk kam të nevojshme zyra, auditor apo salla konferencash. Zyra dhe konferenca ime do të jenë takimet e përditshme me qytetarët dhe personalisht do të impenjohem për zgjidhjen e të gjitha problemet e tyre. Unë di në çdo moment që e kërkon halli dhe nevoja e qytetarit se do të jem këmbëngulës dhe i fortë dhe patjetër që do ta fitoj luftën e qytetarit kundër padrejtësisë. Jam plotësisht i qartë që përball meje kam një luftë shumë të rëndësishme, luftën për të drejtat e popullit tim, luftën për drejtën më sublime të popullit tim, atë që është mbi të gjitha luftërat për liritë dhe të drejtat e njeriut, të drejtën për të jetuar denjësisht me shportën e ushqimeve plot. Unë do ju kujtoj dhe rikujtoj përherë sesa herë ta mbushim në shtëpitë tona shportën me ushqime duhet ta bëjmë këtë për çdo familje në Shqipëri, ndryshe nuk ka dhe nuk mund të ketë dhe përsëri nuk mjafton. Avokati i Popullit duhet të jetë atje, ku një nënë kërkon mbrojtje dhe punë për të rritur, edukuar dhe arsimuar fëmijën e tij, ai duhet të jetë atje, ku rinia zgjedh edukimin, shkollën dhe civilizimin, ky për mua është dhe duhet të jetë Avokati i Popullit. Ai duhet të jetë atje ku pensionisti në fshat apo në qytet kërkon një pension normal jetese, duke afruar politikën me origjinën dhe me 40% të këtij elektorati permanent, ky për mua është Avokati i Popullit. Ai duhet të jetë atje ku shteti, përveç taksës dhe detyrimit, i ka vënë mbi kokë popullit instrumentin e kamatës, ky për mua është Avokati i Popullit. Ai duhet të jetë atje ku shqiptari i pamundur për pagesë dritash përçudnohet dhe burgoset, ndërkohë që më parë duhet t'i krijohen kushte për t'u paguar, ky për mua është Avokati i Popullit. Ai duhet të jetë atje ku njerëzia nxirren në rrugë se nuk paguajnë dot qiranë e banesave popullore apo kreditë mbi to ndaj shtetit, ky për mua është Avokati i Popullit. Ai duhet të jetë atje, ku në semafor e mbingarkuar

në Tiranë ka më shumë lypës sesa policë, ky për mua është Avokat i Popullit. Ai duhet të jetë atje, edhe për zgjedhjet kur shkelet ligji dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që sanksionohet nga neni 9 pika 3, ky për ne duhet të jetë Avokat i Popullit. Unë në emër të qytetarisë sime intelektuale, nuk e pranoj këtë shkelje të ligjit, por si kandidat për Avokat të Popullit, thellësisht i revoltuar, e denoncoj këtë shkelje të paprecedentë të zgjedhjes së *ombudsman-it* në gjithë historinë time këtij tribuni të popullit në luftën kundër padrejtësisë të servitur nga padrejtësia. Njëkohësisht, nuk mund të pranoj që juristi shqiptar, aspirant i drejtësisë së nesërme, të bëhet palë me padrejtësinë e sotme.

Në fund të vitit 2016 për mua përcaktimi i minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë apo pagesat për sigurime shoqërore dhe orë pune në burgjet e Republikës Shqiptare, duhet të ishin tashmë një realitet, jo nëpër letra, por të matrealizuara, ky për ne duhet të jetë Avokati i Popullit. Jo gjithmonë qeveritë ndezin dritën jeshile për idetë, për programet dhe për projektet që Avokati i Popullit i prezanton, por ai duhet të jetë i aftë, kurajoz, ambicioz dhe këmbëngulës, ai quhet Avokat i Popullit dhe patjetër duhet t'i bindë ata për rrugën ku duhet të ecur, ndryshe nuk ka. Ndoshta t'i marr edhe përdore për të shkuar së bashku për të ndezur dritën jeshile dhe ky për mua është dhe duhet të jetë Avokati i Popullit. Shkoj me bindjen e hekurt se me kauzën time do të jem Avokati i parë i Popullit në luftën kundër padrejtësisë, paaftësisë, arrogancës, vuajtjes, në luftën për një shqiptar dhe një Shqipëri kurdoherë të përkushtuar për njëri-tjetrin. Lufta ime, si një luftë ndaj arbitraritetit të institucionit ka një pikë të errët, pasi duke qenë kritik...

Vasilika Hysi – Zoti Ardian, mendoj se koha mbaroj. Të lutem, përmbli dhe pak!

Ardian Licaj – Po, në fund jam.

Pasi duke qenë kritik ndaj administratës, në të njëjtën kohë nuk duhet të jem në pozitë me pushtetin, sepse kështu pengoj të drejtat e popullit. Opozita është dhe duhet të jetë në parlament. Avokati i Popullit ka në boshtin e funksionit të tij të mbrojtë qytetarët, pa penguar punën e institucioneve.

Unë mendoj se frika më e madhe e të gjithëve është se kjo qeverisje do të ketë një kritik të ri dhe shumë aktiv, që është dhe duhet të jetë në opozitë. Sipas mendimit tim çdo qeverisje e suksesshme ka nevojë për Avokat Populli kritikues dhe aktiv, i cili, nga njëra anë, mban në lëvizje të vazhdueshme administratën dhe, nga ana tjetër, mbron interesat legjitime të popullit.

Pa dyshim që unë do të bashkëpunoj me të gjitha institucionet, qeveri, parlament, që qytetarëve t'ju siguroj një mbrojtje sa më efektive. Pikërisht, ky efektivitet duhet të jetë treguesi më i qartë i rendimentit të punës sime.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Pranoni kandidaturën time si më të fortën, të vetmen dhe më të sigurtën në kandidaturë, jashtë çdolloj ndikimi, për t'i dhënë popullit shqiptar një Avokat Populli që vjen aty ku burojnë dhe nuk rreshtin hallet e tij, një Avokat Populli që di, kupton dhe jeton në botën reale të hallit të madh të shqiptarit, një Avokat Populli, si shpresa e fundit dhe vetme e qytetarit për drejtësinë.

Unë i jap fjalën popullit tim dhe si djalë Vlore fjala ime tregon se kush jam dhe do të jem, sepse si ju dhe unë, në rast se më zgjidhni, kur nuk duhet të harrojmë se në fund të ditës para popullit duhet të raportojmë.

Faleminderit, që patët mirësinë të më dëgjonit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ju lutem, t'ju bëj një pyetje?!

Besoj se Kushtetutën e keni parasysh lidhur me kriteret për Avokatin e Popullit, por njëkohësisht dhe ligjin nenin 3, ku thuhet se për t'u zgjedhur Avokati i Popullit duhet të kemi njohuri dhe veprimtari të shquar në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit, si dhe të shquheni për aftësi profesionale në këtë fushë. Nga CV-ja dhe materialet që kanë përgatitur Shërbimet e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura rezulton se ju keni mbaruar Fakultetin e Drejtësisë krahas një diplome të Inxhinierisë Mekanike, që nga viti 2010 jeni certifikuar për avokat, por nuk e di nëse ushtroni profesionin dhe jeni President i Federatës Shqiptare të *Body Building Fitness*. A Mund të thoni diçka më shumë lidhur me këto dy kushte ose kriteret ligjore, që parashikon Kushtetuta dhe ligji “Për Avokatin e Popullit”?

Ardian Liçaj – Unë jam student i viteve '90 dhe normalisht jam nga pjesëmarrësit e Lëvizjes Studentore të viteve '90. Mendoj se ky është një tregues jo pak i vogël për të treguar sesa unë kam punuar, kam luftuar apo kam qenë prezent në Shqipëri për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Plus kësaj, gjithë jetën kam punuar si administrator kompanish private dhe gjithmonë kam pasur në shërbim njerëz, ndaj të cilëve kam pasur pagesat maksimale dhe kushtet ideale të punës, që tregon sesa unë kam qenë pranë mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ndërkohë, duke qenë president i federatës për një periudhë jo të vogël kohe, njëkohësisht anëtarë, aktualisht, gjithmonë

promovoj të gjithë njerëzit që hyjnë dhe dalin aty për aftësitë dhe mundësitë që ata duhet të na japin dhe të na prezantojnë ne për këtë punë që bëjmë aty.

Kam mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe në Universitetin Politeknik ditën me kohë të plotë, dhe në të njëjtën mënyrë kam mbaruar edhe Fakultetin e Drejtësisë, me kohë të plotë, më pas kam bërë provimin për avokat. Kam tentuar vitin e parë të punoj si avokat për ta testuar këtë diplomë që kam marrë, dhe kam parë që në të gjitha vendet e botës ku kam shkuar, pasi unë nga kontaktet e mia me bizneset kam hyrë dhe kam dalë, një avokat i mirë duhet të njohë ligjin në radhë të parë, kurse këtu kam parë se një avokat i mirë duhet të njihë gjyqtarin mirë. Nuk isha aq i zoti të bëja sekserin midis gjyqtarit dhe prokurorit dhe u ktheva përsëri tek administrimi i biznesit. Sot e kërkoj këtë vend, sepse kam tri parametra shumë të rëndësishme; kam pasionin për ta bërë, dhe e di që bëj mirë, jam nga Vlora dhe ne nga Vlora po e thamë fjalën e kemi institucion, dhe nuk më josh fare kartmonedha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Faleminderit, zoti Liçaj!

Të paraqitet zonja Luzi (Lleshi).

Lefterie Luzi (Lleshi) - Përshëndetje!

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje, zonja Luzi!

Keni paraqitur kandidaturën për funksionin e lartë të Avokatit të Popullit dhe keni paraqitur dhe dokumentet përkatëse, që e shoqërojnë kërkesën e tuaj për shprehjen e interesit për kandidim. Sot në këtë seancë dëgjimore do të dëshironim shkurtimisht CV-në tuaj dhe kryesorja vizionin tuaj për këtë funksion kushtetues. Siç ju është bërë me dije dhe siç është respektuar për të gjithë parafolësit, pra të gjithë ata kandidatët e tjerë që janë paraqitur këtu, koha është 7 minuta. Ju lutem, respektoni kohën, mund të filloni, koha është për ju.

Lefterie Luzi (Lleshi) - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

CV-ja ime, sikurse dhe ju e thatë, në fakt, fillon që në krye të herës, që pas mbarimit të shkollë në administratën publike dhe deri më sot, unë kam qenë dhe kam punuar në administratën publike, kjo është edhe një nga arsytet që dua të vazhdoj të punoj përsëri për postin e Avokatit të Popullit.

Punën time e kam filluar në Shërbimin Informativ Kombëtar, më pas kam vijuar si juriste, më pas kam vijuar në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit dhe më pas shefe Sektori Juridik në Kuvendin e Shqipërisë. Sigurisht, gjatë rrugës sime kam avancuar me begraundin profesional, duke ndjekur kurse të ndryshme, duke qenë pjesë e komisioneve të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimet ligjore të të gjitha organeve në të cilat unë kam qenë.

Finalizimi i punës sime ka qenë kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Para kryetares së komisionit kam qenë anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në këtë post kam punuar si status i përkohshëm për 3 vjet dhe përmbyllja me kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sigurisht, si kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kam raportuar për çdo vit pranë këtij komisioni.

Gjithashtu, do të thosha se në pjesën e botimeve kam qenë prezente, edhe në Shqipëri, por sigurisht pjesën më të madhe të botimeve e kam jashtë saj.

Kam qenë lektore edhe në Shkollën e Magjistraturës, në Akademinë e Arteve për të Drejtën e Autorit, si dhe gjatë gjithë periudhës në shumë universitete, në të gjithë Shqipërinë, në lidhje me zgjedhjet. Sigurisht, kam marrë edhe çmime për punët që kam bërë dhe certifikata mirënjohjeje. Çmimet kanë ardhur nga Instituti i Studimeve Parlamentare, me qendër në Londër, dhe janë çmime të cilat karakterizojnë punën e mëparshme të kryetares së KQZ-së, janë çmime në lidhje me mirëmenaxhimin e mirë të ciklit zgjedhor, ku çmimi i fundit ka qenë në vitin 2016, pikërisht menjëherë pasi e lashë këtë detyrë.

Gjithashtu, kam marrë certifikata mirënjohjeje nga trupat zgjedhore në Amerikë dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Kosovës, sigurisht, për atë çfarë i kam ofruar këtij komisioni, për ndihmën e madhe dhe bashkëpunimin që kemi pasur me të.

Kjo është pak a shumë CV-ja ime.

Në lidhje me platformën, referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, institucioni i Avokatit të Popullit është institucion i pavarur dhe, sigurisht, kjo ma bën edhe më të lehtë kandidimin dhe punën, pasi është institucion monokratik, krahasuar me atë se çfarë kam kaluar më parë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në drejtimin e këtij institucioni, sigurisht, nëse ju do të më besoni mua, do të vijoj të dëshmoj integritet, profesionalizëm, paanshmëri, respektim dhe zbatim të normave kushtetuese dhe atyre ligjore.

Institucioni që kam drejtuar dhe ky që kandidoj kanë shumë ngjashmëri me njëri-tjetrin, pasi mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit sigurisht që prek çdo fushë të jetës dhe aq më tepër edhe atë të zgjedhjeve.

Duke e parë në këtë këndvështrim, puna ime ka përfshirë të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, për të cilat janë investuar shumë, nëpërmjet bashkëpunimit direkt me këto grupe, tryezave të punës me to dhe propozimeve për ndryshime ligjore për t'u ardhur në ndihmë me fokus kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, grupet e minoriteteve, duke përfshirë edhe atë rome, gratë, të rinjtë e të tjerë.

Mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike apo të të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, janë objekt i punës jo vetëm i Avokatit të Popullit, por i të gjitha institucioneve shtetërore. Prandaj bashkëpunimin me to e shoh si një pikë kyçe, të rëndësishme, të rezultatit të punës së këtij institucioni.

Objekti i punës së Avokatit të Popullit është shumë i gjerë dhe, sigurisht, përkushtimi, serioziteti, gjithëpërfshirja, si dhe problematikat që vijnë nëpërmjet saj tregojnë përgjegjësinë e lartë, të cilën duhet të karakterizojnë drejtuesin dhe nëpunësit e këtij institucioni.

Ndryshimet e fundit që i janë bërë ligjit organik "Për Avokatin e Popullit" tregojnë edhe rëndësinë e madhe që ka ky institucion në raport me ato të tjerat. Fokusi i këtyre ndryshimeve reflekton edhe përgjegjësinë që parlamenti ka treguar për rritjen dhe fuqizimin e rolit të këtij institucioni, si garantues i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ndryshime të tilla, si: rritja e transparencës së institucionit; parashikimi i afateve kohore për marrjen në shqyrtim të raporteve vjetore, duke përfshirë edhe ato të veçanta; rritja e rolit të Avokatit të Popullit për të iniciuar procedurat e hetimit, edhe në ato raste kur nuk ka pëlqimin e personit të interesuar si të dëmtuar; zgjerimi i rrethit të subjekteve ndaj të cilëve do të zbatohen dispozitat e ligjit për Avokatin e Popullit, duke shtuar edhe kategori të tjera të ligjit, siç janë të huajt, refugjatët, personat pa shtetësi e të tjerë, si dhe krijimi i një seksioni të ri për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës jo vetëm e kanë rritur rolin proaktiv të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, por njëkohësisht e obligon këtë të fundit të rrisë performancën e punës dhe të administratës nëpërmjet rishikimit të akteve nënligjore, si dhe të strukturës në funksion të ndryshimeve ligjore, duke rritur, në radhë të parë,

besimin pikërisht te publiku dhe më pas tek të gjithë aktorët me të cilët institucioni i Avokatit të Popullit duhet të bashkërendojë veprimtarinë e tij.

Ndër objektivat e parashikuar në ligj nga Avokati i Popullit, siç kanë të bëjnë me parandalimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe mbrojtjes së tyre nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme, porë nga këndvështrimi im është që fryma e bashkëpunimit midis Avokatit të Popullit dhe institucioneve duhet të konsistojë në krijimin e marrëdhënieve të përhershme të ngushta me këto institucione dhe jo vetëm kur lindin problematika. Institucionet duhet të bashkërendojnë punën më shumë midis tyre për parandalimin e shkeljes së të drejtave të individit dhe kjo duke e parë njëri-tjetrin si partnerë në këtë bashkëpunim dhe jo si kundërshtarë.

Bashkërendimi i të gjitha praktikave midis institucioneve në rastet kur preken të drejtat dhe liritë e individit, ofrimi i asistencës për njohjen e legjislacioneve reciproke të të drejtave dhe detyrimeve të gjithsecilit, krijimi i pikave të përhershme të kontaktit me institucionet, kjo për të qenë e menjëhershme, si dhe dhënia e rezultateve kur Avokati i Popullit u drejtohet këtyre të fundit.

Referimi i masave dhe i rekomandimeve ndaj institucioneve që shkelin të drejtat e njeriut duhet të vijë vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha elementet e tjera të bashkëpunimit me këto institucione dhe vetëm përmes analizave të studiuara mirë dhe serioze, në mënyrë që zgjidhja të vijë e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë.

Tjetër fokus i punës së Avokatit të Popullit duhet të jetë ajo që vjen nga nxitja e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e...

Zilja është për mua?

Fatmir Xhafaj – Po, për ta përmbyllur.

Lefterie Luzi (Lleshi) – Roli i Avokatit të Popullit, sigurisht, është edhe promovues dhe nxitës i standardeve të larta. Në këtë drejtim, unë do të luaja një rol aktiv në qoftë se do ta kisha këtë detyrë dhe, sigurisht, që rrugët për të shkuar dhe për të promovuar janë të shumta, duke pasur parasysh edhe faktin se kemi të bëjmë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive. Madje subjekti i këtij është kaq i gjerë, sa që edukimi, promovimi do të ishte një nga detyrat kryesore, të cilat Avokati i Popullit duhet t'i përfshinte në axhendën e tij të punës.

Për sa më sipër, referuar edhe eksperiencës sime, mendoj se përvoja ime e gjatë dhe profesionale do ta ngrinte këtë institucion në një nivel dhe një qasje tjetër dhe do të jepte, sigurisht, një impuls mjaft pozitiv edhe në marrëdhëniet e këtij institucioni me institucionet e tjera, si dhe

me shoqërinë civile, organizatat e huaja, me fokus kryesor mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Luzi, për ekspozenë tuaj!

Kush ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Luzi!

Kam një pyetje lidhur me hapat ose veprimet konkrete që ju duhet të bëni nëse përzgjidheni si Avokate e Popullit nga Kuvendi i Shqipërisë. Cilat masa parësore do të vlerësonit si të domosdoshme për të filluar punën tuaj?

Lefterie Luzi (Lleshi) – Sigurisht, puna do të vinte një herë pas një analize që duhet t'i bësh punës së mëparshme të të gjithë institucionit, duke parë realisht pikat e dobëta dhe problematikat të cilat ky institucion ka ngritur. Por do të thosha se ndër masat e para që do të merrja, dhe që është kryesore, është bashkëpunimi midis institucioneve: do të krijoja një mënyrë tjetër takimi dhe bashkëpunimi me të gjitha institucionet shtetërore.

Unë e thashë edhe në fjalën time, do të sugjeroja që çdo institucion të kishte një person kontakti, i cili të kishte lidhje me Avokatin e Popullit, për arsye se e gjithë veprimtaria e të gjitha institucioneve çdo ditë ka drejtpërdrejt lidhje me të drejtat dhe liritë e individit.

Sigurisht, masat janë të shumta. Unë do të shkoja edhe përtej faktit që ndoshta, në fakt, mendoj të rishikonim edhe strukturën e ngritur të Avokatit të Popullit. Me sa kam dijeni, ata kanë përshtatur modelin danez, por nuk është i vetmi model të cilit mund t'i referohemi, se mund të ketë edhe modele të tjera, të cilat mund të ofrojnë fleksibilitet në punën e Avokatit të Popullit, në mënyrë që puna e tij të jetë jo vetëm e dukshme, por edhe e prekshme. Ajo që është më kryesorja është që rekomandimet të mos jenë vetëm rekomandime që unë të bëj detyrën, por të jenë të prekshme dhe të zbatueshme nga institucionet të cilat duhet t'i zbatojnë.

Sigurisht, do të propozoja që të mos ngeleshim vetëm në kuadrin e rekomandimeve, por do të shkoja përtej, do të kërkoja që në rast se rekomandimet nuk zbatohen nga institucionet, atëherë duhet të kishim edhe një hap tjetër për të bërë të mundur që të realizonim, në fund të fundit, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; ndoshta vendosja e gjobave, ndoshta ndryshimi i ligjit në këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Luzi!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje.

Faleminderit për paraqitjen dhe për përgjigjet!

Ditë të mbarë!

Lefterie Luzi (Lleshi) – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Do të dëgjojmë kandidatin tjetër, zotin Anton Lleshaj.

Zoti Anton, ju keni ardhur edhe një herë tjetër përpara këtij komisioni. Mirë se keni ardhur edhe sot!

Anton Lleshaj – Mirë se ju gjeta!

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, siç jeni në dijeni, do ju duhet të paraqisni CV-në dhe vizionin tuaj për atë çka kandidoni për një kohë jo më shumë se 7 minuta, një kohë e respektuar edhe për kandidatët e tjerë, të cilët kanë marrë fjalën para jush.

Ju lutem, mund të filloni!

Anton Lleshaj – Faleminderit!

Për mua është rasti i dytë që po vij para këtij komisioni të nderuar për të aplikuar në pozicionin e Avokatit të Popullit, kam aplikuar edhe dy herë për kryetar të KQZ-së, edhe muajin që kaloi. CV-ja ime është vendosur dokumentacioni përkatës, ndaj po e paraqes disi shkurtimisht. Unë kam mbaruar gjimnazin ditën, Ekonomikun ditën, si dhe Fakultetin Juridik shtetëror. Kam punuar gjashtë vjet ekonomist plani; kam punuar për pesë vjet shef prapavije në repartin ushtarak dhe në mars të vitit 1995, me vendim të KLD-së kam kaluar si ndihmës gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Mirditë.

Me suprimimin e vendit të punës, në korrik të vitit 2000 është ngritur Qendra e Ndërmjetësimit, ku unë kam kaluar në rolin e koordinatorit, pozicion tek i cili vazhdoj deri në ditën e sotme.

Për sa i përket jetës sime profesionale kam vazhduar Fakultetin Juridik shtetëror, Tiranë. Gjatë punës sonë ne kemi pasur rezultate të mira, si koordinator i Qendrës së Ndërmjetësimit. Kemi ngritur grupin e punës pa dallim partiak dhe kemi realizuar shumë ndërmjetësime, pajtime deri në pajtime gjakmarrjeje, ku u realizua edhe një film për gjakmarrjen, film dokumentar, që ka ndikuar shumë në komunitetin tonë për parandalimin e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve deri në pajtimin e tyre.

Nuk kam marrë pjesë në organizata partie për arsye të funksioneve ku kam qenë. Jam pa parti, nuk kam qenë asnjëherë dhe vij nga shoqëria civile.

Lidhur me platformën time për pozicionin e Avokatit të Popullit, dua të paraqes para këtij komisioni se nga profesioni dhe përvoja kam mësuar se për të zgjidhur në mënyrë sa më efektive një çështje, përveç njohurive mbi legjislacionin, duhet edhe një bashkëpunim sa më i gjerë dhe gjithëpërfshirës me profesionistët e organeve të ndryshme të pushtetit lokal, vendor, organet e drejtësisë e të tjera.

Unë e kam paraqitur materialin edhe me shkrim, por po lexoj shkurt synimet e platformës për të cilën aplikoj: të drejtat e të miturve, të drejtat për fëmijët e rrugëve, ngritjen e dënimeve për pedofilët, për trafikantët e qenieve njerëzore, dhunën në familje, që është një veçori në sistemin tonë shqiptar, si ndjekja e rasteve të abuzimit, në bashkëveprimin për mbrojtjen e viktimave, zbatimi i vendimeve të gjykatave për masat e dhëna ndaj dhunës në familje, mbrojtja e viktimave.

Ndër pikat e tjera futet Qendra e Rehabilitimit dhe Burgjeve dhe Shërbimi i Provës. Me ndryshimin e Kushtetutës rëndësi i ka dhënë edhe sistemi i drejtësisë, që do të jetë prioritet kryesor në qoftë se na jepet mundësia.

Rastet e avokatit apo të prokurorit, të gjyqtarëve dhe rikthimi në punë i atyre që janë... Afati i shqyrtimit të dhënies së vendimeve dhe jo stërzgjatja që kanë arritur deri në dekada, marrja përsipër e monitorimit dhe shumë çështjeve për të drejtat e njeriut, si dhe për rastet e pamundësisë ekonomike.

Një pikë tjetër do të jetë ndërmjetësimi, që është një hallkë paragjyqësore që ndikon në uljen e vendimeve gjyqësore, si dhe shpejton në çështje, i lë palët në mirëkuptim dhe sjell reduktimin e çështjeve gjyqësore.

Pikë tjetër do të jetë shërbimi shëndetësor, personat në nevojë, minoritetet dhe rastet e veçanta.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, jam në pritje të pyetjeve në qoftë se keni.

Fatmir Xhafaj – Edhe ne ju falënderojmë që ishit shumë konçiz, pra nuk e konsumuat të gjithë kohën në paraqitjen tuaj!

Ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Ju keni qenë edhe një herë tjetër, në fakt, këtu...

Fatmir Xhafaj – Po, për kryetar KQZ-je.

Vasilika Hysi – ...lidhur me pozicionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por unë dua të bëj një pyetje lidhur me kërkesat që ka Kushtetuta dhe ligji. Ligji kërkon që kandidati për Avokatin e Popullit duhet të plotësojë, midis shumë kriteresh, të cilat ju i përmendët, si arsimit e të tjera, dy kriteret ose kushte.

Së pari, të ketë njohuri dhe veprimtari të shquar në fushën e lirisë dhe të drejtave të njeriut, si dhe të ligjit, dhe të shquhet për aftësitë profesionale në këtë fushë. Si mund ta provoni ju para komisionit dhe më pas të bindni seancën plenare që ju i plotësoni këto dy kushte?

Anton Lleshaj – Unë mendoj se këto dy kushte i plotësoj më shumë sesa të gjitha fushat e tjera për dy arsye: për shkollën përkatëse që kam, përvojën e punës dhe faktin se kam 22 vjet që merrem me organet e drejtësisë: 5 vjet në gjyqësor, ku edhe kam pasur rezultate, edhe si avokat, detyrë të cilën e ushtroj aktualisht, kam edhe çështje konkrete, po nuk po u hyj. Ne kemi pasur të dënuar me 7 vjet, me vendim të shkurtuar dhe është në shtëpi, ndërsa të tjerë janë dënuar në mungesë me 20 vjet dhe nuk kanë pranuar të bëhet gjyq. Pra, kam një eksperiencë në fushën e ndërmjetësimit dhe kemi pasur rezultat, siç e thashë edhe më lart, madje është realizuar edhe një film për gjakmarrjen, për të mos rënë në përsëritje, por kemi pasur edhe ekspertë të huaj, ndërkombëtarë (i kam paraqitur këto në dosje komplet), kemi qenë në Danimarkë.

Kur kam konkurruar radhën e parë për Avokat të Popullit, një organ i shtypit thoshte se emri im është i publikuar. Fatmirësisht, qendrën tonë e kanë vizituar: sekretari i ambasadës gjermane, zëvendëssekretari i ambasadës gjermane, i cili ka marrë pjesë edhe në dregën e filmit. Kur është hapur Qendra e Ndërmjetësimit ka marrë pjesë ambasadori i Norvegjisë, si dhe ka ardhur një grup norvegjezësh, juristë dhe avokatë, të cilët kanë publikuar edhe në organet e shtypit në Danimarkë dhe në Norvegji, ku janë habitur se si ka mundësi që kjo qendër bashkëpunon me pushtetin lokal dhe komisariatit.

Për të gjitha këto ne kemi edhe një rezultat tjetër, që në shkallë republike në komunitetin tonë nuk ka asnjë fëmijë dhe asnjë grua të ngujuar. Kjo për arsye të grupit të punës sonë që kemi pasur rezultate dhe i kemi paraprirë ndërmjetësimin, pajtimin.

Megjithatë, unë i kam të gjitha materialet në dosje, por dua të them që të kesh ekonomik, juridik dhe 22 vjet punë në organet e drejtësisë, plus rezultatet pozitive mendoj se do të arrij t'i justifikoj.

Kam edhe rekomandime nga shoqëria civile, nga profesor Mark Marku, nga profesor Maksimi, nga profesoret Mariana Semini, si dhe nga profesor Ismet Elezi.

Pra, dua të them që në fushën e drejtësisë, madje shumëkush më thotë ndonjëherë: “A je artist filmi, apo a je jurist?”, sepse puna jonë në komitet, de facto, avokatë jemi, por kemi pasur rezultate pune.

Kemi kënaqësinë që kemi rezultate pune dhe njohje të legjislacionit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Nuk ka pyetje të tjera për ju.

Ditë të mbarë!

Tani është radha e kandidatit zotit Bujar Madani.

Bujar Madani – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Pastaj e ka radhën kandidatja Erinda Ndroqi.

Bujar Madani – Mirëdita!

Fatmir Xhafaj – Zoti Madani, mirë se keni ardhur!

Bujar Madani – Mirë se ju gjeta!

Fatmir Xhafaj – Ju keni paraqitur kërkesën për të kandiduar për funksionin e Avokatit të Popullit, keni dorëzuar dokumentet dhe sot jeni këtu në këtë seancë dëgjimore për t’u prezantuar.

Siç jeni njoftuar, koha gjatë së cilës do të duhet ta bëni këtë paraqitje nuk mund të jetë më shumë sesa 7 minuta. Prandaj, ju lutem, mund të filloni.

Bujar Madani – Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Duke nisur nga mënyra si e perceptoj unë, sipas ligjit, punën e institucionit kushtetues të Avokatit të Popullit: institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion i ri kushtetues dhe i pavarur, i ndërtuar sipas modelit suedezo-danez, me profil investigues dhe ndërmjetësues, institucion në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ka një vendim unifikues nr. 49/2000 vetëm për rastet kur aktet normative të nxjerra nga administrata publike dhe ato që evidentohen të jenë të papajtueshme me Kushtetutën.

Për t’i mundësuar Avokatit të Popullit kontrollin e vetë organizmave që e kanë zgjedhur, njëkohësisht është edhe pavarësia e Avokatit të Popullit, sipas Komisionit të Venecias, nënkupton dhe percepton si i pavarur nga politika, sepse pa këto elemente Avokati i Popullit do të ishte joefektiv, kriter kyç që Avokati i Popullit të jetë i vlerësuar nga opinioni publik, i besueshëm dhe i respektuar nga publiku.

Shërbimi i avokatit ndihmon që individëve t'u krijohen shanse të barabarta, që mund t'i trajtojnë si të barabartë në çdo marrëdhënie administrative. Kjo arrihet kryesisht në bazë të bisedimeve pa anësi dhe standardeve më të gjera të drejtësisë për të rregulluar raportin midis shtetit dhe individit. Në këtë drejtim, krahas mbrojtjes së të drejtave të njeriut, që është një nga synimet kryesore të Avokatit të Popullit, është që ai të zhvillojë atë që quhet kulturë të qeverisjes së mirë. Ky nocion përmban administrimin e mirë të pronës publike, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike, pranë njerëzve që paguajnë taksat për ta mbajtur atë.

Mundohet ta edukojë administratën duke bërë që ajo të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve. Avokati i Popullit duhet të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së tij është të jetë shërbëtor për t'u shërbyer qytetarëve dhe të realizojë të drejtat e tyre.

Përveç pavarësisë nga qeveria dhe nga çdo ndikim të lehtësisë dhe të fleksibilitetit në kapjen e problemeve, sidomos është efektive edhe forca e rekomandimit të tij.

Avokati i Popullit duhet të zhvillojë takime me individë edhe jashtë zyrës në rrethe të ndryshme të vendit. Kontrolli i veprimtarisë së organeve të administratës publike është kompetencë e gjykatave administrative.

Nëse e analizojmë sistemin e drejtësisë administrative në Shqipëri, marrëdhëniet individ-administratë, që kanë të bëjnë me standardet e qeverisë së duhur, organet administrative duhet të veprojnë ashtu siç logjikisht pret populli një sjellje administrative ndaj tij.

Avokati duhet të jetë zgjedhja e parë që një individ të zgjidhet, pra duhet të jetë zgjidhja e parë. Populli duhet t'i drejtohet direkt Avokatit të Popullit. Në kompetencat që ai ka duhet të zgjerojë hetimin në çështje të thella administrative, e bën atë të adresojë problemet që ndihmojnë prodhimin dhe një qeverisje demokratike të hapur dhe të përgjegjshme.

Procesi hetimor i kryer nga avokati konsiderohet gjithnjë e më shumë si proces i saktë dhe efektiv, më tepër sesa institucionet e tjera.

Në të vërtetë, shqyrtimi i rasteve nga Avokati i Popullit nuk ka seancë dëgjimore, por ka një ndërmarrje veprimesh, në kuadër të hetimeve që rezultojnë po aq të suksesshme sa mund të jetë një proces i mirëfilltë gjyqësor.

Pse unë po konkurroj për Avokat të Popullit? Jo vetëm sepse plotësoj kushtet ligjore, por edhe siç e kam shpjeguar edhe në CV-në time, kam kryer trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, që janë organizuar nga partnerët ndërkombëtarë, ku kanë marrë juristë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, por kam edhe njohuri për ligjin dhe përvojë të gjatë pune.

Karriera ime prej 21 vjetësh në prokurorinë e Vlorës, të Gjirokastrës dhe të Tropojës, si dhe kjo e fundit, ku jam transferuar në prokurorinë e Fierit, ka qenë një sfidë personale dhe kam punuar me përkushtim, profesionalizëm, paanësi dhe kam qenë i drejtë dhe i pavarur. Kam ruajtur figurën e pastër etiko-morale, ku gëzoj respekt nga komuniteti dhe njerëzit në rrethet ku kam punuar.

Në këta 21 vjet kam pasur fatin të jem afër dhe t'i di më shumë problemet e njerëzve në marrëdhënie me administratën dhe institucionet shtetërore dhe gjyqësore, ku në disa raste kam qenë edhe unë në rolin e një individi mes marrëdhënieve institucion-administratë publike dhe atë gjyqësore.

Pra, i kam njohur nga afër problemet dhe kuptoj, madje e di sesi zgjidhen problemet për popullin në raport me administratën publike dhe institucionet shtetërore dhe ato gjyqësore, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Por për të qenë i sinqertë, kërkoj nga deputetët e Kuvendit që nëse ju bind të më përzgjidhni, ky do të jetë një shpërblim i merituar për karrierën time të gjatë dhe të vështirë të këtyre 21 vjetëve në prokurorinë e Vlorës, të Gjirokastrës, të Tropojës dhe tani në Fier, por që do të jetë një përgjegjësi dhe sfidë tjetër për mua, për të çuar përpara punën e bërë në këto vite nga të gjithë avokatët e Popullit që janë përzgjedhur më parë nga Kuvendi, për të rritur cilësinë, shpejtësinë dhe zgjidhjen reale ndaj problemeve që kanë individët në raport me administratën publike dhe marrëdhëniet me shtetin, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të sanksionuara në Kushtetutë dhe aktet ligjore ndërkombëtare të ratifikuara, duke zbatuar ligjin “Për Avokatin e Popullit”, gjithashtu, për t'i dhënë shtytje më tepër mbrojtjes së interesave të ligjshme të individit në raport me administratën publike, siç e parashikon Kushtetuta dhe ligji “Për avokatinë”.

Nisur nga arsimimi që kam kryer, por edhe nga përvoja e gjatë 21-vjeçare në prokurori, që është institucion i pavarur dhe i depolitizuar, gjatë viteve të fundit unë kam kryer hetime dhe i njoh metodat e hetimit dhe procedurat ligjore nga lidhjet e punës sime me individët dhe me administratën publike, institucionet shtetërore dhe gjyqësore.

Kjo është afërsisht e njëjtë me detyrat që ka Avokati i Popullit, pasi edhe ky pozicion ndërmerr një proces hetimi dhe kryen sipas ligjit “Për Avokatin e Popullit” që sanksionohet në nenet 18, 19 dhe 20 të tij.

Ky fakt më ka detyruar të konkurroj për pozicionin e Avokatit të Popullit jo vetëm për të mirën e karrierës sime, por edhe për të mirën e funksionimit të zbatimit të detyrave kushtetuese dhe ligjore të institucionit kushtetues të Avokatit të Popullit.

Unë e kuptoj se ka mendime që Avokati i Popullit mund të jetë një akademik apo profesor, por unë shpreh mendimin se Avokati i Popullit duhet të jetë një person që plotëson kushtet ligjore, që ka një përvojë pune dhe ka treguar aftësi menaxhuese në jetën e tij dhe të jetë një administrator i mirë.

Lidhur me këtë aspekt, unë kam kryer një master shkencor për administrim dhe kam një eksperiencë pune si oficer i Policisë Gjyqësore. Kjo ngjashmëri për sa i takon kryerjes së veprimeve hetimore dhe teknikat e hetimit.

Një oficer i Policisë Gjyqësore, jurist i prokurorisë, duhet ta kuptojmë, të nderuar deputetë, merr dhe administron kallëzime, ankime; merr në pyetje dhe administron prova, kryen hetime dhe relatton në përfundim të hetimit.

Ndërsa Avokati i Popullit pranon kërkesa, ankesa dhe kryen hetime; kërkon shpjegime, merr pyetje dhe administron prova, si dhe në fund rekomandime.

Pra, ka një ngjashmëri për sa u takon detyrave dhe mënyrës së kryerjes së detyrës funksionale të Avokatit të Popullit, midis oficerit të Policisë Gjyqësore në prokurori dhe avokatit.

(Mbaron koha e prezantimit.)

Po.

Fatmir Xhafaj – Koha që ishte caktuar për ju ishte 7 minuta.

Ka ndonjë pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Madani!

Nga CV-ja juaj rezulton se pothuajse të gjithë karrierën e keni si oficer të Policisë Gjyqësore në prokurori të ndryshme.

Bujar Madani – Po.

Vasilika Hysi – Besoj se ju ka lidhur puna edhe me zyrën e Avokatit të Popullit.

Bujar Madani – Sigurisht.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje: nëse Kuvendi do t'ju përzgjedhë për të qenë Avokat i Popullit, cilat do të ishin tri prioritetet ose përparësitë në punën tuaj?

Pyetja e dytë është: në raport me Avokatin e sotëm të Popullit, i cili është, gjithashtu, një kandidat, cilat janë përparësitë tuaja?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Madani, ju lutem, shkurt.

Bujar Madani – Sapo ta marr detyrën do të bëj një analizë të punës dhe të gjendjes aktuale të këtij institucioni.

Vasilika Hysi – Jo, jo, m’u përgjigjini pyetjeve!

Dua tri gjëra që...

Bujar Madani – Çfarë do të ndryshoj?

Ndryshimi do të fillojë që me marrjen e detyrës, duke u nisur nga karakteri, nga tipi im, aftësia ime menaxhuese, pra nisur nga vetë personi. Më pas do të japim një temp në lidhje me hetimin me iniciativë të problemeve që kanë individët me administratën publike.

Së dyti, do të kem në staf një grup akademikësh, të cilët kanë njohuri në të drejtat e njeriut, ku do të shikojmë, të verifikojmë legjislacionin shqiptar dhe aktet nënligjore që nxjerr administrata në marrëdhënie me Gjykatën Kushtetuese, sepse është një prioritet tjetër.

Së treti, donatorët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk arrita ta lexoj në fjalën time, por krijimi i një fondi të veçantë për donacione të ndryshme që t’i administrojë Avokati i Popullit në raste fatkeqësie, sepse për njerëzit në nevojë... Pra, një fytyrë tjetër në problemet e drejtimit të hetimit, sepse nuk është problemi vetëm me ankesa, duhet të shkojë ta kërkojë provën, pra Avokati i Popullit të kërkojë shkeljen e ligjit, me iniciativë, të mos qëndrojë vetëm tek ankesat. Pra, të kryejë veprime me iniciativë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është një rast: deri më sot, veprime ka pasur me iniciativë, por problemet e individit me administratën janë më të gjera sesa ato që duken deri tani dhe është punuar nga Avokati i Popullit, zoti Totozani, jo se dua të hedh poshtë punën e tij.

Zoti Totozani ka punuar si çdo avokat Populli që është përzgjedhur, se duhet t’i vlerësojmë edhe të mëparshmit. Atë punë që ka bërë zoti Totozani do ta çoj më tej, duke u nisur edhe nga tipi, nga aftësitë menaxhuese, nga arsimi dhe nga përvoja ime si oficer i Policisë Gjyqësore.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Faleminderit, zoti Madani! Nuk ka pyetje të tjera për ju.

Ditë të mbarë!

Bujar Madani – Faleminderit edhe juve!

Mirupafshim!

Fatmir Xhafaj – Tani do të dëgjojmë zonjën Erinda Ndroqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Ndroqi, mirë se kenë ardhur!

Ju kenë paraqitur interes për të kandiduar, për të qenë një kandidate e mundshme që për zgjidhet nga Kuvendi për funksionin e Avokatit të Popullit.

Jeni thirrur në këtë seancë dëgjimore për t'u dëgjuar rreth vizionit tuaj lidhur me këtë projekt.

Siç jeni njoftuar dhe siç është praktikuar edhe me kandidatët e tjerë para jush, koha që do të duhet ta bëni prezantimin është jo më shumë se 7 minuta. Kështu që mund të filloni, ju lutem, për të paraqitur platformën tuaj.

Erinda Ndroqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Me thënë të drejtën, për mua është kënaqësi shumë e veçantë që u krijua kjo mundësi qoftë për kandidimin tim personal, qoftë edhe për të sfiduar veten, le të themi, në këtë ndërmarrje kaq të madhe dhe kaq të rëndësishme, siç është institucioni i Avokatit të Popullit.

Për hir të së vërtetës, përvoja ime me punën, me institucionin e Avokatit të Popullit, por në përgjithësi edhe kontributi im në angazhimin me shoqërinë civile ka qenë i vazhdueshëm, i përhershëm dhe që prej krijimit të këtij institucioni.

Gjatë gjithë këtyre viteve kam pasur mundësinë të angazhohem me disa nisma ligjore, ku, ndër më të rëndësishme, mund të themi se kanë kontribuar drejtpërdrejt në konsolidimin e mekanizmave ekzistues të Avokatit të Popullit, ka qenë mekanizmi për parandalimin e torturës, një instrument ky në dorën e Avokatit të Popullit, i cili, përveç misionit të drejtpërdrejtë të investigimit dhe adresimit të rasteve të torturës, ka pasur edhe konceptin e parandalimit si një ndërhyrje, le të themi, që i shtohet Avokatit të Popullit në morinë e mandatit të tij institucional, kushtetues dhe ligjor.

Në perceptimin tim të problematikave që duhen adresuar ose duhen mbajtur parasysh për përmirësimin e punës së Avokatit të Popullit, mendoj se ndër instrumentet ose ndër ndërhyrjet kryesore mund të jenë ato që lidhen drejtpërdrejt me mekanizmat që janë sot, që funksionojnë.

Një mirëkoordinim, një riorganizim i strukturës së brendshme, në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor që ekziston sot, me nevojën për minimizimin ose shmangien e konfliktit të interesit, për nevojën për garantimin e integritetit dhe pastërtisë së figurës së çdo profesionisti që kontribuon në këtë institucion, mendoj se Avokati i Popullit ka patjetër mundësi dhe potenciale të pashfrytëzuara për adresimin e mekanizmave në mënyrë shteruese.

Përveç këtij roli, që mund të themi se e ka kushtetues dhe ligjor në adresimin e problematikës, mendoj se një kontribut i veçantë ose një vëmendje specifike mund t'i adresohet nevojës për hartëzimin për tipologjinë e mekanizmave, madje edhe të shkeljeve që adresohen nga ky institucion.

Ne kemi sot një praktikë të mirë lidhur me raportet që institucioni i Avokatit të Popullit i adreson parlamentit, por nuk kemi një mundësi konkrete ose një transparencë lidhur me rastet specifike që adreson ky institucion.

Adresimi, ngritja e një sistemi të menaxhuar të rasteve është një risi që mund të ridimensionojë konceptimin dhe adresimin e problematikave.

Për sa i përket një roli më proaktiv lidhur me procesin e reformës në drejtësi, mendoj se roli mbikëqyrës që ai ka deri më sot nuk e përcakton, nuk i jep pozicionimin e tij specifik. Nuk mund të jetë Avokati i Popullit vetëm në rolin e një *mailbox*-i kur vjen puna për kandidaturat e rëndësishme nga të gjitha... ose të gjitha llojet e kandidaturave si për KLGJ-në, ashtu për KLP-në.

Mendoj, gjithashtu, se Avokati i Popullit gjatë gjithë kësaj periudhe nuk e ka luajtur ashtu siç duhet rolin në lidhje me Kuvendin e Shqipërisë. Raportet e tij, në ndryshim nga praktika e mëparshme, nuk kanë pasur mundësinë as të paraqiten, ose vetë Avokati i Popullit t'i adresohet drejtpërdrejt.

Gjithashtu, raportet tematike ose specifike, analitike, kanë qenë të mangëta dhe rekomandimet kanë qenë thjesht në kuadër të komisioneve specifike. Ai e ka në mandatin e tij, në kuadrin e tij ligjor, në strukturën e tij që, përveç rasteve të raporteve vjetore, dhe presupozohet që është Avokati i Popullit ai që, në fund të fundit, do të bëjë një lloj vlerësimi të përgjithshëm të situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri, të adresojë çështje tematike, probleme tematike, raporte analitike.

Prandaj rekomandova që në fillim pjesën e një sistemi të integruar të rasteve dhe databazën, siç e ka praktika e shoqërisë civile, është shumë e mirë, të jep mundësinë të zhvillosh instrumente matëse analitike dhe shumë praktike edhe për transparencën dhe për llogaridhënien e institucionit.

Mendoj se ka shumë për të përmirësuar rolin e tij specifikisht në lidhje me Gjykatën Kushtetuese. Është i pashfrytëzuar ose edhe në ato kur është adresuar, nuk është bërë në kohën e duhur dhe nuk ka qenë me tempin e momentit ose duke adresuar rastin sipas tipologjisë së tij.

Një nevojë e posaçme sërish dhe që duhet eksploruar jo vetëm në fillim kur merret mandati, por gjatë gjithë mandatit të Avokatit të Popullit është edukimi qytetar.

Lidhur me rolin aktiv për adresimin e problematikave, Avokati i Popullit është një nga institucione që është, le të themi, i plotësuar nga pikëpamja e burimeve njerëzore ose infrastrukture. Është shumë e rëndësishme që këto potenciale të adresohen dhe të jenë konstante.

E fundit dhe ndoshta jo më pak e rëndësishme për t'u adresuar është puna që duhet bërë nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, në përgjithësi me shoqërinë civile.

Pavarësisht ndryshimeve ligjore...

(Zonjës Ndroqi i mbaron koha e prezantimit.)

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Ndryshimet ligjore ia krijojnë këtë mundësi të eksplorimit dhe të konsolidimit të bashkëpunimit. Mendoj se institucionalizimi i shoqërisë civile, si pjesë e punës së Avokatit të Popullit, mund të jetë një risi.

Faleminderit shumë!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ndroqi!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ndroqi!

Ju përmendët në pjesën e strategjisë disa shtylla. Midis shtyllës së organizimit të rrjetit të regjistrimit të ankesave dhe ndryshimit të mënyrës së trajtimit të ankesave, riorganizimit institucional, marrëdhënieve me institucionet dhe shoqërinë civile, kë do të vlerësonit si më parësore në punën tuaj nëse Kuvendi do t'ju mandatonte për të qenë Avokate e Popullit?

Erinda Ndroqi – Faleminderit!

Mendoj se i pari dhe prioritari është sistemi i adresimit të ankesave për shkak edhe të vetë mandatit të dhënë nga Kushtetuta dhe ligji “Për funksionimin e Avokatit të Popullit”.

Mendoj se riorganizimi institucional, në funksion të mirorganizimit dhe adresimit të të gjitha problematikave, ankesave, kërkesave, nevojave për bashkëpunim e të tjera do të shkojnë hap pas hapi.

Hapi i parë dhe cilësor, le të themi, është ridimensionimi i potencialeve të Avokatit të Popullit, i të gjithë organizmit, le të themi, institucional. Më pas, ky lloj organizimi specifik në shmangie, siç e përmenda, të çdo konflikti interesi, në garantim të integritetit të profesionistëve që punojnë dhe do të punojnë nesër pranë institucionit të Avokatit të Popullit, mendoj se janë disa elemente që duhen garantuar pavarësisht pjesës së reformës në vijim.

Unë mendoj se struktura ose organizimi specifik me këtë lloj formati do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në impaktin e punës praktikisht, pra në adresimin e problematikave të shumta të mbartura, shpeshherë, për fat të keq, edhe me vite të tëra të Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Ndroqi!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Ndroqi që ishit këtu dhe për prezantimin që bëtë!

Ditë të mbarë!

Erinda Ndroqi – Faleminderit edhe juve!

Fatmir Xhafaj – Tani është radha për zonjën Suzana Pasha dhe pastaj për zonjën Peti.

(Diskutime në sallë.)

Zonja Pasha, siç jeni njoftuar, do të paraqisni kandidaturën tuaj për funksionin e Avokatit të Popullit. Do t’ju lutesha të mbani në konsideratë faktin se koha e prezantimit është 7 minuta.

Mund të filloni, ju lutem!

Suzana Pasha – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Unë, Suzana Pasha, iu drejtova Kuvendit të Shqipërisë me kërkesë për shprehje interesi për të kandiduar për vendin vakant të Avokatit të Popullit, sepse mendoj se plotësoj të gjitha kriteret e parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 8458, si dhe besoj fort se, si asnjëherë tjetër, Kuvendi i Shqipërisë ka nisur një garë të ndershme, të hapur dhe transparente për këtë funksion të rëndësishëm kushtetues.

Të nderuar zotërinj,

Kam mbaruar arsimin e lartë juridik në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dhe jam diplomuar si juriste. Gjatë vitit 2012-2013 kam kryer studimet me kohë të plotë në programin master profesional *Business Law* në këtë fakultet.

Gjatë vitit 2015-2016 kam kryer një sërë trajnimesh në fushën penale, civile, të drejtat e individëve, të drejtat e fëmijëve e të tjerë.

Me vendimin nr. 1 të datës 01.07.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë jam emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Mat, punë të cilën e kam kryer deri në vitin 2000, kohë në të cilën ky vend u suprimua.

Në datën 17.06.2000 kam fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e lirë të avokatit dhe këtë profesion mendoj se e kam kryer për rreth 17 vjet me dinjitet, profesionalizëm, përkushtim në këtë detyrë.

Arsyet që më nxitën të shpreh interes për këtë vend vakant është pasi besoj fort se kam aftësitë profesionale për ta ushtruar këtë detyrë. Eksperienca e gjatë e punës prej 17 vjetësh, përfaqësimi në të gjitha nivelet e gjyqësorit çështje të ndryshme, si civile, penale, administrative, familjare, tregtare më kanë dhënë aftësitë e duhura, ndër të tjera, edhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Ushtrimi i kësaj detyre për një periudhë të gjatë kohe më ka dhënë mundësinë të dëgjoj dhe të kuptoj më mirë shkeljen e të drejtave të individit dhe, nga ana tjetër, më ka dhënë mundësinë të luftoj fuqishëm për rivendosjen e tyre.

Së dyti, profesioni i avokatit më është bërë jo vetëm përditshmëria ime, por pasion dhe determinues për të ardhmen.

Duke qenë Avokat i Popullit, e shoh veten brenda funksionit të avokatit, por me mundësi më të mëdha për të luftuar në rivendosjen e të drejtave të shkelura.

Fakti se im atë është ndarë nga jeta kur unë isha dhjetë vjeçe dhe jam rritur në një familje së cilës i është dashur të përballet me një jetë të vështirë, së qenit femër në një zonë me mentalitet më ka bërë edhe më të fortë dhe kërkuese në jetë. Nga ana tjetër, kjo amalgamë ndjenjash ka rritur brenda meje instiktin e reagimit kundrejt çdo lloj padrejtësie.

Së treti, besoj se zotëroj aftësi shumë të mira menaxhuese për të koordinuar punën në grup.

Platforma e punës sime, nëse zgjidhem Avokate e Popullit, në ushtrimin e detyrës do të punoj fort për respektimin dhe mbrojtjen e lirive të individit, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në konventat ndërkombëtare, ligjet materiale dhe procedurale, duke respektuar parimet themelore të ushtrimit të profesionit të Avokatit të Popullit, si pavarësia, paanshmëria, ligjshmëria, kushtetutshmëria, transparenca e të tjerë.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të ketë nxitjen dhe kontrollin tim të vazhdueshëm për trajtimin e çdo pretendimi, kërkesë apo ankese të individit ose grupeve shoqërore vulnerabël, duke garantuar një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm.

Nën drejtimin tim ky institucion do të jetë jo vetëm veshi, por edhe dora dhe mendja e çdo personi, që ndihet i diskriminuar apo i cenuar në lidhje me të drejtat e tij themelore. Kjo do të realizohet nëpërmjet ushtrimit të të gjitha të drejtave që i garanton ligji “Për Avokatin e Popullit”, për të investuar gjykatat apo për të nxitur organet e administratës shtetërore të ndërmarrë veprimet e duhura.

Një nga nismat e para do të ishte hartimi i një pakete ndryshimesh ligjore të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ligjeve procedurale penale e të tjerë, nëpërmjet të cilave të mundësojë që në çdo proces penal ndaj një të mituri, organet e ndjekjes penale të kishin detyrim ligjor të njoftonin Avokatin e Popullit, pjesëmarrja e të cilit në këtë procedurë të veçantë do të ishte një garantues më shumë i respektimit të të drejtave dhe lirive të të miturit.

Një tjetër sfidë në ushtrimin e kësaj detyre do të ishte përpjekja për të ndryshuar paksa përfaqshen vetëm rekomanduese të deritanishme të Avokatit të Popullit, në funksion të realizimit të kësaj sfide. Në terma konkretë, do të jetë propozimi që në kuadër të reformës në drejtësi, të ndryshojë ligjin për Avokatin e Popullit, duke mos e kufizuar veprimtarinë e tij vetëm në kryerjen e hetimeve dhe rekomandimeve, sipas nenit 21 të këtij ligji, por duke bërë të mundur që në rastet e mosmarrjes në konsideratë të rekomandimeve Avokati i Popullit të kishte të drejtë të merrte edhe masa administrative.

Duke ju falënderuar për mundësinë që na ofruat, uroj dhe besoj se çdokush i zgjedhur si Avokat i Popullit të punojë fort në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Uroj të fitojë më i miri!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Pasha!

Ka pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Pasha Hoti dhe sinqerisht sot ndihem jashtëzakonisht mirë që ne kemi kandidatura nga gjithë bashkitë ose, do të thosha, zonat nga Veriu në Jug, pra jo vetëm nga Tirana!

Kam një pyetje që lidhet me strategjinë ose vizionin tuaj për institucionin e Avokatit të Popullit. Përmendët në fjalën tuaj se do të kërkonti ndryshim ligjor, që Avokati i Popullit të jetë i pranishëm, të njoftohet në çdo proces gjyqësor.

Unë e kuptoj ndjeshmërinë tuaj si avokate prej 17 vjetësh dhe gjithë problematikën që ka sistemi i drejtësisë, por nga ana tjetër Kushtetuta thotë që Avokati i Popullit monitoron dhe merret me respektimin e lirive dhe të drejtave nga administrata publike.

Suzana Pasha – E qartë.

Vasilika Hysi – Ndryshimet që ne kemi bërë në vitin 2005 në ligjin “Për Avokatin e Popullit” kanë qenë goxha të debatueshme për raportin e tij me sistemin gjyqësor, me vendimet e gjykatës.

A e mendoni ju se ky propozim apo kjo qasje juaja mund të çojë në shkeljen e Kushtetutës dhe të rolit që ka Avokati i Popullit në të gjitha vendet, ku ekziston si institucion.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zonja Pasha për t’u përgjigjur!

Suzana Pasha – Po, zonja Vasilika. E kam fjalën që ligjet të ndryshohen në unison me njëra-tjetrën dhe jo të kundërshtojnë njëra-tjetrën. Nisur nga fakti që kam një periudhë të gjatë që punoj si avokate dhe që i mituri gëzon dhe do një mbrojtje të veçantë, jam dakord që Avokati i Popullit mbikëqyr dhe sugjeron. Unë mendoj se do të ishte e udhës të ishte e shkruar dhe e zbatuar qartë një gjë e tillë, sepse ata ndodhen përballë çdo situatë dhe nëse nuk trajtohen mirë, nëse nuk ka kush t’i kontrollojë, për një faj të fëmijërisë, mendoj se jeta e tyre nuk do të niste mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord që ne t’i mbrojmë, por mbikëqyrja dhe mbrojtja nga Avokati i Popullit është më...

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Gjithë të mirat!

Suzana Pasha – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me kandidaten tjetër, me zonjën Zhaklina Peto.

Zhaklina Peto – Përshëndetje!

Fatmir Xhafaj – Ju keni shprehur interesin për të kandiduar për postin e Avokatit të Popullit, keni paraqitur dokumentet përkatëse në formën e kërkuar nga ligji dhe jeni sot këtu për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore. Siç jeni njoftuar dhe siç është vepruar edhe me kandidatët paraardhës, koha për t’u prezantuar dhe për të paraqitur vizionin tuaj, lidhur me këtë funksion të rëndësishëm, është 7 minuta. Do t’ju lutesha ta respektoni, ndërkohë edhe unë do të bëj të njëjtën gjë duke e monitoruar atë.

Fjala është për ju.

Zhaklina Peto – Faleminderit!

Unë quhem Zhaklina Peto dhe jam pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, në Departamentin e së Drejtës Civile. Gjatë gjithë periudhës si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, kam realizuar hap pas hapi të gjitha kërkesat në lidhje me shkallën e kualifikimit tim shkencor dhe profesional dhe aktualisht mbaj titullin “Profesor Doktor”. Përvoja ime shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies, si lektore e disa moduleve në nivelin Bachelor, Master dhe Doktoraturë, më ka ndihmuar për të qenë një njohëse shumë e mirë e doktrinës dhe e jurisprudencës së vendit dhe asaj të huaj. Formimi im akademik, rreshton edhe disa tekste dhe botime universitare dhe publikime shkencore me karakter kombëtar, ndërkombëtar në revista me faktor impakti.

Gjithashtu, unë kam mbajtur disa pozicione në organet kolegjiale të Fakultetit të Drejtësisë: jam zgjedhur dy herë anëtare e Këshillit Shkencor e Fakultetit të Drejtësisë, jam zgjedhur anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, kam qenë anëtare e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe aktualisht, jam përgjegjëse në Departamentin e së Drejtës Civile, një pozicion të cilin e kam fituar nëpërmjet zgjedhjeve në dy mandate rresht. Duke menduar se CV-ja ime dhe unë personalisht, plotësoj të gjitha kushtet formale dhe integritetin moral personal, këto ishin arsyet që më shtynë për të kandiduar për pozicionin e Avokatit të Popullit.

Unë kam përgatitur një platformë të shkurtër me vizionin dhe mënyrën si e shoh unë pozicionin e Avokatit të Popullit. E kam përgatitur në formën e një *booklet*-i dhe mund t’jua shpërndaj. Unë kam ngritur një vizion të tillë: kryesisht do të fokusohem në rolin aktiv të Avokatit të Popullit, në evidentimin e tij, si një aleat i zgjidhjes së problemeve në lidhje me zbatimin e të

drejtave të individëve, një aleat i shoqërisë, i medias, një bashkëpunëtor i institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale, një mbrojtës i të drejtave, i detyrimeve dhe i interesave të individit.

Mendoj, se çdo drejtues duhet të udhëhiqet në punën e tij duhet të ketë disa sfida personale në lidhje me institucionin e Avokatit të Popullit që ai do të drejtojë, si një institucion i rëndësishëm së veçantë në kuadër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet të jetë një mekanizëm shumë efektiv. Duhet rritja e cilësisë së shërbimeve, në pranimin e ankesave dhe zgjidhjen e këtyre problemeve deri në fund, deri në dhënien e rekomandimeve.

Gjithashtu, duhet të jetë një sfidë në drejtimin e këtij institucioni, ruajtja e pavarësisë dhe e paanësisë. Me ndryshimet kushtetuese, pozicioni i Avokatit të Popullit ka marrë një konotacion krejt tjetër, pra i është kushtuar më shumë rëndësi. Nisur nga ky fakt, zbatimi i pavarësisë dhe i paanësisë, jo vetëm institucionale, por edhe personale në raport me politikën apo dhe me institucionet e tjera, ka vlera të veçanta dhe konsiderohet një sfidë në lidhje me këtë.

Rritja e bashkëpunimit institucional brenda dhe jashtë vendit, është një sfidë tjetër e rëndësishme në lidhje me përmirësimin e punës së Avokatit të Popullit. Në drejtimin e këtij institucioni, mendoj se do të mbështetem në disa parime të rëndësishme, të cilat të gjitha qeverisjet europiane i konsiderojnë si armë të fortë: paanësia, neutraliteti, konfidencialiteti, profesionalizmi, garancia, ligjshmëria, transparenca dhe universaliteti.

Unë kam paraqitur disa objektiva dhe në *booklet*-in e paraqitur janë në mënyrë të detajuar. Këtu do të përpiqem t'i them shumë shkurt. Në *booklet* është paraqitur edhe mënyra se si, cilat janë mekanizmat që do të ndjek për të arritur tek objektivat dhe çfarë rekomandoj unë, në lidhje me rrugët që do t'i zgjidhin këto objektiva.

Kam përmendur evidentimin e rolit edukativ të Avokatit të Popullit. Çfarë përfitojmë nga kjo? Përfitojmë një shtrirje më të gjerë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit në drejtim të subjekteve. Ne sot nuk kemi asnjë indikacion që të arrijmë në konkluzione dhe të themi që Avokati i Popullit është një institucion i rëndësishëm nga Jugu në Veri, në zonat rurale dhe në zonat urbane, pra kemi një pikëpyetje shumë të madhe. Në lidhje me këtë do të rekomandoja krijimin e një *database* kombëtare pranë Avokatit të Popullit mbi të gjitha problematikat, në mënyrë që të analizojmë dhe të shohim se cilat janë vendet dhe në cilat vende këto problematika janë më të shpeshta, cila është gama e këtyre problematikave e të gjitha me radhë.

Një fushatë publicitare në lidhje me veprimtarinë e Avokatit të Popullit, por jo si fushatë publicitare për Avokatin e Popullit, por për atë që ai ka si detyrë kryesore, pra një fushatë

publicitare në lidhje me shërbimet e Avokatit të Popullit, cili është qëllimi i shërbimeve të Avokatit të Popullit. Kjo është sot më e rëndësishmja.

Përfshirja e OJQ-ve si faktor, jo kthimi i Avokatit të Popullit në OJQ. Pranë Avokatit të Popullit ekziston një bord këshillimor dhe unë do të thosha që ky bord në funksionin e tij, në bordin e tij ka vetëm persona nga shoqëria civile, ndërkohë nuk përfshihen në të mediet. Mediet janë faktori kryesor, i cili prek shkeljen e të drejtave të njeriut në terren dhe është ajo që e përcjell e para. Pra, përveç qytetarit, media luan një faktor të rëndësishëm. Në këtë drejtim, do ta konsideroja një partner shumë të rëndësishëm për të evidentuar rolin edukativ të Avokatit të Popullit.

Promovimi i qeverisjes së mirë është kryefjala e sotme e të gjitha institucioneve europiane. A duam të shkojmë edhe ne aty? Natyrisht, duam. Çfarë do të përfitojmë? Do të përfitojmë performancë, bashkëpunim institucional brenda vendit, bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, kryesisht për atë pjesë të shoqërisë që ka në fokus të drejtat e njeriut, bashkëpunim me shoqatat dhe institucionet ndërkombëtare, zbatimin e të gjitha parimeve bazë.

Si do të arrihet qeverisja e mirë? Kjo do të arrihet nëpërmjet trajnimeve të stafit të administratës, aplikimin e metodave të vlerësimit të stafit, nxitjen e frymës së bashkëpunimit nëpërmjet organeve të administratës qendrore dhe lokale, thellimin e procedurave të thjeshta dhe të qarta në lidhje me trajtimin e shpejtë të problemeve, krijimin e një sistemi efektiv komunikimi të brendshëm dhe nxitjen e transparencës institucionale.

Shqyrtimi i ankesave në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Pra, shërbimi është kryefjala e Avokatit të Popullit.

Çfarë do të përfitojmë, nëse do të zbatojmë këtë objektiv? Kështu do të zbatojmë parimin e garancisë, duke qenë garanti kryesor për atë subjekte të cilave u janë shkelur të drejtat dhe do të rrisim efikasitetin në vendimmarrje dhe gjithashtu, do të rrisim dhe rolin aktiv të Avokatit të Popullit, kryesisht në nismat e tij.

Çfarë do të rekomandoja? Do të rekomandoja forcimin e kontrollit të brendshëm institucional, në lidhje me zbatimin e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë gjatë procedurave që do të ndërmerren nga administrata për shqyrtimin e ankimeve.

Roli aktiv i Avokatit të Popullit në hartimin e ligjeve është shumë i rëndësishëm. Do të doja këtu të theksoja lidhjen me Kuvendin. Avokati i Popullit nuk duhet të çojë vetëm raporte të

posaçme dhe të përgjithshme në Kuvend. Njerëzit duhet ta dëgjojnë dhe ta njohin Avokatin e Popullit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Peto!

Ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit për prezantimin!

Unë kam një pyetje, që ua kam bërë të gjithë kandidatëve dhe dua të jem korrekte me të gjithë: Nëse Kuvendi do t'ju mandatojë për të qenë Avokate e Popullit, midis të gjithë atyre masave që ju përmendët dhe besoj se keni edhe shumë të tjera në *booklet*, kë do të vlerësoni si prioritet në ditën që do të uleshit në zyrën e Avokatit të Popullit?

E dyta, çfarë ofroni midis kandidatëve të tjerë? Pse duhet t'ju votojmë?

Zhaklina Peto – Unë po e filloj nga e para. Ju thashë që detyra e Avokatit të Popullit është pikërisht shërbimi, pra të jetë në funksion të qytetarëve. Në fakt do të përpiqesha të kontrolloja dhe të përmirësoja cilësinë e shërbimit, pra zgjidhjen deri në fund të ankesës.

E dyta, do të doja të isha një ndërmjetës shumë i mirë. Fjala “Avokat i Popullit”, ndoshta keqkuptohet në shoqëri, sepse Avokati i Popullit nuk është avokati i palëve, por është ndërmjetësi. Do të doja ta bëja shumë mirë, në mënyrë të paanshme detyrën e ndërmjetësit ndërmjet palëve.

Nga ana tjetër, do të merresha shumë seriozisht me nxitjen e rolit aktiv të Avokatit të Popullit. Në kuadër të zbatimit të parimit të universalitetit, në mënyrë që njerëzit ta njohin, ta dinë se çfarë bën, çfarë zgjidh dhe çfarë ofron, pra të ndërgjegjësohen të gjithë, në lidhje me ekzistencën e këtij institucioni kaq të rëndësishëm në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave.

Kisha edhe diçka tjetër: marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë janë marrëdhënie absolutisht të rëndësishme për të evidentuar gabimet dhe për të eliminuar pasojat në të ardhmen.

Roli i Avokatit të Popullit, në lidhje me propozimet për ndryshime ligjore. Meqenëse unë vij nga fusha e mësimdhënies dhe ne japim opinione të ndryshme në lidhje me ligje të ndryshme që vijnë në parlament, pra u bëj një lloj oponente, do të më pëlqente shumë që roli aktiv i Avokatit të Popullit në këtë lloj oponente të ishte i padiskutueshëm për të gjitha ligjet, pra të merrej mendimi i tij për të gjitha ligjet, t'i jepet një rol i tillë. Unë do të propozoja të ngrihej një bord brenda institucionit që të merrej me punë shkencore të mirëfilltë, sepse në fund të ditës, të prekësh

praktikën, të shikosh problemet dhe ta pasqyrosh atë në ligj, është idealja që mund të presim në për brezat e ardhshëm në kuadër të vazhdimësisë së legjislacionit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Peto!

Ditë të mbarë!

Mund t'ia lini stafit ato që keni përgatitur për ne dhe stafi do të na i shpërndajë.

Gjithë të mirat!

Zhaklina Peto – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me zotin Igli Totozani!

Igli Totozani – Mirëdita!

Fatmir Xhafaj – Stafi ta ndihmojë zotin Totozani të ketë mundësi të na vendosë në dispozicion ato çfarë ka përgatitur.

Përshëndetje, zoti Totozani!

Ju keni shprehur interesin për të kandiduar përsëri si Avokat i Popullit. Sot kemi seancën dëgjimore. Siç jeni njoftuar lidhur me këtë seancë, koha për t'u prezantuar dhe për të paraqitur vizionin tuaj lidhur me këtë rikandidim, është 7 minuta. Do t'ju lutesha ta respektoni atë, ndërkohë që është respektuar edhe nga kandidatët e tjerë që kanë qenë këtu.

Fjala është për ju, për filluar prezantimin tuaj dhe më pas eventualisht, për t'iu përgjigjeni pyetjeve të deputetëve.

Igli Totozani – Faleminderit, zoti kryetar!

Po e filloj shpejt. Gjatë këtyre 5 vjetëve të ardhshëm, Avokati i Popullit, nëse do të më besohet drejtimi, do të ketë këto objektiva kryesore:

Përmirësimin e mirëqeverisjes, luftën kundër varfërisë, pabarazisë dhe përjashtimit social, parandalimi i torturës, trajtimit degradues dhe çnjerëzor, konsolidimi i një kulture demokratike në Shqipëri, forcimi i besimit publik ndaj institucionit të Avokatit të Popullit, forcimin e pavarësisë së institucionit.

Ju e dini që 3 janë fushat, ku punon Avokati i Popullit: parandalimi, mbrojtja dhe promovimi. Të gjitha objektivat janë të shpërndara në këto 3 fusha.

Për sa i përket parandalimit, ju e dini që Njësia e Parandalimit të Torturës kryen pjesën më të madhe, por ky parandalim do të shtrohet edhe më tej nga strukturat e institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, për sa i përket mekanizmit, do të futen më shumë për shoqërimet që bën mekanizmi me kthimet e pavullnetshme të emigrantëve shqiptarë pa dokumente, fëmijët në lëvizje, fëmijët shqiptarë të pashoqëruar, monitorimi në pikat kufitare dhe të gjitha qendrat e tjera që dihen si: komisariatet, burgjet, paraburgimet, spitalet psikiatrike etj.

Ajo që mendoj si të re për këtë mandat, është një staf edhe më i plotë dhe më disiplinor, perfeksionimi i metodologjisë së monitorimit sipas ABT-së, uljen e numrit të monitorimeve në mënyrë drastike dhe zëvendësimin e tyre me monitorime tematike, marrëveshje me vendet ku banojnë shqiptarët, në mënyrë që të sigurojmë mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe në mënyrë të veçantë, forcimin e rrjetit ballkanik.

Po në këtë kuadër të parandalimit, mendojmë se është e rëndësishme të monitorohen edhe struktura të caktuara të shëndetësisë, arsimit, shërbimeve publike, vizita monitoruese për infrastrukturën e paktë në institucionet shtetërore.

Momenti i dytë apo reaktiv i institucionit të Avokatit të Popullit, që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose Ombudsmani klasik. Në këtë rast do të ndaja 3 kategori të caktuara:

- Në radhë të parë, është përcaktimi i fushave strategjike. Nuk mund të punojmë në të gjitha drejtimet.

- E dyta, është përcaktimi i rasteve strategjike, të cilat mund të shërbejnë si shembull për administratën publike, si raste praktikash të mira. Elementi i dytë është ngritja në bashkëpunim me administratën publike qendrore dhe lokale, të pikave fokale në çdo dikaster.

- Gjithashtu, ngritja e grupeve të dialogut mes institucionit të Avokatit të Popullit me administratën publike, e cila do të synojë diskutimin e rasteve konkrete, projektligjeve, strategjive, planeve të veprimit etj.

Sa i përket pjesës së brendshme, kam parasysh trajnimin e vazhdueshëm të stafit me standardet ndërkombëtare dhe në mënyrë të veçantë, me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, trajnimin e vazhdueshëm të administratës publike qendrore dhe lokale.

Një sistem që është përdorur te mbrojtësit e të drejtave në Francë, janë delegatët rajonalë, vullnetarë, të cilët do të jenë përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit në çdo qytet të Shqipërisë, forcimi i zyrave rajonale dhe rinovimi i zyrave të sistemit të menaxhimit të rasteve.

Për sa i përket elementit të tretë, i cili ka të bëjë me Avokatin e Popullit, si institucion i të drejtave të njeriut me status pranë Kombeve të Bashkuara.

Objektivat kryesore për sa i përket promovimit do të jenë: përmirësimi i mirëqeverisjes, lufta kundër varfërisë, pabarazisë dhe përjashtimit social, konsolidimi i një kulture demokratike në Shqipëri, forcimi i besimit publik ndaj institucionit të Avokatit të Popullit, forcimi i pavarësisë së institucionit të Avokatit të Popullit.

Në këtë rast prioritetet kryesore do të mbeten: bashkëpunimi me administratën publike qendrore dhe lokale, promovimi i konventave ndërkombëtare, promovimi i Avokatit të Popullit dhe i të drejtave të njeriut në administratën publike qendrore dhe lokale me qytetarët, si dhe rritja e rolit të Avokatit të Popullit në përhapjen e edukimit mbi të drejtat e njeriut.

Objektivat kryesore në këtë drejtim do të jenë grupet vulnerabël, fëmijët jetimë, fëmijët e pashoqëruar, fëmijët në lëvizje, minoritetet, gratë, fëmijët e familjeve në gjakmarrje, PAK, mosha e tretë, komuniteti LGBTI, emigrantët, të varfrit, të pastrehët etj.

Tri drejtimet që do të monitorojmë në kuadër të promovimit, do të jenë: Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (2015-2030), duke i përfshirë që të gjitha: nivelin e varfërisë, minimumin jetik, jetën e shëndetshme, mirëqenien, arsimin, mësimin për të gjithë, barazinë gjinore, aksesin në ujë dhe energji.

Gjithashtu, do të jetë e rëndësishme të monitorojmë konventat e Kombeve të Bashkuara, tek të cilat ka aderuar Shqipëria në mënyrë të tillë, që të përgatisim raporte hije për Kombet e Bashkuara, të monitorojmë zbatimin e kriterëve për hapjen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE-së, dhe në mënyrë të veçantë të monitorojmë zbatimin e kapitullit 23, që flet për gjyqësorin, drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, kapitull për të cilin Shqipëria do të hyjë në negociatë.

Gjithashtu, do të monitorojmë planin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, në rastin e Shqipërisë.

Të gjitha këto monitorime do të shoqërohen me raporte të posaçme për Kuvendin, raporte hije për Kombet e Bashkuara, për sa thashë më sipër. I gjithë ky aktivitet do të kërkoj marrjen e masave të brendshme, që kanë të bëjnë me stafin e Avokatit të Popullit, përgatitje me homologët tanë europianë për trajnimin e stafit monitorues dhe për përgatitjen e rekomandimeve

legjislative. Një vend të veçantë do të zerë në këtë rast puna promovuese me Kuvendin e Shqipërisë, diskutimin e raporteve të posaçme dhe hije, seancat dëgjimore vizita të përbashkëta me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut në institucione të caktuara në Shqipëri, zbatimin e rezolutave.

Një gjë e re do të jetë një iniciativë për të organizuar vizita të përbashkëta me parlamentarë dhe me Ombudsman-in në vende të ndryshme europiane për të parë se si bashkëpunojnë parlamentarët dhe ombudsmanët në vendet europiane. E njëjta gjë (gjithmonë në fushën e promovimit), do të fuqizohen lidhjet me shoqërinë civile, do të forcohet Bordi Këshillimor, do të ketë monitorime dhe raporte të përbashkëta.

E reja është krijimi i një rrjeti kombëtar mes Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe ngritja e bordeve lokale, aty ku ka zyra të Avokatit të Popullit. Do të kërkojmë të kemi seanca të përbashkëta për t'u dëgjuar në komisionet parlamentare. E njëjta gjë vlen edhe për sindikatat, edhe për grupet e interesit.

E reja tjetër, qëndron te bashkëpunimi me qeverinë. Përveç atyre që thamë, grupet e punës, apo grupet e dialogut dhe për pikat me të cilat do të bashkëpunojmë, kemi menduar që me fillimin e punës, të kontribuojmë për ndërtimin e një strategjie kombëtare për të drejtat e njeriut në nivel qeveritar, për ngritjen e një komiteti ndërministror për të drejtat e njeriut, ngritjen e një raportit kombëtar për të drejtat e njeriut nga Kryeministri, do të kërkojmë ngritjen e një mekanizmi pune me qeverinë dhe dhënien e një mandati shtesë për një prej ministrave apo zëvendëskryeministrin për të drejtat e njeriut dhe grupet që përmendën për trajnimet me administratën publike. Në mënyrë të veçantë kam dalluar Ministrinë e Arsimit dhe atë të Kulturës. Kjo është lidhur me faktin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ka një rol të jashtëzakonshëm në edukimin e brezave të rinj me të drejtat e njeriut. Për këtë arsye do të ngrihet një grup pune me Ministrinë e Arsimit për të rishikuar kurrikulat e arsimit parauniversitar, në mënyrë që t'i përmirësojmë ato në këtë drejtim, si dhe të organizojmë trajnime periodike me mësuesit e arsimit parauniversitar.

Një tjetër marrëdhënie delikate dhe e rëndësishme është ajo me INSTAT-in, duke pasur parasysh edhe procesin e vendimmarrjes, sidomos, në zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku INSTAT-i ka një rol jashtëzakonisht të madh.

Këto janë 3 fushat kryesore, ku funksionon Avokati i Popullit: sikurse e thamë, parandalimi, ombudsman-i i klasik dhe pjesa e tretë, që është institucioni i të drejtave të njeriut.

Të gjitha këto do të kërkojnë një modernizim të institucionit të Avokatit të Popullit. Këtë do ta ndaja në këto objektiva: përmirësimi i vendimmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të bazuar, rritja e efektivitetit të Avokatit të Popullit dhe orientimi i vendimmarrjes në lidhje me realitetin e të drejtave të njeriut, fuqizimi i strukturës së Avokatit të Popullit.

Masat konkrete: gjëja e parë që duhet bërë është rinovimi i sistemit aktual të menaxhimit të rasteve, që është i vjetër dhe duhet ndryshuar, si dhe perfeksionimi i tij në lidhje me nxjerrjen e statistikave me bazë moshe, gjinie, zone gjeografike, gjendjeje sociale, arsimimi etj.

Përmirësimi ligjor: e drejta e titullarit për të ndryshuar strukturën e Avokatit të Popullit, pra një strukturë më elastike për t'iu përgjigjur më mirë sfidave dhe situatave konkrete.

Ndryshimi i mënyrës së rekrutimit të stafit...

Fatmir Xhafaj – Do t'ju lutesha ta përmbliidhni, se e keni kaluar kohën!

Igli Totozani – Edhe një fjali.

Ndryshimi i mënyrës së rekrutimit të stafit të nëpunësit civil ndryshe nga ligji “Për nëpunësin civil” dhe njohja e transferimeve të përhershme të gjyqtarëve apo avokatëve pranë stafit të Avokatit të Popullit.

Fuqizimi i rolit të Avokatit të Popullit në nivel ndërkombëtar.

Së fundi, do të doja të shtoja edhe një gjë: pika kyçe e të gjithë këtij programi apo kësaj strategjie qëndron te pavarësia e institucionit. Nëse ajo do të arrijë të jetë e konsoliduar, të gjitha sa përmenda më sipër, janë të realizueshme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Totozani!

Ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Totozani!

Unë ju ndoqa me vëmendje. Përfitova nga rasti për të parë edhe vizionin e ri për institucionin që ju keni drejtuar dhe kërkoni ta drejtoni, edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar. Unë ua kam bërë këtë pyetje edhe kandidatëve të tjerë, por për ju është më pak specifike: Krahasuar me punën që keni bërë në 5 vjetët e mandatit të parë, çfarë nuk keni bërë siç duhet dhe çfarë do të bënit më mirë, nëse Kuvendi do t'ju mandatonte për një mandat të dytë?

Igli Totozani – Ju falënderoj për pyetjen!

Mendoj që në radhë të parë, ajo që nuk kemi mundur të bëjmë që në dukje nuk është e rëndësishme, por është jetike për institucionin e Avokatit të Popullit, sepse e lehtëson shumë vendimmarrjen e grupit drejtues të institucionit, është rinovimi i sistemit të menaxhimit të rasteve konkrete. Ky është një sistem i vjetër, i sjellë nga Danimarka në vitin 2001 dhe për fat të keq, nuk na lë vend për statistika. Koha ka ardhur, bile po kalon, që çdo institucion para çdo vendimmarrjeje që kryen duhet që ta bazojë atë në një sistem të qartë statistikash, të cilat e bëjnë vendimin të përshtatshëm me realitetin ku ai funksionon.

Nëse doni të dini pengjet e mia gjatë këtyre 5 vjetëve, ato janë që nuk kam arritur dot të ndal uljen e disa standardeve, si për shembull në rastin e aftësisë së kufizuar për ata persona që futen në qendrat rezidenciale dhe humbin pagën e aftësisë së kufizuar.

Një tjetër peng i madh ka të bëjë me qytetarët romë dhe ata egjiptianë, sidomos, me 2 projektet që kemi pasur gjatë këtyre 5 vjetëve, që kanë pasur të bëjnë me transferimin e të dhënave të gjendjes civile nga njëri qytet në një qytet tjetër dhe krijimin e lehtësive dhe standardeve për të përfituar ndihmën ekonomike. Pengu më i madh për mua është mosmiratimi ende i një minimumi jetik në Shqipëri, i cili do të bënte të mundur krijimin e një sistemi social më të afërt me qytetarët shqiptarë, në mënyrë të veçantë për ata që janë të pamundur dhe e kanë të vështirë mbijetesën e tyre. Besoj se kjo do të jetë një sfidë për këdo që do të jetë Avokat i Popullit, sepse kjo nuk është një kërkesë shkencore, por është një nevojë, të cilën e sjell koha, e sjellin problemet e shumta që ndeshin qytetarët tanë. Do t'i jepja rëndësinë maksimale, megjithëse jemi munduar t'ia japim atij postulati të Kombeve të Bashkuara, që ka lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, që do të thotë: luftë ndaj pabarazisë, përjashtimit social dhe ndaj varfërisë.

Askush nuk duhet të mbetet prapa në Republikën e Shqipërisë. Nëse nuk do të arrinim dot që t'ju siguronim qytetarëve tanë një jetë dinjitoze, do të ishte pengi i gjithë jetës, jo vetëm si Avokat i Popullit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Kisha unë dy pyetje:

E para: në fillimet e mandatit tuaj të parë ju keni deklaruar që nuk do të kandidoni më për postin e Avokatit të Popullit. Çfarë ka ndryshuar që ju ka bërë të ndryshoni pozicionin dhe qëndrimin tuaj në këtë deklaratë publike?

E dyta: në ndryshimet e ligjit të para dy vjetëve në mos gaboj për miratimin e dy komisionerëve në zyrën e Avokatit të Popullit, edhe sot ende nuk kanë ardhur në Kuvend dy kandidaturat përkatëse. A ka diçka që nuk shkon në punën tuaj, apo ka diçka që është përtej punës suaj?

Igli Totozani – Ju falënderoj për pyetjen, zoti kryetar!

Po e nis nga pyetja e dytë. Ne kemi bërë të gjitha përpjekjet që nga dita që ka hyrë ligji në fuqi. Për këtë ekzistojnë dosjet konkrete pranë institucionit të Avokatit të Popullit, me të gjitha ftesat që kemi bërë të cilat përsëriten çdo muaj në institucionin tonë, duke u përhapur në të gjitha sajtet dhe mundësitë në sajtin tonë, në *facebook*, në institucionet shtetërore, në ato të shoqërinë civile dhe kudo. Për fat të keq, kandidaturat që vijë, janë shumë të pakta dhe nuk arrijnë numrin 4, që është minimumi për një kandidaturë. Mendoj që ajo formulë në rast se do të jem ende në detyrë si Avokat i Popullit, duhet ta rishikoj së bashku me komisionin tuaj, që ta pleqërojmë, nëse është e mundshme, apo jo, sepse është shumë e vështirë të mblidhen 4 kandidatura për një post. Për këtë janë dosjet përkatëse pranë institucionit të Avokatit të Popullit, e që në një farë mënyre e vërtetojnë se është shumë e vështirë.

Do të jetë e vështirë akoma më shumë tani, në prag të zgjedhjes së 5 komisionerëve, që do të thotë se duhet të na vijnë minimumi 20 kandidatë për 5 komisionerë, por që të ketë një minimum gare, me një logjikë të thjeshtë matematike, i bie të na vijnë 40 kandidatura për 5 komisionerë, në mënyrë që të ketë të paktën 2 kandidatë për një post. Kështu që ju ftoj, nëse do të isha Avokat i Popullit edhe për një mandat të ri që bashkë me komisionin tuaj, të ulemi dhe ta pleqërojmë, që të gjejmë një formulë sa më të përshtatshme për t'i afruar njerëzit ose edhe me ndihmën tuaj të gjejmë një zgjidhje për këtë.

Për sa i përket pyetjes suaj të parë, ajo çka unë kam thënë që nuk do të kandidoja më, është e vërtetë që e kam thënë, por siç jua thashë edhe në fillim, unë jam një njeri i zakonshëm, me shumë pengje dhe kjo detyrë këto 5 vjet, kultura demokratike që unë kam ndeshur në këto 5 vjet, ka bërë që shumë nga këto çështje të mos zgjidhen dhe këto çështje për një njeri si unë, mbeten pengje, të cilave nuk u ikën dot. Unë nuk dua t'u iki këtyre pengjeve dhe në mënyrë të veçantë, atë që ju thashë që në fillim të sistemit social, i cili ka nevojë të ndryshohet rrënjësisht në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave që kanë qytetarët shqiptarë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Totozani!

Besoj se platforma juaj u shpërnda tek të gjithë kolegët.

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Vazhdojmë me kandidaten Rovena Voda.

Përshëndetje!

Ju falënderoj zonja Voda, që keni shprehur interesin për të kandiduar për postin e Avokatit të Popullit!

Në këtë seancë dëgjimore, koha për t'u prezantuar dhe për të paraqitur vizionin tuaj lidhur me këtë funksion të rëndësishëm, është 7 minuta. Do t'ju lutesha ta respektoni atë, ashtu siç kemi vepruar edhe për kandidatët e tjerë!

Fjala është për ju.

Rovena Voda - Përshëndetje!

Ju falënderoj për mundësinë që më dhatë për t'u dëgjuar para këtij komisioni të nderuar!

Së pari, do të bëj një prezantim të shkurtër të CV-së sime. Unë quhem Rovena Voda. Kam mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës dhe kam mbaruar Master Shkencor në të Drejtën Private.

Gjatë periudhës 10-vjeçare 2004-2014 kam ushtruar profesionin e avokatit , kam punuar *part time*, si lektore (2009-2012) dhe jam trajnuar dhe jam certifikuar si ndërmjetëse, duke punuar si e tillë në zyrën pilot të ndërmjetësimit në Gjykatën e Rrethit të Durrësit. Aktualisht, punoj si drejtoresh e Kabinetit pranë ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Doja të veçoja se një pjesë e punës ime aty lidhet me institucionet e pavarura kushtetuese, siç është edhe ai i Avokatit të Popullit. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin është ministri që kujdeset edhe për institucionet e pavarura kushtetuese. Mendoj se kjo eksperiencë do të më vlejë pa masë në këtë pozicion për të cilin unë po kandidoj.

Desha të përmend arsyet pse mendoj që unë jam kandidatura e duhur për pozicionin e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit është një ndër institucionet e pavarura më të rëndësishme, me rol të padiskutueshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë, në forcimin dhe konsolidimin e demokracisë së vendit tonë. Sigurisht, mendoj se ka ende për të bërë në drejtim të gjetjes së mekanizmave të duhura për t'i bërë mundësisht sa më shumë të zbatueshme rekomandimet e dala nga ky institucion.

Mendoj se jam personi i duhur edhe për shkak të profesionit të avokatit që e kam ushtruar për vite me radhë, gjë që më ka dhënë mundësinë të njoh dhe të prek nga afër problematikat e shumta të jetës së përditshme, të qytetarëve të thjeshtë të këtij vendi. Jam person që më pëlqen të komunikoj me njerëzit, të ndjek nga afër problemet e tyre, të këmbëngul në zgjidhjet e tyre, të bashkëpunoj me të gjithë aktorët që do të jenë pjesë e punës së këtij institucioni.

Unë besoj fort në vlerat e këtij institucioni, të cilat janë pa diskutim, një kontribut i çmuar për demokracinë e vendit tonë.

Nuk mund të lë pa përmendur edhe eksperiencën që kam, lidhur me trajtimin e shqetësimeve të institucioneve të pavarura, për shkak të punës sime.

Për shkak të funksionit tim aktual, eksperiencia me Kuvendin e Shqipërisë më ka bërë të kuptoj që vetëm bashkëpunimi i ngushtë i institucioneve të pavarura me Kuvendin e Shqipërisë, kryesisht me Komisionin e Ligjeve, me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, me Drejtorinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, janë mbështetja e duhur drejt gjetjes së mekanizmave të duhura për forcimin e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit. Për shkak të eksperiencës, gjithashtu, njoh mirë strategjinë dhe reformën për administratën publike dhe jam në dijeni se Avokati i Popullit është një nga institucionet lider në realizimin e treguesve, që lidhen me llogaridhënien e administratës publike, ku shqetësimi kryesor dhe çështje për t'u zgjidhur mbetet mbrojtja e së drejtës së qytetarëve për të pasur një administratë që do t'u shërbejë sa më mirë.

A ka mekanizma kontrolli nga institucionet mbikëqyrëse dhe për më shumë, a janë sistematikisht të implementueshme rekomandimet e Avokatit të Popullit? Këto shqetësime mbeten gjithmonë. Eksperiencë e vlefshme ka qenë pjesëmarrja ime si anëtare e grupit të punës së ngritur pranë Kuvendit të Shqipërisë, ku në fokus ka qenë hartimi i një plani veprimi për *follow up* të zbatimit të rekomandimeve të *Peer Mission Review*, konferenca e datës 3 shkurt 2015 për disa institucione të pavarura.

Po kështu, mendoj se do të vlejë njohja e mirë e procesit që ka nisur në Kuvend që në nëntor të vitit të shkuar, lidhur me ngritjen e një mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve kryesore kushtetuese, kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe hartimi i një plani të përbashkët të këtyre institucioneve, Kuvendit dhe Qeverisë.

Së treti, do të doja të rendisja pikërisht fokusin, pra cili do të ishte fokusi im në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën 2017-2022.

Së pari, funksioni kryesor i institucionit të Avokatit të Popullit është i lidhur pazgjidhshmërisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sigurisht, një nga mënyrat për të siguruar maksimalisht këto të drejta, lidhet me aksesin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen e institucioneve publike. Kështu, Avokati i Popullit mund të shërbejë si një mekanizëm për të siguruar aksesin e qytetarëve në vendimmarrje, duke i detyruar organet qendrore të administratës publike që të gjitha aktet me impakt të drejtpërdrejtë në jetën sociale, ekonomike, apo ato që lidhen me shërbimet që u ofrohen qytetarëve, të shkojnë për mendim pranë Avokatit të Popullit, të konsultohen me këtë institucion të pavarur kushtetues.

Së dyti, duhen bërë përpjekje që rekomandimet e Avokatit të Popullit të jenë me një afat detyrues. Nga praktika ime, shpeshherë kam vënë re se rekomandimet mbeten edhe pa përgjigje. Të paktën, minimumi është që brenda një afati detyrues, të ketë një përgjigje për rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe sigurisht, më e mira do të ishte zbatimi i tyre.

Modeli ynë i Avokatit të Popullit ka qenë ai danez dhe ka qenë qeveria daneze që e ka mbështetur fuqimisht krijimin e këtij institucioni, ndaj në fokusin tim të punës do të ishte e pashmangshme që të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga raporti “Vlerësimi i mbështetjes së qeverisë daneze për Ombudsman-in shqiptar” 2012-2016”, ku disa prej tyre (më vjen mirë që e them këtë), janë të njëjta me ato të dala nga projektrezoluta e Kuvendit për Avokatin e Popullit 2016.

Sigurisht, në mënyrë të përmbledhur, sepse i kam edhe në materialin që ju, të nderuar deputetë, keni përpara, por në fakt mendoj se gjërat kryesore që janë urgjente dhe që duhen bërë hapa përpara në veprimtarinë e këtij institucioni, janë:

Së pari, duhet të zgjidhet ngërçi për zgjedhjen e dy komisionerëve. Mendoj se ky është hapi i parë. Nuk mund të pretendojmë një funksionim normal të këtij institucioni, pra nëse ne nuk arrimë të kemi një staf të plotë, të bashkëpunojmë me stafin dhe sigurisht, mendoj se këtu ka pasur mangësi. Mendoj se duhen bërë thirrje publike për t’u bërë e njohur për të gjithë personat e interesuar, që të vijnë dhe të kandidojnë për këto dy pozicione. Unë mendoj që në fakt dy ndryshimet e fundit që u bënë në ligjin për Avokatin e Popullit, garantojnë më së miri pavarësinë e komisionerëve, apo paragjykimin, që ata janë të përzgjedhur personalisht nga vetë Avokati i

Popullit. Pra, vlerësimi, votëbesimi që do të japë Kuvendi, për mua është një plus shumë i madh, që nuk do të paragjykojë aspak punën e Avokatit të Popullit.

Së dyti dhe më e rëndësishmja, që në fakt për mua ka munguar, është dialogu me Kuvendin, por edhe me përfaqësuesit e qeverisë. Mendoj se ndoshta krijimi i një grupi të përbashkët reference, pune me përfaqësues të Komisionit të Ligjeve, të Nënkomisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuesit e qeverisë dhe të Avokatit të Popullit, mund të ndihmojë në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Do t’ju lutesha ta mbyllni, se e kaluat kohën! Keni ndonjë merak për ta mbyllur?

Rovena Voda – Kisha edhe një merak.

Shumë faleminderit!

Në fakt gjatë gjithë viteve të punës së Avokatit të Popullit ka qenë në fokus pothuajse të gjitha grupet e interesit që nga fëmijët, gratë, romët egjiptianët komuniteti LGBT, por në fakt një grup moshe ka qenë i harruar. Është pikërisht mosha e tretë. Ne duhet të bëjmë shumë për ta. Janë prindërit tanë, edhe ne do të jemi një ditë si ata, kështu që fokusi im do të ishte edhe kjo grupmoshë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Muhedini ka një pyetje për ju.

Tahir Muhedini – Faleminderit, kryetar!

Siç thatë gjatë fjalës suaj, në punën e Avokatit të Popullit ka shumë mangësi për ta bërë punën më mirë. Para jush ishte vetë Avokatit të Popullit, i cili kishte vetë disa vërejtje. Çfarë mund të bëni ju më mirë në rolin e Avokatit të Popullit?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zonjë!

Rovena Voda – Unë ju falënderoj për pyetjen! Besoj se e preka pak këtë në fjalimin tim, i nderuar zoti Muhedini. Unë e çmoj shumë dialogun dhe e përmenda fjalën kyçe “dialog”. Mendoj se kjo ka munguar. Nuk është koha që të qahemi dhe të ankojemi se pse institucionet nuk reagojnë, pse nuk kthejnë përgjigje apo pse kjo nuk bëhet. Unë mendoj se duhen vendosur ura komunikimi, të cilat mendoj se nuk kanë qenë në nivelin ku duhet të jenë. Për mua dialogu ka qenë i një niveli tepër të ulët. Madje, mund të shtoj se kam ndjekur (e kam këtë eksperiencë gjatë punës me Kuvendin dhe me këtë komision të nderuar, të cilin e vlerësoj jashtë mase), seanca dëgjimore

raportimet e Avokatit të Popullit pranë Nënkomisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe në fakt këto raportime nuk do t'i quaja në nivelin e duhur, madje nuk kanë qenë as të azhurnuara. Është kërkuar që Avokati i Popullit të raportojë në vitin 2015, por në raportin e tij ka pasur të dhëna për vitet 2012, 2013 dhe 2014. Pra, gjithmonë mendoj se bashkëpunimi i ngushtë, raportimet e shpeshta dhe dialogu do ta përmirësojë punën e Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi ka një pyetje për ju.

Vasilika Hysi - Faleminderit për prezantimin, zonja Voda!

Shumë faleminderit edhe për platformën shumë interesante!

Unë kam një pyetje për ju. Ju i keni ndjekur institucionet e pavarura kushtetuese dhe Avokatin e Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Na dhatë edhe një rekomandim shumë interesant si mund të jenë më efektive rekomandimet e tij. Nëse Kuvendi do t'ju mandatonte për të qenë Avokate e Popullit për 5 vitet e ardhshme në tërësinë e këtyre sugjerimeve që keni bërë, cilat do të rendisni si 3 më parësoret në 100-ditëshin e parë të punës suaj?

Rovena Voda – E para, do të ishte zgjedhja e menjëhershme, funksionimi normal i punës së Avokatit të Popullit me zgjedhjen e dy komisionerëve, pra historia mesa di unë, vazhdon dhe ky ngërç duhet të marrë fund dhe sigurisht, duhet edhe vullneti i kreut të institucionit.

E dyta, të cilën e përmenda, do të ishte ngritja e menjëhershme e grupit të referencës me parlamentarë të nderuar të Komisionit të Ligjeve, të Nënkomisionit parlamentar për të Drejtat e Njeriut e pse jo, edhe me përfaqësues të qeverisë për të parë se cilat kanë qenë më të shpeshtat rekomandime të Avokatit të Popullit, si mund të bëhen të zbatueshme ato dhe cili mund të jetë fokusi kryesor i Kuvendit, por edhe i qeverisë.

E treta, të cilën e kam shumë për zemër, do të filloja menjëherë punën për të ndërtuar një plan veprimi për moshën e tretë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Voda për prezantimin dhe për platformën!

Rovena Voda – Ju falënderoj shumë për durimin!

Fatmir Xhafaj – Ishte detyra jonë dhe kënaqësi që ju dëgjuam.

Ditë të mbarë!

A mund të më thoni ju, të Shërbimit të Monitorimit, se çfarë do të bëjmë më tej? Ne e mbyllëm procesin e seancës dëgjimore. Ka mbetur vetëm një kandidat për t'u dëgjuar.

Artur Baku - Faleminderit, zoti kryetar!

Ne, si Shërbimit të Monitorimit, kemi bërë një memo për të gjitha kandidaturat, ku jemi shprehur edhe për kriteret ligjore të kandidatëve. Komisioni, bazuar në ligjin organik për Avokatin e Popullit, duhet të miratojë listën e kandidatëve që nuk e vazhdojnë më tej procedurën.

Fatmir Xhafaj – Mos duhet të bëjmë edhe një raport për procesin, ne si komision?

Artur Baku – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – A duhet të jetë edhe lista e përfshirë në atë raport?

Artur Baku – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – Këtë duhet ta miratojmë në mbledhjen e ardhshme të komisionit.

Artur Baku – Çdo kandidaturë duhet të miratohet nga komisioni, nëse i plotëson kriteret ligjore.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Artur Baku – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kjo do të thotë që ju së bashku me relatorët do të punoni për ta përmbledhur këtë në një raport të komisionit.

Ka ndonjë ide tjetër?

Artur Baku – Pas miratimit të listës nga komisioni, referuar ligjit organik “Për Avokatin e Popullit”, çdo kandidaturë për të vazhduar më tej procedurat duhet të marrë mbështetjen e deputetëve.

Fatmir Xhafaj – Patjetër. Ne sot do të miratojmë dhe do t'ua paraqesim grupeve parlamentare dhe do të botohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe më pas, secili është i lirë të hedhë firmën aty ku dëshiron.

Artur Baku – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk është më pjesë e detyrës sonë. Mos duhet ta dëgjojmë edhe personin që mungon, që të mos na përbëjë ndonjë problem?

Artur Baku – Kjo është e vendimmarrjes së komisionit. Ai person ka paraqitur një kërkesë dhe të dielën mund të jetë në Shqipëri dhe të hënën do të jetë në komision. Ju përket juve të vendosni.

Fatmir Xhafaj – Meqë të hënën do të kemi mbledhje miratojmë edhe raportin.

Artur Baku – Dakord.

Fatmir Xhafaj – T’i japim një shans atij që të konkurrojë.

Faleminderit kolegëve!

Faleminderit, edhe Drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit për angazhimin që ka pasur në këtë proces të vështirë!

Ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë, sepse nuk ka qenë shumë e lehtë për ta administruar të gjithë këtë proces.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

